



**GLOBAL
INITIATIVE**

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

PRURJE FINANCIARE TË PALIGJSHME NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONINË E VERIUT

Faktorët Kryesorë dhe Prirjet Aktuale

TUESDAY REITANO | KRISTINA AMERHAUSER

GUSHT 2020

PRURJE FINANCIARE TË PALIGJSHME NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONINË E VERIUT

Faktorët Kryesorë dhe Prirjet Aktuale

Tuesday Reitano
Kristina Amerhauser

Gusht 2020

FALËNDERIME

Kjo analizë e prurjeve të paligjshme financiare është pjesë e angazhimit të Iniciativës Globale në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Observatorit të Shqipërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs). SEE-Obs është një platformë që mbledh së bashku dhe fuqizon organizatat të shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi. Observatori kërkon t'i krijojë mundësi shoqërisë civile që të identifikojë, analizojë dhe të krijojë një tablo të prirjeve dhe tendencave kriminale, si dhe ndikimin e tyre mbi prurjet e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe respektimin e ligjit. SEE-Obs mbështet organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për monitorimin e zhvillimeve dhe tendencave të kriminit të organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ky raport bazohet mbi të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura nga organizatat dhe aktivistët të shoqërisë civile. Ai mbështet veçanërisht mbi intervistat dhe raportimin e një grupi prej nëntë ekspertësh nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut. I falënderojmë për ndihmesën e vyer përgjatë këtij procesi, si dhe për angazhimin e hapur dhe konstruktiv gjatë punës studimore. Falënderime të veçanta edhe për Walter Kemp, Fatjona Mejdinin, Ugi Zvekic, dhe Fabian Zhillën, si pjesë e ekipit të SEE-Obs.

Ky raport u hartua me mbështetjen financiare të GIZ. Duam të falënderojmë partnerët tanë në GIZ që na ndihmuan dhe orientuan përgjatë përpilimit të këtij raporti. Sidoqoftë, përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ.

NË LIDHJE ME AUTORËT

Tuesday Reitano është zëvendës-drejtoresh e GI-TOC. Tuesday ka punuar për 12 vjet si specialiste politikash në sistemin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Programin e Zhvillimit të OKB-së (UNDP), Grupin e Zhvillimit të OKB-së (UNDG), si dhe zyrën e OKB-së mbi Drogën dhe Krimin (UNODC). Ajo ka hartuar disa raporte mbi politika dhe studime akademike për disa nga institucionet më të rëndësishme si OKB, Bankën Botërore, dhe Organizatën për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (Organisation for Economic Co-operation and Development – OECD), mbi çështje që variojnë nga evoluimi dhe ndikimi i kriminit të organizuar në Afrikë, trafikimi i qenieve njerëzore, prurjet financiare të paligjshme, si dhe lidhjet midis kriminit, terrorizmit, sigurisë, dhe zhvillimit. Tuesday është autorja kryesore e një prej publikimeve më të rëndësishme të OECD: Prurje Financiare të Paligjshme: Ekonomitë Kriminale në Afrikën Perëndimore (Illicit Financial Flows: Criminal Economies in West Africa). Tuesday jeton në Gjenevë, Zvicër, së bashku me familjen e saj.

Kristina Amerhauser u bashkua me ekipin e GI-TOC në tetor 2018. Ajo punon si analiste, dhe po zhvillon kërkime dhe studime mbi Ballkanin perëndimor, në kuadër të punës me SEE-Obs. Kristina ka një diplomë master për studime ndërkombëtare nga Shkolla për Studime Ndërkombëtare në Vjenë, një diplomë universitare për biznes ndërkombëtar nga Universiteti i Vjenës për Ekonomi dhe Biznes, dhe një diplomë për studime zhvillimi nga Universiteti i Vjenës. Ajo jeton në Vjenë.

© 2020 Global Initiative Against Transnational Organized Crime.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdoq formë apo mënyrë pa leje me shkrim nga Iniciativa Globale.

Kopertina: © Robert Atanasovski, Armend Nimanj/AFP nga Getty Images; Dan Dennis, Amin Hamad, Marjanblan, Vladimir Solomyani, Christian Wiediger/Unsplash
Koperitna e dizenujar nga: Elné Potgieter
Hartografia: Paulina Rosol-Barras

Për çdo informacion mund të kontaktoni:
The Global Initiative Against Transnational Organized Crime
Avenue de France 23
Geneva, CH-1202
Switzerland

www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

Iniciale dhe shkurtime.....	iv
Përmbledhje e përgjithshme	1
Hyrje.....	4
Çfarë janë PFP?.....	6
Metodologjia.....	7
Kontekstualizimi i PFP në vendet e Ballkanit perëndimor.....	9
Tipare të qeverisjes.....	12
Komponentë të Prurjeve të Paligjshme.....	15
Krime të lidhura me korrupsionin.....	15
Krimi i organizuar.....	18
Krime të lidhura me taksat.....	23
Kanalet e Prurjeve të Paligjshme	26
Pastrim parash.....	26
Manipulimi me faturat.....	31
Transferimi i parave	34
Kanale të llogarive kapitale	36
Vlerësimi i reagimit ndaj PFP në vendet e Ballkanit perëndimor	39
Përpjekjet kundër pastrimit të parave	41
Legjislacioni financiar	44
Përpjekjet anti-korrupsion.....	45
Ndikimi mbi politikat	47
Analizimi i PFP për periudhën pas COVID-19	48
Përfundime.....	50
Përfundime për secilin shtet.....	52
Rekomandime	54
Shënime	58

INICIALE DHE SHKURTIME

ALL	Lek shqiptar
APP	Anti-pastrim parash
APP/BFT	Anti-pastrim parash / bllokimi i financimit të terrorizmit
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Pushtetin e Ligjit në Kosovë
TFVF	Task Forca për Veprim Financiar
NJIF	Njësia Informative Financiare
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
IGF	Integriteti Global Financiar
GI-TOC	Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
PFP	Prurje Financiare të Paligjshme
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KFOR	Misioni NATO për Kosovën
PP/FT	Pastrim parash / financimi i terrorizmit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës mbi Vlerësimin e Masave Anti-Pastrim Parash
BKRMV	Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut
PMP	Pajisje për mbrojtje personale
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SEE-Obs	Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar në Evropën juglindore
STR	Sinjalizim për transaksion të dyshimtë
RDT	Rrjeti i Drejtësisë Tatimore
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin
TVSH	Taksa e Vlerës së Shtuar



© Peter Endig/Picture Alliance
nga Getty Images

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Purjet Financiare të Paligjshme (PFP) – që përkufizohen nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si “para që fitohen, shpenzohen apo transferohen në mënyrë të paligjshme, dhe që kalojnë kufijtë e shteteve,” dhe dalin nga aktivitete kriminale, korrupsioni dhe evazioni fiskal¹ – paraqesin sfida serioze për vendet e Ballkanit perëndimor. Ky raport studion dinamikat e PFP-ve në rajon, dhe përqendrohet mbi Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Këto janë informacione plotësuese në vazhden e studimeve të shumta të kryera nga organizata ndërkombëtare, në kuadër të procesit të hyrjes në Bashkimin Evropian, dhe e analizojnë fenomenin nga këndvështrimi i shoqërisë civile.

Sipas modelit të sugjeruar nga Task Forca e Kombeve të Bashkuara mbi Financimin dhe Zhvillimin, raporti shqyrton *komponentë* të PFP, apo mënyrat e sigurimit të të ardhurave të paligjshme, si dhe *kanalet* me anë të të cilave ato lëvizin nëpër shtete, rajone, dhe më gjerë. PFP-të shpesh përzihen dhe pastrohen në kompani dhe ekonomi legjitime, apo fshihen në llogari bankare në parajsë financiare.

Duke qenë se ato gjenerohen nga akte kriminale, është thuajse e pamundur që PFP-të të studionen dhe të llogariten në mënyrë të hollësishme dhe të përpiktë. Ky raport është përpiluar falë intervistave me burime dhe personazhe të mirëinformuara nga qeveritë, shoqëria civile, dhe sektori privat, në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe nga analizimi i rasteve ku janë bërë publike prova dhe të dhëna, si pasojë e konfiskimeve, ngritjes së padive apo ndjekjeve ligjore, si dhe nga dokumentacione të institucioneve publike. Një sasi e konsiderueshme informacioni u mbledh nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore, që vuri në dispozicion të këtij studimi eksperiencën shumëvjeçare dhe përjetimet personale në lidhje me ekosistemin e kriminit që mundëson PFP-të.

Studimi u zhvillua në dy faza: një raund i parë intervistash me persona të mirëinformuar gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2019, dhe një cikël i dytë i analizimit të të dhënave në maj 2020. Në total, u zhvilluan më shumë se 60 intervista gjysmë të strukturuar. U zhvillua edhe një analizë e literaturës dhe medias në tre gjuhë, anglisht, shqip, dhe maqedonisht, që përfshinte raporte dhe të dhëna kombëtare, raporte dhe analiza ndërkombëtare, duke përfshirë edhe raporte të MONEYVAL dhe raporte mbi procesin e anëtarësimit në BE, si dhe raportime nga organe mediatike lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Puna kërkimore në terren tregoi se terminologjia e 'prurjeve financiare ndërkombëtare' nuk njihet mirë në këtë rajon. Shumë nga të intervistuarit nuk i kuptonin menjëherë disa nga termat, dhe të gjithë pjesëmarrësit në studim kishin përkufizime dhe interpretime të ndryshme të këtij problemi. Kjo mund të shkaktojë probleme në lidhje me aftësinë për të ngritur struktura dhe strategji për të luftuar PFP-të në mënyrë të integruar dhe të gjithanshme. Sidoqoftë, task forca e UNCTAD-UNODC mbi prurjet e paligjshme ka nënvizuar faktin se përqasja e PFP ka të bëjë më shumë me sferën konceptuale, sesa atë praktike: është hartuar një fjalor i përgjithshëm për të kuptuar dhe shpalosur më mirë ndërthurjet dhe ndërveprimin në ekosistemin e krimit, por nga ana tjetër, ndërhyrjet e natyrës teknike duhet të jenë më specifike në varësi të komponentëve dhe kanaleve në terren.²

Raporti nxjerr shtatë konkluzione bazë në lidhje me PFP-të në rajon, dhe del në përfundimin se debati në lidhje me prurjet e paligjshme financiare duhet të përfshijë edhe përballjen me ekosistemin e korrupsionit dhe krimit, dhe duhet të mobilizohet mbështetja popullore për ndryshimin e kulturës së qeverisjes dhe shpërndarjes së pasurisë në rajon.

Konkluzione kryesore

1. Të gjitha të dhënat sugjerojnë se PFP janë përhapur në shkallë të gjerë, dhe se ato mundësohen nga një sërë faktorësh strukturorë në vendet e rajonit: integrimi i tyre; shkalla e lartë e informalitetit në ekonomi, që llogaritet se përfaqëson 30–40 për qind të ekonomisë në të tre vendet; si dhe dobësia e përgjithshme e shtetit, institucioneve shtetërore dhe kulturës demokratike. Nga pikëpamja gjeografike, rajoni ka shërbyer për një kohë të gjatë si korridor lidhës midis Azisë dhe Evropës për trafikimin e drogës, emigrantëve, dhe një game të gjerë mallrash. Pavarësisht nga përparimet e natyrës teknike në lidhje me hartimin e miratimit të masave kundër pastrimit të parave, luftës kundër financimit të terrorizmit (APP/BFT), dhe miratimit të masave kundër korrupsionit dhe përmirësimit të nivelit të transparencës, problemet sistemike në këto vende sabotojnë zbatimin e masave dhe arritjen e rezultateve konkrete.
2. Ka një ndryshim shumë të madh midis shkallës së mundësive në ekonominë e krimit dhe ekonomisë së ligjshme. Në një rajon ku të ardhurat mujore mesatare shkojnë nga 400 deri në 600 euro, dhe niveli i papunësisë për rininë e kalon shifrën prej 20 për qind, trafikimi i drogave tranzit nëpër rajon është llogaritur se shkon në qindra milionë euro në vit, vetëm për Shqipërinë. Duke patur parasysh edhe kontekstin që u përmend në pikën e mësipërme, ekonomia e paligjshme natyrisht që ofron më shumë mundësi e të ardhura se sa ekonomia legjitime.
3. PFP mundësohen gjithashtu edhe nga nivele të larta korrupsioni, që prekin të gjitha nivelet e shtetit, dhe që variojnë nga mitmarrja për favore e shërbime deri tek korrupsioni me fonde e investime publike. Ryshfetet dhe përqindjet konsiderohen si avantazhe të postit, dhe personazhe me lidhje të forta politike kanë akses të privilegjuar në sektorë fitimprurës dhe gëzojnë mbrojtje politike për interesat e tyre.

Duke parë edhe nivelin e lartë të pandëshkueshmërisë në shtet, qytetarët e thjeshtë nuk i kushtojnë rëndësi të madhe respektimit të ligjit. Analiza dhe vlerësime të ndërmarra kohët e fundit nga organizata ndërkombëtare tregojnë se qeveritë në rajon janë angazhuar në mënyrë aktive në marrjen e masave drejt reduktimit të kontrollit të institucioneve të pavarura mbi qeverisjen, po dobësojnë sistemin e kontrollit dhe balancave, dhe po sabotojnë përpjekjet për transparencë dhe dhënie llogarie. Këtu përfshihen edhe sulme ndaj mediave të pavarura dhe reduktimi i hapësirave për shoqërinë civile.

4. Financimi i partive politike është një hallkë veçanërisht e dobët në zinxhirin e përpjekjeve anti-PFP dhe strategjive të tjera zhvillimi, dhe nuk ka shenja të ndonjë ndryshimi pozitiv. Ndonëse ka kufizime në lidhje me shumat që mund të jepen nga donacione private, këto rregulla nuk monitorohen aq sa duhet, dhe mund të shmangen me lehtësi. Përveç akuzave dhe raportimeve të pakonfirmuara për “valixhe me para” që u jepen politikanëve, janë zbuluar edhe të dhëna e informacione që tregojnë për manipulime financiare nga ana e krimit të organizuar, dhe faktorëve të tjerë të brendshëm e të jashtëm, në jetën politike të të tre vendeve. Është e qartë se figurat politike që mbështeten nga elemente e grupe të dyshimta do t'i kushtojnë shumë më pak vëmendje elektoratit të tyre.
5. Në të tre vendet, shumica e transaksioneve kryhet me para në dorë, madje edhe pagesa miliona dollarëshe me para në dorë për apartamente luksoze konsiderohen si diçka normale. Kjo tregon natyrën informale të ekonomisë, dhe mënyrat e përdorura nga individë e kompani për të shmangur apo reduktuar tatimet që duhet t'i paguajnë shtetit. Ky lloj sistemi krijon pengesa serioze për masat APP/BFT, dhe ndërhyrjet e tjera legjislative për të siguruar integritetin e sistemit financiar. Duke qenë se origjina e pagesave me para në dorë nuk mund të monitorohet, këto transaksione mbeten jashtë vëmendjes dhe kontrollit të sistemit financiar. Ky është një avantazh i madh për ata që duan të pastrojnë para të pista, si brenda vendit ashtu edhe në rang ndërkombëtar. Llogaritet se shuma e parave që kalojnë në mënyrë të paligjshme kufijtë e shteteve është e madhe – kohët e fundit janë kapur persona që transportonin më shumë se nga një milion euro në makina private – por duket se parandalimi i trafikimit fizik të parave nuk është prioritet për forcat e zbatimit të ligjit, dhe agjencitë e kontrollit të kufirit.
6. Pastrimi i parave kryhet nëpërmjet metodave dhe mënyrave të ndryshme, veçanërisht nëpërmjet investimeve në prona të paluajtëshme. Ky proces nis me financimin e ndërtimeve të reja për zyra apo ambiente banimi, vazhdon me financimin e kontratave të ndërtimit dhe raportimin e shifrave më të ulëta për kostot e punës në ndërtim, dhe më pas vazhdon me shitjen e ndërtesës së përfunduar. Bashkëpunimi në këto forma aktiviteteve të paligjshme është identifikuar përgjatë gjithë zinxhirit, duke përfshirë firma ndërtimi, agjenci të pasurive të paluajtëshme, noterë, avokatë e bankierë.
7. Dy nga tre vendet që studiohen në këtë raport i kanë përmbushur kriteret e kërkuara për të vazhduar më tej procesin e anëtarësimit në BE. Kjo është një arritje shumë e rëndësishme. Sidoqoftë, një vëzhgim më i thelluar në këtë drejtim – veçanërisht për sa i përket numrit të procedimeve të suksesshme penale – nxjerr në pah problemet dhe mangësitë e instrumenteve dhe institucioneve. Për të arritur rezultate në reduktimin e PFP është e nevojshme që të luftohet informaliteti, të ndryshohet mendësia që i quan diçka normale korrupsionin dhe politikat klienteliste, dhe duhet të shkatërrohen rrjetet e mbrojtjes dhe tutelës në majë të sistemit politik.



© Yordan Simeonov/AFP
nga Getty Images

HYRJE

Njohja në thellësi e problemit, dhe përlogaritja e PFP në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut është një sfidë serioze, pasi nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht mbi këtë fenomen, dhe nuk ka një tregues të veçantë që të paraqesë një tablo të plotë të situatës. Duke qenë se janë veprimtari ilegale, është e vështirë që të identifikohen dhe gjurmohen këto prurje. Sidoqoftë, të gjitha të dhënat e mbledhura tregojnë se ky problem është shtrirë në shkallë të gjerë, dhe situata po përkeqësohet. Në vitin 2015, Integriteti Global Financiar (Global Financial Integrity – IGF) përlogariti se prurjet e paligjshme mund të arrijnë deri në 5.9 për qind të PBB për rajonin,³ që është proporcionalisht më i madh se prurjet e paligjshme në nivel global, që llogaritet se shkojnë nga tre deri në pesë për pind të PBB botërore.⁴

PFP promovojnë sjellje kriminale dhe akumulimin e përfitimeve të pamërituara. Këto prurje i krijojnë mundësi elitave të pasura të papërgjegjshme, dhe elementëve kriminalë, që të pastrojnë paratë e fituara në mënyra të paligjshme, të shmangin pagimin e taksave, të përdorin pushtetin politik për përfitime personale, të fshehin pasuritë e tyre, dhe të kalojnë pronësinë tek pasardhësit e tyre duke evituar pagesën e taksave. Në këtë mënyrë sabotohen përpjekjet për të reduktuar pabarazinë sociale, reduktohet aftësia e qeverisë për të zbatuar politika zhvillimi dhe shpërndarje të drejtë të pasurisë, si dhe pengohet seriozisht respektimi dhe zbatimi i rendit ligjor.

Për këtë arsye Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) kanë identifikuar PFP si një kërcënim serioz për qeverisjen dhe drejtësinë anëmbanë botës. Pika 16.4 kërkon që, '[deri në vitin] 2030, duhet të reduktohen ndjeshëm prurjet financiare të paligjshme dhe trafiku i armëve, të forcohet konfiskimi dhe kthimi i mallrave dhe pasurive të vjedhura, si dhe të luftohen të gjitha format e krimit të organizuar'.⁵

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është përcaktuar si një nga parakushtet më të rëndësishme për anëtarësimin në BE, një objektivi gjeopolitik që vendet e Ballkanit perëndimor e kanë ndjekur për shumë vite me radhë. Sipas opinionit të BE-së, këto vende tregojnë shenja të qarta të kapjes së shtetit, duke përfshirë edhe lidhje me krimin e organizuar, dhe korrupsion në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës,




FIGURA 1 Rajoni i Ballkanit perëndimor, gjashtë shtetet

si dhe ngatërrim të interesave publike dhe private. E gjithë kjo situatë krijon një ndjesi pandëshkueshmërie dhe pabarazie sociale. Po kështu kemi të bëjmë edhe me ndërhyrje politike në media dhe kontroll të organeve mediatike. Një sistem juridik i fortë dhe i pavarur, qeveri dhe administrata të përgjegjshme, janë faktorë thelbësorë për të realizuar ndryshimet e nevojshme shoqërore.⁶

Raporti mbi procesin e zgjerimit të BE-së vëren gjithashtu se 'ekonomitë e rajonit nuk janë kompetitive, ndikohen tepër nga ndërhyrjet politike, ndërsa sektori privat është i pazhvilluar'.⁷ Procesi i anëtarësimit kërkon si parakusht që të forcohet shteti ligjor dhe konkurrenca, duke përfshirë këtu uljen e nivelit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Baza legjislative dhe rregullat e BE-së parashtrojnë një sërë objektivash që duhet të arrihen nga secili prej vendeve të Ballkanit perëndimor, përpara se të merret në konsideratë anëtarësimi i tyre.⁸

Sidoqoftë, pavarësisht nga investime të konsiderueshme nga BE dhe partnerë të tjerë, një analizë e thjeshtë e situatës tregon se Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut kanë mbetur shumë prapa në përmbushjen e kriterëve të OZHQ-së. Paratë qarkullojnë në mënyrë të paligjshme në të gjitha drejtimit, nga brenda dhe jashtë Ballkanit perëndimor, duke krijuar një ekosistem krimi, korrupsioni dhe evazioni fiskal nga kompani private, që krijojnë hapësira për lulëzimin e PFP-ve në shkallë të gjerë.

Prurjet e paligjshme në vendet e Ballkanit perëndimor janë të shumanshme, të shumëllojshme dhe përbëjnë një përqindje të madhe të PBB. Pavarësisht kësaj, ky term përdoret shumë pak në këto vende, dhe fenomeni nuk është studiuar aq sa duhet. Kjo vjen pjesërisht nga fakti se kemi të bëjmë me një koncept të ri, që është kristalizuar pas shumë vitesh përpjekje, në lidhje me përmirësimin e bazës ligjore APP/CTF, dhe kundër krimit ekonomik në rajon.

Paratë qarkullojnë në mënyrë të paligjshme brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit perëndimor, në një ekosistem krimi, korrupsioni dhe evazioni ekonomik që lejon hyrjen e prurjeve të paligjshme në përmasa shumë të mëdha.

Avantazhi i konceptit të PFP është fakti se, ai përmbledh në një të gjithë ekosistemin e sjelljeve kriminale dhe korruptive që dëmtojnë reputacionin e ekonomive të këtyre vendeve. Ky koncept ka të bëjë në rradhë të parë me zhvillimin e vendit – është krijuar për të vënë në dukje dëmin që shkaktojnë prurjet e paligjshme ndaj qeverisjes, zhvillimit social-ekonomik, varfërisë dhe pabarazisë.

Çfarë janë PFP?

Ka patur disa përkufizime për PFP dhe modifikime të tyre ndër vite, por dhe sot e kësaj dite këto përkufizime mbeten shumë të gjera, të paqarta dhe të kontestuara, megjithëse ato janë bërë pjesë e kornizave politike botërore me rëndësi, si OZHQ. Termi mbulon si një ombrellë konceptuale një gamë të gjerë kërcënimesh e problemesh në rang kombëtar e ndërkombëtar, mbi aktivitete brenda një spektri të caktuar të shkëmbimeve të paligjshme tregtare dhe financiare ndërkombëtare.⁹ Mungesa e një përkufizimi të pranuar ligjërish nuk është thjesht një problem akademik. Ky konfuzion konceptual përbën një pengesë serioze gjatë studimit dhe analizës së fenomenit, si dhe për hartimin e politikave dhe programeve për t'iu kundërvënë këtij problemi.

Kjo u vu re edhe gjatë përpilimit të këtij raporti, pasi termi PFP duhet që t'iu shpjegohej vazhdimisht personave të intervistuar. Disa nga bashkëbiseduesit e konsideronin PFP si një sinonim të 'pastrimit të parave' apo 'krimit të organizuar,' gjë që vështirësonte procesin e intervistave. Keqkuptime në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e problemit rezultuan në një sërë përlogaritjesh kontradiktore mbi nivelet proporcionale të PFP në rajon, pasi bashkëbiseduesit kishin prirje që t'i mëshonin më fort fushës së tyre të ekspertizës. Për shembull, një zyrtar doganash sugjeroi se më shumë se 95 për qind e PFP-ve vinin si pasojë e manipulimit me faturat e ngarkesave të mallrave, ndërsa një zyrtar i njësisë anti-drogë kishte mendimin se e njëjta përqindje shkaktohej nga trafikimi i drogës.

Ky raport përdor përkufizimin e OKB-së për prurjet e paligjshme: 'para që fitohen, shpenzohen apo transferohen në mënyrë të paligjshme, dhe që kalojnë kufijtë e shteteve' dhe janë të ardhura që dalin kryesisht nga tre burime: aktivitete kriminale, korrupsioni, dhe evazioni fiskal.¹⁰




FIGURA 2 Komponentët dhe kanalet e PFP

BURIMI: Financimi për zhvillim: Përparime dhe programe. Raport i Task Forcës për Financimin e Zhvillimit 2017, <https://developmentfinance.un.org/illicit-financial-flows>

Prurjet financiare mund të jenë të paligjshme për tre arsye: që nga fillimi, kur vijnë si rezultat i aktivitetit kriminal; kur paratë e fituara në mënyrë të ligjshme transportohen apo transferohen nëpër sistemin financiar në mënyra të paligjshme, dhe kur përdoren për qëllime korruptive; ose kur pastrohen apo transferohen në vende të tjera.

Kjo tregon edhe vështirësinë e përlogaritjeve të sakta të vlerave monetare të PFP-ve. Duke qenë se ka disa hallka në këtë zinxhir ku mund të përlogaritet vlera e tyre, ekziston gjithmonë rreziku i numërimit të dyfishtë. Duke u nisur prej kësaj, mund të ketë të drejtë si zyrtari i doganave, ashtu edhe oficeri i njësisë anti-drogë. Ka shumë të ngjarë që të ardhura të paligjshme nga trafiku i drogës të përdoren për të korruptuar zyrtarë të administratës, dhe më pas të pastrohen në vende të tjera nëpërmjet

manipulimit me faturat e mallrave. Për këtë qëllim, koncepti PFP ka vlerë të madhe si instrument analitik. Duke përmbledhur në një pikë të vetme ekosistemin e krimit të organizuar, korrupsionit, dhe krimit ekonomik, ai mbulon të gjitha mënyrat me anë të të cilave mund të ndikohet negativisht në ekonomi, duke dëmtuar zhvillimin e vendit.

Në mënyrë që të analizohen PFP-të në vendet e Ballkanit perëndimor, ky raport do të bëjë një analizë në dy faza, që ndiqet edhe nga Task Forca e OKB mbi Financimin për Zhvillim (figura 2). Në fillim analizohen tre *komponentë* kriminalë të PFP – korrupsioni, krimi i organizuar, dhe aktivitete që lidhen me evazionin fiskal – dhe më pas katër *kanalet* e PFP: pastrim parash, manipulim me faturat, transportimi i parave, dhe kanalet për llogaritë e kapitalit.

Metodologjia

Ashtu si u përmend edhe më lart, një tablo e plotë në lidhje me PFP nuk mund të krijohet nga analizi i vetëm një prej treguesve tregtarë apo financiarë. Është e nevojshme që të analizohen një sërë treguesish sasiorë dhe vlerësime të situatës që të shpaloset dhe kuptohet natyra komplekse e fenomenit. Në fakt, Task Forca e UNCTAD-UNODC mbi prurjet e paligjshme arriti në përfundimin se, duke patur parasysh komponentët dhe kanalet e shumtë që përbëjnë konceptin PFP, do të ishte më mirë që ky problem të mos merrej në analizë si një çështje e vetme, por të studiohej si një ekosistem i fenomeneve të ndërlidhura me njëri-tjetrin.¹¹

Metodologjia e përdorur për këtë raport shfrytëzon një sërë burimesh. Ajo bazohet në punë kërkimore në terren me më shumë se 60 intervista të gjysmë-strukturuara që u zhvilluan gjatë periudhës dhjetor 2019 dhe maj 2020 me punonjës bankash, oficerë të forcave të rendit, pjesëtarë të njësive informative financiare (NJIF), prokurorë, gazetarë, e të tjerë. Skema në figurën 3 paraqet një tablo të përgjithshme të kategorive të personave të intervistuar për këtë raport.




FIGURA 3 Kategoritë e personave të intervistuar, n = 65

*PFP në Ballkanin
perëndimor janë
të shumëllojshme
dhe në përmasa
shumë të mëdha në
krahësim me PBB.*

Puna në terren u pasurua me analiza dhe materiale nga literaturë sekondare, raporte vlerësimi të institucioneve qeveritare, si dhe udhëzime e statistika administrative. Kërkesa për informacion në kuadër të lirisë së informimit iu dërguan autoriteteve përkatëse për informacione shtesë, me rezultate të ndryshme. Kosova paraqiti vështirësi të theksuara pasi kishte më pak informacion në dispozicion. Si pasojë e statusit politik të pazgjidhur ende, Kosova nuk paraqitet gjithnjë si njësi më vete në studimet rajonale që organizohen nga OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Grupi kryesor i kërkimit përbëhet nga nëntë studiues nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut, me eksperiencë të madhe në analizimin e krimit të organizuar, korrupsionit, PFP, dhe aktiviteteve të lidhura me pastrimin e parave. Një grup analistësh nga GI-TOC rishikuan të gjitha të dhënat për t'u siguruar mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, dhe bënë koordinimin e të dhënave cilësore dhe sasiore. Raporti u rishikua nga ekspertë të brendshëm rajonalë të GI-TOC, dhe ekspertë mbi PFP, që ndihmuan edhe në hartimin e rekomandimeve.

Ndonëse PFP shpesh konsiderohen vetëm në bazë të vlerave monetare, është e rëndësishme që të kemi parasysh elementet që u përmendën më lart. Ka shumë të ngjarë që numrat të paraqesin vetëm një pjesë të problemit, pasi komponentë të ndryshëm të prurjeve të paligjshme nuk mund të krahasohen me njëri tjetrin, llogaritja e pëmbledhur nga të dhëna që vijnë nga kanale të ndryshme mund të rezultojë në numërim të dyfishtë dhe fryrje të shumave, dhe e gjithë kjo mund të ndikojë negativisht mbi analizën e efektshme, dhe hartimin e politikave për t'iu kundërvënë PFP.¹²

Për këtë arsye, ky raport nuk ka për qëllim që të paraqesë një tablo të përgjithshme të nivelit të prurjeve të paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Në fakt, ky raport bën një analizë politiko-ekonomike të faktorëve dhe prirjeve kryesore që krijojnë hapësira dhe mundësi për PFP në rajon, në mënyrë që të ndihmojë për një njohje më të mirë të fenomenit, dhe krijimin e një baze të shëndoshë për marrjen e masave më të forta.



© T Miettinen/Shutterstock

KONTEKSTUALIZIMI I PFP NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Qëllimi i këtij kapitulli është analizimi i disa prej elementeve kryesore ekonomike, kriminale dhe qeverisëse në Ballkanin perëndimor, që e ekspozojnë këtë rajon ndaj rrezikut të PFP. Sipas kësaj analize, struktura e ekonomisë, veçanërisht niveli i informalitetit, mundëson prurjet e paligjshme.

Intervistat me ekspertë identifikuan elemente dhe tipare sociale, ekonomike dhe qeverisëse në Ballkanin perëndimor që e kanë përkeqësuar situatën në rajon në lidhje me PFP. Ekspertët nënvizuan veçanërisht faktin se ndërlidhja e ngushtë midis të tre vendeve e vështirëson shumë punën e hartimit dhe zbatimit të zgjidhjeve në nivel kombëtar. Ky është një rajon që ka njohur të njëjtën ideologji politike dhe pasojat që erdhën më pas, ka përjetuar një konflikt të tejzgjatur që vazhdon të shkaktojë pasiguri e destabilizim, dhe ka lënë gjurmë të thella, ndërkohë që prurjet e paligjshme janë një "problem me spec"¹³ që janë integruar tërësisht me këtë realitet të vështirë.

Pozicioni strategjik i Ballkanit perëndimor është një nga faktorët kryesorë për këtë situatë. Ky rajon përshkruhet shpesh si urë lidhëse ndërmjet Azisë dhe Evropës perëndimore, dhe kjo zonë është një segment i Rrugës së Mëndafshit, një korridor i lashtë për transportimin e mallrave dhe njerëzve. Investime të mëdha në infrastrukturë gjatë viteve të fundit – kryesisht falë iniciativës kineze Rrugë e Porte (Belt and Road Initiative) – kanë intensifikuar rrjedhën e mallrave dhe njerëzve nëpër rajon, duke ndihmuar si tregtinë e ligjshme ashtu dhe trafiqet e paligjshme.

Ashtu si ndodh kudo nëpër botë, edhe ekonomia kriminale e Ballkanit perëndimor zhvillohet nën hijen e ekonomisë së ligjshme, dhe për pasojë zhvillimi i tregtisë botërore dhe globalizimi ka ndihmuar në lulëzimin e krimit të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor. Edhe emigrantë trafikohen nëpër këtë rajon në rrugëtimin e tyre drejt




FIGURA 4 Përlllogaritje e aktivitetit ekonomik në sektorët formalë dhe informalë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut (për qind e PPB)

BURIMI: Ernst dhe Young,

Evropës perëndimore.¹⁴ Drogat, veçanërisht heroína afgane, kalojnë nëpër korridorin ballkanik drejt veri-perëndimit, ndërsa kokainë arrin nga Amerika Latine në Shqipëri dhe Mal të Zi nga deti.¹⁵ Po kështu, avionë përdoren për transportimin e drogave në të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor.¹⁶ Më pas kjo drogë trafikohet drejt perëndimit, në vendet e BE-së dhe Britanisë së Madhe, si dhe drejt lindjes për në Rumani, Turqi, dhe vende të tjera.¹⁷ Kanabis prodhohet dhe shpërndahet gjerësisht,¹⁸ ndërsa drogat sintetike kalojnë nëpër rajon (dhe përpunohen më tej në Ballkan) drejt Turqisë dhe vendeve të tjera në lindje. Po kështu, ka raportime të shumta mbi trafikimin e armëve, aktivitet të dendur falsifikimi, tregtim të mallrave të paligjshme, duke përfshirë cigare, që prodhohen dhe trafikohen nëpër rajon.¹⁹

Ashtu si tregohet edhe në figurën 4, një përqindje e lartë e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit perëndimor zhvillohet në ekonominë informale, gjë që shfrytëzohet nga ekonomia e paligjshme për qëllimet e saj.

Me informalitet kuptojmë aktivitet ekonomik që i shmanget mbikqyrjes së institucioneve kombëtare financiare dhe rregullatore. Për pasojë, transaksionet e biznesit informal kryhen me para në dorë apo nëpërmjet mekanizmave informale të transfertave të parave, si havala. Në vendet e Ballkanit perëndimor, paratë e thata përdoren gjerësisht edhe në pjesën më të madhe të transaksioneve ditore në ekonominë legjitime.²⁰ Kjo krijon hapësira të gjera loje për lëvizjen e fondeve të paligjshme.

Aktiviteti ekonomik informal u zhvillua ndjeshëm gjatë periudhës së tranzicionit të pasluftës, kur trafikimi ndërkufitar mori një rëndësi të veçantë gjatë procesit të shtetformimit në republikat e ish-Jugosllavisë.²¹

Edhe sot e 20 vjet më vonë, kjo trashëgimi vazhdon të ketë ndikimin e saj mbi ndërvlerësinë e ekonomive të Ballkanit perëndimor nga njëra-tjetra, kontrollin e dobët të kufijve, dhe ngulitjen thellë të mendësisë për pasurim të shpejtë pa punuar, në ekonominë informale dhe të paligjshme, nga elementë të lidhur me krimin, apo nga zyrtarë shtetërorë (që nganjëherë janë i njëjti person).

Ashtu si paraqitet edhe në figurën 4, informaliteti në Shqipëri përfaqëson 30–40 përqind të ekonomisë. Në Kosovë, ekonomia informale është llogaritur se përbën 31.7 për qind të PBB, nga e cila 8 për qind ka të ngjarë të përfaqësojë forma të paligjshme të aktivitetit ekonomik.²² Edhe në Maqedoninë e Veriut, ekonomia informale llogaritet të përbëjë rreth një të tretën e PBB.²³ Ndonëse nuk ka patur një përlllogaritje të ekonomisë së paligjshme në këtë vend, ka të ngjarë që të jetë në të njëjtin proporcion.

Një nga arsyt kryesore pse aktivitetet e paligjshme janë bërë kaq të përhapura në vendet e Ballkanit perëndimor ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve dhe integritetit të institucioneve shtetërore, që nuk kanë mbajtur dot ritmin e rritjes së nivelit të tregtisë dhe biznesit.

Raporte të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare e pranojnë dobësinë në nivele kritike të institucioneve shtetërore për të monitoruar aktivitetin financiar në ekonomi që dominohen nga biznese të vogla, me sisteme të varfra kontabiliteti dhe kontrolli. Në Shqipëri, për shembull, 88 për qind e kompanive janë regjistruar si 'biznes i vogël', që deklarojnë më pak se 60,000 euro të ardhura në vit, dhe që kanë më pak se katër punëtorë. Në Kosovë, më shumë se 90 për qind e bizneseve janë kompani të vogla dhe të mesme.²⁴ Duke patur parasysh problemet në raportim dhe

monitorim të ardhurash, këto biznese mund të shmangin kontrollin e autoriteteve tatimore.²⁵

Po kështu, edhe niveli i ulët i rrogave mesatare në rajon është një nga faktorët kryesorë. Ashtu si tregohet në figurën 5, të ardhurat mujore mesatare shkojnë nga 400 deri në 600 euro në muaj, gjë që do të thotë se një pjesë e popullatës fitojnë më pak se kaq. Është e kuptueshme që këta persona do të mundohen të kompensojnë të ardhurat e tyre jashtë ekonomisë legjitime. Nivele të larta papunësie (në janar 2020: 11.6 për qind në Shqipëri, 21.5 për qind në Maqedoninë e Veriut, dhe 25.9 për qind në Kosovë²⁶), dhe aftësia e dobët blerëse, i shtojnë shumë të rinj që të kërkojnë mundësi të tjera në ekonominë informale dhe të paligjshme.

Në të treja vendet dominon sektori i shërbimeve. Në vitin 2018, shkëmbimet tregtare në sektorin e shërbimeve përbënin 55.1 për qind të PBB në Maqedoninë e Veriut²⁷, dhe 29.3 për qind në Shqipëri.²⁸ Këto vende kanë gjithashtu sektorë bujqësorë të rëndësishëm për ekonominë: bujqësia në Shqipëri përbënte 18.4 për qind të PBB për vitin 2018, që ishte niveli më i lartë i bujqësisë në PBB për vendet e Ballkanit perëndimor dhe në Evropë.²⁹ Sektori i përgjithshëm industrial, që përfshin edhe ndërtimin, përbënte rreth 23.6 për qind të PBB për Maqedoninë e Veriut, dhe 21.3 për qind për Shqipërinë.³⁰ Ndërtimi dhe pronat e paluajtëshme përbënin 26.3 për qind të PBB në Kosovë.³¹

TREGUES	SHQIPËRI	KOSOVË	MAQEDONI E VERIUT
Popullsia (milione) (2018) ³²	2.87	1.85	2.8
PBB (US\$ miliardë) (2018) ³³	15.10	7.94	12.67
Rritja e PBB (2018) ³⁴	4.1 për qind	3.8 për qind	2.7 për qind
PBB për person (US\$) (2018) ³⁵	5 268.8	4302.3	6083.7
Importe (për qind e PBB) (2018) ³⁶	45.40	55.60	72.90
Eksporte (për qind e PBB) (2018) ³⁷	31.70	26.40	60.30
Ekonomia informale ³⁸	33 për qind (2018)	30 për qind (2016)	30–33 për qind (2018)
Rroga mesatare mujore (€) (2019) ³⁹	400–450	475–525	550–670
Papunësia ⁴⁰	13.8 për qind (2017)	29.4 për qind (2018)	20.7 për qind (2018)
Emigrimi (për 1,000 banorë) ⁴¹	–7 (2017)	–8.90 (2016)	–0.50 (2017)
Renditja në Treguesin e Perceptimit të Korrupsionit (2019) ⁴²	106/198	101/198	106/198

FIGURA 5 Treguesit kryesorë për Ballkanin perëndimor

Ekonomia e rajonit është shumë e varur nga remitancat, apo paratë që sjellin emigrantët. Shuma të mëdha parash hyjnë në rajon nga shtetas që jetojnë dhe punojnë në Evropën perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara, dhe një pjesë e madhe e këtyre fondeve vjen në para të thata, apo nëpërmjet shërbimeve financiare jo-bankare.

Në vitin 2018, Banka e Shqipërisë raportoi se 1.15 milionë shqiptarë nga jashtë vendit dërgojnë rregullisht para në vendin e tyre, duke siguruar mbështetje financiare për më shumë se një të katërtën e familjeve shqiptare. Në vitin 2017, remitancat shqiptare arritën shifrën 1.16 miliardë euro, nga të cilat 39 për qind u dërguan në para të thata, dhe 57 për qind nëpërmjet shërbimeve financiare jo-bankare.⁴³ Numri total i remitancave të dërguara në Maqedoninë e Veriut u përlogarit në shifrën 318 milionë për vitin 2018, dhe po ashtu pjesa më e madhe e këtyre fondeve hyri në vend nëpërmjet kanaleve informale.⁴⁴ Nga të tre shtetet, Kosova është vendi ku remitancat luajnë

rolin më të madh, përse i përket burimit të të ardhurave për qytetarë e biznese.⁴⁵ Banka Kombëtare e Kosovës raportoi se 800 milionë euro hyjnë në vend çdo vit, ndërsa ministria kosovare për diasporën përlogarit se remitancat mund të arrijnë deri në 1.5 miliardë euro, që është e barabartë me 70 për qind të të ardhurave të shtetit.⁴⁶

Ndonëse remitancat janë kontribut i rëndësishëm dhe pozitiv për rajonin, niveli i lartë i tyre dhe shkalla e informalitetit krijojnë shumë mundësi maskimi për kalimin e fondeve të paligjshme pa u diktuar. Duke qenë se është e pamundur që të matet apo monitorohet prejardhja e fondeve të remitancës, ka shumë mundësi që të ardhura kriminale të bashkohen me rrymën e parave. Studime globale dhe eksperiencat nga vende të tjera në lidhje me remitancat rekomandojnë me forcë që transfertat e të ardhurave nga emigrantët të kalojnë nëpër sistemin e rregullt financiar.⁴⁷



Tipare të qeverisjes

Protestë përpara godinës së kryeministrit në Tiranë, 2019. Elemente të qeverisjes politike në rajon janë shumë të dobëta.

© Armend Niman/AFIP nga Getty Images

Megjithëse vendet e Ballkanit perëndimor kanë shumë pika të përbashkëta me demokracitë e forta të Evropës perëndimore, dhe aspirojnë që të arrijnë standardet e tyre, demokracitë e tyre janë akoma të reja dhe të brishta. Vetëm dy dekada më parë ky rajon ishte përfshirë në konflikte të dhunshme, dhe problemet që erdhën më pas, si kapja e shtetit, korrupsioni, klientelizmi, si dhe tendenca për të anuar nga autoritarizmi, e vështirësojnë rrugën drejt demokracisë.⁴⁸ Kosova, që ka hedhur hapa mahnitës përpara, filloi të funksiononte si territor i pavarur në vitin 2008, duke patur shumë pak kohë për të ngritur institucione shtetërore të pasluftës dhe një kulturë shoqërore për formimin e një shteti ligjor të efektshëm.

Integriteti elektoral ka rëndësi kritike për barazinë e përfaqësimit në një qeverisje demokratike dhe pushtetin e ligjit, si dhe për të siguruar që zyrtarët e zgjedhur të jenë të vëmendshëm ndaj dëshirave dhe nevojave të qytetarëve të tyre.⁴⁹ Zgjedhje paqësore, të lira e të ndershme, kanë po ashtu rëndësi kritike për hyrjen në BE për vendet e Ballkanit perëndimor. Por ndërkohë që kanë arritur të organizojnë zgjedhje shumëpartiake paqësore,⁵⁰ vihet re një mungesë e theksuar transparence në financimet e forcave politike, dhe boshllëk në bazën ligjore për financimin e partive politike. Këto mangësi mund të monetarizojnë dhe korruptojnë politikën me anë të financimit sekret të politikanëve nga krimi i organizuar apo interesa të tjera të paligjshme, duke rezultuar kështu në një sistem politik që nuk interesohet për zhvillimin e vendit dhe nevojat e elektoratit.⁵¹ Në demokracitë relativisht të reja në vendet e Ballkanit perëndimor, kjo situatë përkeqësohet nga klientelizmi, duke qenë se edhe partitë politike ndërtohen rreth personaliteteve, dhe jo mbi ideologji.⁵²

Legjislacioni i të tre vendeve që studiohen në këtë raport lejon një kombinim të fondeve publike e private për financimin e partive politike dhe fushatave elektorale. Sidoqoftë, fondet publike janë të pakta, dhe kandidatët politikë e marrin shumicën e fondeve nga pagesa e kuotave të anëtarësimit në parti, dhe kontribute nga individë, kompani private dhe grupe interesi, si të brendshëm ashtu dhe të jashtëm. Shqipëria ka vendosur një kufi për kontribute në shifrën një milionë lekë (8,000 euro) për kandidat në fushata elektorale; ndërsa në Kosovë, partitë politike nuk mund të marrin më shumë se 10,000 euro në vit në donacione. Të gjitha partitë janë të detyruara që të raportojnë burimin e fondeve brenda një periudhe të parashikuar me ligj.

Pavarësisht kësaj, dhënia e fondeve nga donacione private anonime po rritet në të gjithë rajonin. Këto shtete nuk kanë aftësi praktike të mjaftueshme për të bërë kontroll mbi financimet e fushatave elektorale,⁵³ dhe ka patur vazhdimisht akuza për shkeljen e rregullave në të tre vendet që analizohen në këtë raport. Në Kosovë, një ish-punonjës i Misionit të BE për Pushtetin e Ligjit (EULEX) deklaroi se partitë politike i fshehin financimet e tyre dhe se fondet që shpenzojnë në fushata elektorale i tejkalojnë shifrat e deklaruar prej tyre.⁵⁴ Në vitin 2018, Komisioni Evropian raportoi se revizione të pavarura që shqyrtuan financat e partive politike arritën në përfundimin se partitë 'kishin shuma të mëdha të paverifikueshme në donacione dhe shpenzime, shkelje të vazhdueshme të rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit financiar, kontrollit dhe raportimit, dhe u identifikuan raste të shkeljes së legjislacionit tatimor, dhe Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave'.⁵⁵ Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë ka kohë që kërkojnë reformë ligjore të financimit të partive politike, dhe forcimin e rolit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të monitoruar kostot dhe shpenzimet e fushatave. Legjislacioni aktual e ngarkon parlamentin me detyrën e zgjedhjes së revizorëve të jashtëm për ekzaminimin e financave të partive politike, gjë që paraqet një konflikt interesi për politikanët dhe revizorët e zgjedhur prej tyre për këtë punë. Përgjigja e qeverisë ishte dobësimi i Ligjit mbi Financimin e Partive Politike, një manovër që u kritikua ashpër.⁵⁶

Në qershor 2019, gazeta gjermane *Bild* shkaktoi një skandal politik në Shqipëri kur publikoi inçizime të dala nga prokuroria, që implikonin politikanë të njohur në manipulimin e votimeve në bashkinë e Dibrës në vitin 2016, dhe gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017. Këtu përfshihej bashkëpunimi me grupe kriminale për të blerë vota, presion ndaj mësuesve për të votuar për kandidatët e partisë, si dhe ndërhyrje policore ndaj votuesve që mendohej se ishin pro opozitës.⁵⁷ Po kështu,

në 2019, në një tjetër inçizim të dalë nga prokuroria, Vangjush Dako, kryetari i bashkisë së Durrësit, po bisedonte me Astrit Avdyllaj, një kriminel me emër, i arrestuar më parë për trafikim droge. Aty doli edhe roli që kishte luajtur banda e Avdyllajt në fushata elektorale, duke përfshirë edhe sigurimin e votave në rajonin e Shijakut dhe Durrësit.⁵⁸

Zgjedhjet e planifikuara në prill 2020 në Maqedoninë e Veriut u shtynë si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Sidoqoftë, edhe pa u zhvilluar zgjedhjet u vunë re parregullsi, duke përfshirë financimin e partive politike nga burime të panjohura dhe lidhje klienteliste me median. Opozita pretendoi se zyrtarë të qeverisë ishin përfshirë në blerje votash dhe kërcënime gjatë zgjedhjeve parlamentare në 2011 dhe 2014, si dhe gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013.⁵⁹ Ligji mbi Financimin e Partive Politike, që u ndryshua me një dekret në vitin 2018, rregullon marrjen e fondeve nga partitë politike. Institucioni i fortë dhe i pavarur i Kontrollit të Shtetit raportoi se kishte gjetur parregullsi, por hetimi i burimeve të financimit është detyrë e administratës tatimore, që njihet si institucion i dobët dhe që ndikohet politikisht.⁶⁰

Edhe fonde të huaja të paligjshme kanë hyrë në fushatat elektorale në vendet e rajonit, duke kryer rolin e dyfishtë të pastrimit të parave, dhe ushtrimit të ndikimit mbi axhendën politike. Një investigim i zhvilluar nga Projekti i Raportimit mbi Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (Organized Crime and Corruption Reporting Project) gjeti të dhëna se një aleat i kryeministrit hungarez Viktor Orbán futi më shumë se 3.2 milionë euro në Maqedoninë e Veriut nëpërmjet rrjetit të tij mediatic. Me pretekstin e blerjes së reklamave të pafajshme televizive për vaj ulliri dhe magnetë frigoriferi – produkte që nuk shiteshin në Maqedoninë e Veriut – kaloheshin shuma të mëdha parash, dhe kjo tërhoqi vëmendjen e policisë financiare që dyshonte se fonde të shtetit hungarez po pastroheshin nëpërmjet aktiviteteve politike që shiheshin me sy të mirë nga vetë Orbán.⁶¹

Vitet e fundit është vënë re një dobësim i ndjeshëm i sistemit të mbikqyrjes që duhet të garantojë integritetin e qeverisjes dhe parandalimin e korrupsionit. Raporti i vitit 2019 mbi treguesin e perceptimit të korrupsionit nga Transparency International arriti në përfundimin se të tre vendet janë shumë të korruptuara, dhe nënvizoi faktin se qeveritë po hedhin hapa për të sabotuar sistemin e llogaridhënies.⁶²

Këtu futen edhe hapa për reduktimin e hapësirave për shoqërinë civile dhe median. Shoqëria civile – duke përfshirë edhe gazetarë të pavarur dhe median, OJQ dhe OSHC, si dhe akademikët – është relativisht aktive në të

tre vendet, duke u munduar që ta detyrojë qeverinë që të respektojë standardet demokratike, të drejtat e njeriut, dhe pushtetin e ligjit. Lëvizje shoqërore, që organizohen nga grupe aktiviste dhe që shpesh lindin nga investigime të mediave të pavarura, kanë ushtruar presion në mënyrë të suksesshme për ndryshimin e elementeve të rëndësishme të bazës ligjore, duke përfshirë edhe transparencën politike dhe llogaridhënien. Sidoqoftë, një konferencë e zhvilluar kohët e fundit mbi shoqërinë civile dhe krimin e organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor, ku pati prezantime nga gjashtë shtete të Ballkanit perëndimor, doli në përfundimin se media është kapur nga interesa politike, si të brendshme ashtu dhe të jashtme. Shumica e radiove dhe televizioneve janë në pronësi të shtetit, ose janë nën ndikimin e politikanëve dhe aleatëve të tyre. Në të njëjtën kohë, gazetarë dhe media të pavarura po kalojnë një situatë të vështirë për gjetjen e të ardhurave dhe punojnë nën një presion të vazhdueshëm. Ato janë bërë

objekt abuzimesh, sulmesh kibernetike, dhe ngacmimesh ligjore që i detyrojnë të ushtrojnë autocensurë për të mos falimentuar.⁶³ Politikanët në të tre vendet njihen për denigrimin sistematik të gazetarëve, si dhe për ndërhyrjen dhe pengimin e raportimit të pavarur. Partitë qeveritare dhe opozitare përdorin gjerësisht dezinformacion dhe propagandë. Në raportin e viti 2019 për Treguesin e Lirisë së Shtypit, organizata Reporterët pa Kufij i renditi të tre vendet në kategorinë 'problematike' për lirinë e medias. Në Shqipëri, në veçanti, raporti vërejti se legjislacioni anti-shpifje i propozuar për miratim do të kufizonte lirinë e medias në internet, dhe do t'i ekspozonte gazetarët ndaj presionit qeveritar.⁶⁴

Në përgjithësi, debati mbi PFP dhe përpjekjet për të reduktuar këto prurje zhvillohet në kontekstin e një dobësie sistematike në qeverisje, që nga njëra anë mundëson elementë dhe sjellje kriminale, dhe nga ana tjetër pengon zbatimin e programeve për eliminimin e tyre.

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

- PFP mundësohen nga një sërë faktorësh në Ballkanin perëndimor:
 - pozita gjeografike si korridor për tregtinë e ligjshme dhe të paligjshme;
 - profili social-demografik me popullsi të re dhe nivel të lartë papunësie;
 - ekonomi informale masive që lejojnë kalimin e prurjeve të paligjshme.
- Kjo situatë përkeqësohet nga dobësitë në qeverisje, duke përfshirë:
 - nivele të larta korrupsioni;
 - procese demokratike të kompromentuara nga identitete politike të dobëta të partive kryesore, dhe kontroll i varfër mbi financimet politike;
 - hapësirë gjithnjë e më e kufizuar për zërin dhe opinionin e medias së pavarur dhe shoqërisë civile.
- Ka të dhëna se qeveritë po ndërmarrin hapa për të reduktuar vazhdimisht, në vend që të forcojnë, mbikqyrjen, transparencën, si dhe sistemin e kontroleve dhe balancave.



© Gent Shkullaku/AFP
nga Getty Images

KOMPONENTË TË PRURJEVE TË PALIGJSHME

Ky kapitull i raportit analizon shkurtimisht krijimin e PFP nëpërmjet aktiviteteve kriminale më të gjera, si korrupsioni dhe krimi i organizuar. Përhapja e gjerë e korrupsionit shihet si një nga sfidat më të mëdha për zhvillimin demokratik të të tre vendeve. Në mënyrë specifike, ky kapitull analizon nivelin dhe sasinë e fondeve të paligjshme që gjenerohen nga tre forma të krimit të organizuar: trafikimi i drogës, kalimi i paligjshëm i emigrantëve, dhe tregtia e paligjshme.

Ashtu si u përshkrua dhe më lart, jo të gjitha prurjet e paligjshme financiare krijohen nga aktivitete kriminale. Edhe para të fituara në mënyrë legjitime mund të kthehen në fonde të paligjshme gjatë kalimit të tyre në sistemin ndërkombëtar financiar. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e PFP lidhet me të ardhurat e paligjshme të korrupsionit, krimit të organizuar, dhe krimeve të lidhura me taksat. Vlerësimet e mekanizmit anti-pastrim parash të Këshillit të Evropës, MONEYVAL, tregojnë shkallën dhe ndikimin e PFP nga një sërë aktiviteteve kriminale në vendet e Ballkanit perëndimor, që mundësojnë financat e paligjshme në këtë rajon.

Krime të lidhura me korrupsionin

Ashtu si vëren Raporti i Treguesit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019, 'në të gjitha shtetet e rajonit ndarja e pushteteve nuk është e plotë, fonde shtetërore shfrytëzohen për qëllime elektorale, ka financime të dyshimta të partive politike, dhe konflikte interesi'.⁶⁵ Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut morën të gjitha nota më të ulëta se Treguesi i vitit të mëparshëm, ndërkohë që Shqipëria arriti nivelin më të ulët të pesë viteve. Ndërkohë që elitat manipulojnë sistemet politike, ekonomike dhe rregullatore për të akumuluar pasuri të konsiderueshme për veten e tyre, korrupsioni krijon një ekosistem kriminal. Pushteti i ligjit nuk funksionon pa mbështetjen e pushtetarëve.⁶⁶

Për qytetarët e të tre vendeve, nepotizmi, klientelizmi dhe mitmarrja janë pjesë përbërëse e çdo ndërveprimi të tyre me strukturat shtetërore, deri në atë pikë sa korrupsioni përshkruhet si pjesë e kulturës sociale. Besimi i njerëzve ndaj pushtetit të ligjit dhe institucioneve shtetërore është shumë i ulët, dhe perceptimi i nivelit të lartë të korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë e bën akoma më të lehtë për vetë qytetarët që të përfshihen në aktivitete të paligjshme. Nivele të larta papunësie (në janar 2020: 11.6 për qind në Shqipëri, 21.5 për qind në Maqedoninë e Veriut, dhe 25.9 për qind në Kosovë⁶⁷), dhe aftësia e dobët blerëse, i shtynë shumë të rinj që të kërkojnë mundësi të tjera në ekonominë informale dhe të paligjshme.

Korrupsioni është një komponent kyç i prurjeve të paligjshme. Në Ballkanin perëndimor, sipërmarrje kriminale dhe të paskrupullta krijojnë lidhje me politikanë me pushtet, zyrtarë të administratës dhe sistemit të drejtësisë, si dhe institucioneve të tjera shtetërore për të arritur qëllimet e tyre. Nëpërmjet ryshfeteve, ushtrimit të influencës, ndërmjetësimit, abuzimit me pushtetin, dhe shantazheve, ata fitojnë akses dhe njohuri mbi informacione konfidenciale në lidhje me plane pune apo hetime të forcave të ruajtjes së rendit dhe sistemit të drejtësisë. Ata marrin leje dhe licenca, koncesione dhe kontrata me fonde publike, si dhe sigurojnë që trafikimi i mallrave të tyre nëpër kufij të vazhdojë i pandërprerë dhe i pakontrolluar. Pushteti i ligjit sabotohet akoma më tej si pasojë e pengesave që i vendosen sistemit të drejtësisë, si frikësimi i dëshmitarëve.

Ndonëse korrupsioni është problem në të gjithë botën, ky fenomen është veçanërisht i dëmshëm në vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion. Korrupsioni i shfrenuar dëmton legjitimitetin dhe efektshmërinë e institucioneve shtetërore, kompromenton përpjekjet për të arritur zhvillim të qëndrueshëm, thellon pabarazinë në të ardhura, dhe pengon investimet produktive. Të ardhurat që gjenerohen nga korrupsioni mund të duken të pakta në krahasim me të ardhurat e krimit – si për shembull, trafikimi i drogës – por dëmi që shkaktohet nga korrupsioni shtrihet në të gjitha fushat.⁶⁸

Në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, korrupsioni është një nga burimet kryesore të aktiviteteve të pastrimit të parave, dhe një kërcënim i madh ndaj përpjekjeve për të luftuar këtë fenomen.⁶⁹ Në Shqipëri, është burimi i dytë më i madh i PFP, pas trafikimit të narkotikëve.⁷⁰

Është e vështirë që të bëhet një përlogaritje mbi PFP që vijnë nga korrupsioni, por një tregues është përqindja e kompanive që raportojnë se kanë paguar ryshfete për të bërë biznes me shtetin. Studimi i Bankës Botërore mbi Sipërmarrjen tregon se 36.1 për qind e kompanive në Shqipëri kanë patur të paktën një kërkesë ryshfeti gjatë vitit 2019, ndërsa në Maqedoninë e Veriut ky problem u raportua nga 13 për qind e kompanive, dhe 6 për qind e bizneseve në Kosovë.⁷¹ Një studim i ngjashëm, që u zhvillua edhe nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) në vitin 2012, raportoi shifra shumë më të larta kontakti për korrupsion dhe raste ryshfetes.

Treguesi	Vendi			
	Shqipëri	Kosovë	Maqedoni e Veriut	Mesatare Rajonale
Niveli i kontaktit	85.10 për qind	91.20 për qind	78.18 për qind	71.30 për qind
Përhapja e ryshfeteve	15.70 për qind	3.20 për qind	6.0 për qind	10.20 për qind
Numri mesatar i ryshfeteve të paguara	4.60	7.70	6.70	7.10
Përqindja e ryshfeteve të paguara me para në dorë	50 për qind	59 për qind	17 për qind	36 për qind
Ryshfeti mesatar i paguar me para në dorë (€-PPP)	904	1 787	689	881
Ryshfeti i mesëm (€-PPP)	338	1 059	317	317
Niveli i ryshfeteve biznes-me-biznes	24.10 për qind	32.90 për qind	25.40 për qind	27.70 për qind

FIGURA 6 Treguesit kryesorë sipas vendeve, Rajoni i Ballkanit Perëndimor, 2012

BURIMI: UNODC, Biznesi, korrupsioni dhe krimi në vendet e Ballkanit perëndimor: Ndikimi i mitmarrjes dhe krimeve të tjera mbi sipërmarrjen private, 2013

SHËNIM: Mesatarja rajonale përfshin të dhëna nga Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, dhe Serbia. Niveli i kontaktit: Përqindja e bizneseve që kanë patur të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik apo punonjës administrate gjatë 12 muajve të fundit para se të bëhej sondazhi; Burime për tregues të tjerë: kurset e këmbimit të monedhave vendase dhe normat e konvertimit €-PPP nga Eurostat, WIIW dhe Institutet Kombëtare të Statistikave. €-PPP (Ekuivalenca me fuqinë blerëse të euros) për Kosovën llogaritet mbi bazën e vlerësimeve të WIIW (Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare).




FIGURA 7 Kontrata sekrete me fonde publike, Shqipëri, 2008–18

BURIMI: Gjergj Erebara, Qeveria kontrakttoi miliona euro shpenzime me kontrata sekrete, BIRN, 27 maj 2019, <https://www.reporter.al/qeveria-kontrakttoi-miliona-euro-shpenzime-me-kontrata-sekrete/>.

Sipas raportimeve të brendshme nga të tre vendet e Ballkanit perëndimor, kostoja materiale e korrupsionit mund të përllogaritet në rreth 80 milionë euro në vit.⁷² Sidoqoftë, është gati e sigurtë që kjo shifër duhet të jetë shumë më e lartë. Statistikat që zbërthejnë dhe analizojnë burime individuale korrupsioni dhe mitmarje, ashtu si do të shohim më poshtë, sugjerojnë se një llogaritje më e përafërt për koston e korrupsionit arrin në qindra milionë euro.

Kontratat me fonde publike janë burimi kryesor për të ardhurat e korrupsionit. Sipas OECD, 57 për qind e ryshfeteve të huaja paguhen për të siguruar kontrata me fonde publike, dhe 20–30 për qind e vlerës së fondeve të vëna në dispozicion për përmbushjen e kontratave humbet në korrupsion.⁷³

Grafiku në figurën 7 tregon rritjen e shpejtë në volumin e kontratave 'sekrete' – që do të thotë se nuk kanë kaluar në procesin e tenderimit publik – në Shqipëri, gjatë periudhës 2014–2018. Sipas disa burimeve në Shqipëri, deri në 30 për qind e vlerës së kontratës shkon për pagesat e ryshfeteve,⁷⁴ dhe kjo përkon edhe me përllogaritjet e OECD. Për periudhën 2018–2019, qeveria akordoi fonde për kontrata publike me vlerë 679 milionë euro, që nënkupton se rreth 200 milionë euro mund të jenë dhënë për rushfete.⁷⁵ Por kjo shumë mund të jetë akoma më e lartë. Një investigim i kryer nga një prej televizioneve private më të mëdha në Shqipëri, raportoi se 300 milionë euro humbasin çdo vit si pasojë e abuzimit me procedurat e prokurimeve publike, që është afërsisht 45 për qind e shumës së akorduar për kontratat për periudhën 2018–2019.⁷⁶

Prokurimet publike luajnë një rol të ngjashëm në lidhje me PFP që gjenerohen nga korrupsioni në Kosovë. Kontrata me

vlerë 1.03 miliardë euro janë planifikuar në buxhetin e vitit 2020, nga të cilat 672 milionë euro shkojnë për investime kapitale, dhe 357 milionë euro për prokurimin e shërbimeve publike.⁷⁷ Duke përdorur përllogaritjet e OECD, shumën e paguar për ryshfete mund të arrijë në 205–308 milionë euro.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, qeveria e Kosovës ka akorduar fonde të shumta për ndërtimin e rrugëve dhe autostradave.⁷⁸ Këto projekte janë shumë të ekspozuara ndaj korrupsionit, pasi fryrja e çmimeve, manipulimet gjatë procesit të zbatimit të projektit, dhe falsifikimi i dokumenteve, mund të arrihen lehtë, dhe është e vështirë që të dikohen.⁷⁹ Për shembull, në dhjetor 2018, një 'kompani fantazëm' në Shqipëri u zbulua se kishte fituar një kontratë me vlerë 18 milionë euro për ndërtimin e një rruge duke paraqitur dokumente të falsifikuara.⁸⁰ Një sërë raportesh mbi Kosovën kanë sugjeruar shkelje me tenderat për projektin e autostradës së Gjilanit, si dhe ndërtimin e segmeneteve të rrugës nga Gjakova në Shkodër, dhe Prizren – Tetovë.⁸¹

Po kështu, edhe projekti Shkup 2014 në Maqedoninë e Veriut ka ngjallur shqetësime mbi procedurat për prokurime publike. Ajo që nisi si një projekt me vlerë 80 milionë euro për rinovimin e kryeqytetit maqedonas me fasada të reja, monumente dhe ndërtesa të reja, në përfundim gëlltiti më shumë se 680 milionë euro në fonde shtetërore.⁸²

Pavarësisht kësaj, një analist financash nga Maqedonia e Veriut tha në një intervistë se statistikatat qeveritare tregojnë se 'numri i krimeve të abuzimit me pushtetin po rritet gradualisht vit pas viti, por dëmi material po reduktohet'.⁸³ Ky analist dhe bashkëbisedues të tjerë ishin të mendimit se përpjekjet anti-korrupsion e kanë frenuar

korupsionin, veçanërisht në majë të piramidës politike dhe institucioneve shtetërore, por ai vazhdon të jetë i përhapur në nivele më të ulëta të administratës. Për shembull, ish drejtori i Zyrës së Prokurorisë Speciale në Maqedoninë e Veriut u shpall kohët e fundit fajtor për abuzim posti dhe u dënua me shtatë vite burg.⁸⁴

Të dhënat nga studime tregojnë se në rajon të ardhurat kriminale nga korupsioni pastrohen pak a shumë në

të njëjtën mënyrë si të ardhurat nga krimi i organizuar: nëpërmjet investimeve në bizneseve dhe pasuri të paluajtëshme, brenda vendit, në rajon, si dhe jashtë vendit. Ashtu si u pa edhe nga dokumentet që dolën nga Dokumentet e Panamasë (Panama Papers), politikanë dhe zyrtarë të korruptuar përfitojnë nga parajsat financiare për të fshehur pasurinë e tyre.

Krimi i organizuar

Krimi për përfitime ekonomike, dhe krimi i organizuar në veçanti, dëmton aktivitetet ekonomike produktive, prish konkurrencën, dhe dekurajon investimet dhe sipërmarrjen. Krimi i organizuar shkon krah për krah me korupsionin dhe dobësimin e qeverisjes pasi grupet kriminale mundohen vazhdimisht të sabotojnë respektimin e ligjit, sektorin e drejtësisë, dhe duan të manipulojnë strukturat politike për t'ia përshtatur nevojave të tyre. Po kështu, përdorimi i dhunës për të zgjidhur mosmarrëveshjet mbi tregjet e paligjshme dhe për të shtuar fitimet krijojnë probleme të rënda sociale.

Krimi i organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor është shumë i përhapur, dhe ka një histori të gjatë lidhjesh në Azi dhe Evropë. Ka gjithnjë e më shumë të dhëna për rolin e rëndësishëm që luajnë grupet kriminale nga Ballkani në skenën e krimit në rajon e më gjerë.⁸⁵ Grupe nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut përshkruhen si 'poli-kriminale': pasi përfshihen në aktivitete kriminale të shumëllojshme, dhe janë të afta që të përshtaten

shpejt me situata dhe tregje të ndryshme. Aktivitetet e tyre përfshijnë trafikimin e drogës (kokainë, heroinë dhe kanabis) si dhe kalimin e paligjshëm të personave dhe mallrave, duke përfshirë edhe pije e ushqime, mallra të markave të njohura, veshje, këpucë, dhe cigare.⁸⁶

Treguesi i Krimit të Organizuar Ballkanik nga GI-TOC u krijua në vitin 2018 për gjashtë vende të Ballkanit perëndimor. Në bashkëpunim me një numër ekspertësh rajonalë dhe ndërkombëtarë u analizuan dhe u klasifikuan format e ndryshme të krimit të organizuar në rajon, dhe u arrit në përfundimin se trafikimi i drogës, tregtia e paligjshme, dhe trafikimi i qenieve njerëzore ishin tre nga tregjet e paligjshme kryesore dhe më të dëmshme (figura 8).⁸⁷ Për këtë arsye, raporti ynë përqendrohet mbi këto të treja. Sidoqoftë, edhe prurjet financiare që krijohen nga forma të krimit që renditen në vende më të ulëta sjellin efekte negative serioze, dhe nuk duhet të neglizhohen, pavarësisht se nuk janë studiuar sa duhet.




FIGURA 8 Renditja e ndikimit dhe shtrirjes së tregjeve të paligjshme në vendet e Ballkanit perëndimor

BURIMI: GI-TOC – Treguesi i Krimit të Organizuar Ballkanik⁸⁸

Paratë dhe njerëzit rrjedhin lirshëm ndërmjet Shqipërisë, Kosovës, dhe Maqedonisë së Veriut. Njerëzit e kalojnë kufirin rregullisht për punë dhe zbavitje. Nuk ka nevojë për viza, distancat janë të shkurtra, dhe ka një histori të gjatë lidhjesh, sidomos midis shqiptarëve që jetojnë në të tre vendet. Kjo lirshmëri lëvizjesh krijon hapësira edhe për lëvizjen e mallrave të paligjshme, trafikimin e personave, parave kesh, dhe ngarkesave të tjera.

Grupet kriminale bashkëpunojnë me njëri-tjetrin: rrjete të kalimit të paligjshëm të emigrantëve organizojnë udhëtimin e tyre nga Maqedonia e Veriut në Kosovë, dhe më tej; korridoret e trafikimit të heroinës kalojnë nëpër kufij kombëtarë, dhe kontrabanda nëpër rajon (si cigare, dhe produkte të tjera) është shumë e përhapur.

Trafikimi i drogës

Korridori ballkanik është një nga linjat e trafikimit të drogës më të përdorura në botë, veçanërisht për heroinë, por edhe për kokainë dhe kanabis. Në vitin 2014, UNODC përllogariti se më shumë se 20 miliardë dollarë kalojnë nëpër këtë korridor çdo vit.⁸⁹ Kjo linjë lidh Afganistanin, prodhuesin më të madh të heroinës në botë, me tregjet e Rusisë dhe Evropës perëndimore, për në perëndim nga Shqipëria drejt Italisë, dhe në veri drejt Austrisë. Kanabisi i kultivuar në Shqipëri trafikohet përtej kufirit në Kosovë, për përdorim të brendshëm, apo për t'u transportuar për në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe kalon në Maqedoninë e Veriut, kryesisht për tregjet turke, bullgare dhe rumune. Kokaina kalon nga Shqipëria në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut për tregun e brendshëm të drogës. Drogat sintetike që prodhohen në Maqedoninë e Veriut transportohen drejt lindjes.⁹⁰

Një ekspert llogariti se shumica e prurjeve të paligjshme në Shqipëri krijohen nga trafikimi i drogës. Sipas një përllogaritjeje të MONEYVAL trafikimi i drogës është burimi kryesor për pastrimin e parave në Shqipëri, me 42 për qind të të gjitha rasteve të pastrimit të parave.⁹¹

Ndonëse qeveria shqiptare është munduar të reduktojë ndjeshëm kultivimin e kanabisit gjatë viteve të fundit, të ardhurat nga kanabisi – së bashku me heroinën dhe kokainën – vazhdojnë të jenë burim i rëndësishëm i prurjeve financiare të paligjshme.⁹² Kanabisi ka sjellë fitime të paligjshme për një pjesë të madhe të shoqërisë, duke filluar që nga fshatarët që kultivojnë bimën deri tek grupet e krimit të organizuar që e transportojnë jashtë kufijve dhe e shesin në vendet e BE. Gjatë kulmit të kultivimit në periudhën 2016–2017, llogaritet se kanabisi ka sjellë 2.2 miliardë euro.⁹³

Të ardhurat nga prodhimi i kanabisit sigurojnë kapitale për grupe kriminale nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut që të përfshihen në trafikimin e kokainës. Duke krijuar kontakte direkte me Amerikën Latine, e transportojnë drogën në portet kryesore evropiane, dhe e shpërndajnë nëpër Evropën perëndimore.⁹⁴ Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësinë nga Droga ka raportuar se grupet shqiptare të krimit të organizuar janë gjithnjë e më të pranishëm në tregjet evropiane të drogës, dhe janë ngjitur më lart në hierarkinë e trafikimit të kokainës, nga ushtarë të thjeshtë dhe shpërndarës të nivelit të ulët, në organizatorë të ngarkesave me drogë, duke arritur kështu të sigurojnë fitime më të mëdha, pa i ndarë me të tjerë.⁹⁵

Vendi	Lloji i Drogës	Droga	Viti				
			2012	2013	2014	2015	2016
Shqipëri	Kanabis	Vaj	1		11	6	
		Bimë	3 300		55 141		253 629
		Rezinë	5		24	60	23
		Barishte	21 138	20 673	101 726	11 353	30 015
	Kokainë	Kripë	4	16	10	27	7
	Opiate	Heroinë	88	47	73	37	57
Kosovë	Kanabis	Bimë	1 058	151	693	256	S'ka të dhëna
		Rezinë	1		24	60	S'ka të dhëna
		Barishte	1 238	85	738	462	S'ka të dhëna
	Kokainë	Kripë	7	4	21	1	S'ka të dhëna
	Opiate	Heroinë	94	23	10	10	S'ka të dhëna

FIGURA 9 Sasitë e drogës të kapur në Shqipëri dhe Kosovë, 2012–16 (në kilogramë)

BURIMI: Të dhënat e UNODC mbi konfiskimin e drogave, kërkim në bazën e të dhënave për pesë vitet e fundit. Të gjitha grupet e drogave të raportuara, përveç substancave të kontrolluara që nuk përfshihen në listën e Këshillit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve të OKB (International Narcotics Control Board – INCB), sipas vendit, <https://data.unodc.org/drugs/seizures>

Ndonëse nuk ka të dhëna për Maqedoninë e Veriut, baza e të dhënave të UNODC mbi kapjen e drogave (ashtu si paraqitet nga vendet anëtare) vë në dukje sasinë e madhe të kanabisit që kalon nëpër rajon (figura 9). Të dhëna më të fundit tregojnë se sasia e drogave që kalon nëpër rajon është rritur ndjeshëm gjatë pesë viteve të fundit. Për shembull, në shkurt 2018, një ngarkesë me 613 kilogramë kokainë, me vlerë 180 milionë euro, u kap në portin e Durrësit.⁹⁶ Gjatë po atij viti, sasia totale e konfiskimeve të kanabisit arriti në 20,365 tonë.⁹⁷ Duke patur parasysh edhe vlerësimet e ekspertëve në Shqipëri, se vetëm 20 për qind e drogave që kalojnë nëpër vend kapen nga policia,⁹⁸ shkalla e trafikimit të narkotikëve mund të jetë e konsiderueshme.

Fitimet nga trafikimi i kokainës llogaritet të kalojë shifrën e 20,000 eurove për kilogram, çka krijon mundësi të mëdha për investime dhe korrupsion.⁹⁹ Të ardhurat nga trafikimi i kokainës mendohet se financojnë dhe mbështesin aktivitete të tjera kriminale, si tregtia e paligjshme e armëve, rrjete dhe objekte për pastrimin e parave, trafikimin e llojeve të tjera të drogës, dhe kalimin e paligjshëm të njerëzve. Fitimet e mëdha që vijnë nga trafikimi i drogës pastrohen me mënyra të ndryshme, si në vendet e Ballkanit perëndimor ashtu dhe më gjerë.

Legalizimi i kultivimit të kanabisit në Maqedoninë e Veriut

Në maj 2016, Maqedonia e Veriut aprovoi Ligjin për Kontrollin e Narkotikëve, Drogave, dhe Substancave Psikotropike, që lejon prodhimin e kanabisit dhe produkteve të kanabisit për përdorim mjekësor, si dhe eksportin e ekstrakteve mjekësore të kanabisit.¹⁰⁰

Gjatë periudhës 2016–2018, u lëshuan 28 licenca për kultivimin e kanabisit dhe dy licenca përpunimi.¹⁰¹ Në vitin 2019, qeveria lëshoi 31 licenca të reja për kultivim, me 20 aplikime të tjera që presin miratimin e autoriteteve, dhe dy licenca për përpunimin e kanabisit.

Këto konçesione iu dhanë individëve, dhe personave juridikë nga Maqedonia e Veriut dhe jashtë vendit, që kanë lidhje me partinë që është aktualisht në pushtet, si dhe personave 'politikisht të ekspozuar', që kanë mbajtur më parë poste publike me rëndësi, dhe që rrezikojnë të përfshihen në korrupsion.¹⁰² Partia opozitare akuzoi kryeministrin për shpërndarjen e licensave të kanabisit për të afërm dhe aleatë politikë.¹⁰³

Ndonëse ligji u mirëprit, si një mënyrë për të taksuar tregtinë e kanabisit, shitja e licensave të kultivimit mund të jetë një mënyrë për të krijuar të ardhura për politikanët, pasi mbajtësit e licensave do të investojnë miliona euro. Një ndryshim ligji i shumëpritur, për lehtësimin e eksportimit të kanabisit për përdorim të lirë, po krijon një klimë frenetike investimi për një treg të ri shumë të pasur. Tregu i BE-së për marihuanë llogaritet të shkojë deri në 39 miliardë dollarë në vit.¹⁰⁴ Potenciali për PFP është shumë i madh, në një sektor ku qeveria ka aftësi shumë të kufizuara për të kontrolluar situatën.

Nga ana tjetër, një ekspert financash raportoi se pjesa më e madhe e kanabisit të kultivuar për përdorim mjekësor nuk eksportohet në mënyrë të ligjshme, por shitet në mënyrë të paligjshme në tregjet vendase dhe të huaja, duke krijuar burime të tjera të të ardhurave të paligjshme.¹⁰⁵

Tregtia e paligjshme dhe mallrat e falsifikuara

Luftërat në Jugosllavi në vitet 1990, dhe krijimi i shtatë shteteve të reja, me kufijtë e tyre sovranë, krijuan një treg të pasur kriminal edhe për trafikimin dhe kontrabandën e mallrave të ligjshme. Sanksionet, privatizimet, ndryshimet në sistemet tatimore dhe nivelet e taksave, dhe pabarazia në furnizime, krijuan stimuj për grupet kriminale që të trafikonin armë, ushqime, karburante, ilaçe, cigare, dhe gjë të gjallë.¹⁰⁶ Pikat kryesore të trafikimit të atyre viteve vazhdojnë të jenë zona problematike edhe sot e kësaj dite. Për shembull, Kukësi dhe Tropoja ishin nyje kryesore të trafikimit dhe burime furnizimi për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1999, pasi zona kufitare nuk kontrollohej thuajse fare si nga shteti shqiptar ashtu dhe nga shteti serb.¹⁰⁷

Në ditët e sotme, tregtia e paligjshme, veçanërisht e produkteve të duhanit, vazhdon të jetë një aktivitet kriminal shumë i përhapur dhe me rëndësi në rajon. Studimet e kohëve të fundit kanë identifikuar rolin e rëndësishëm që luajnë Mali i Zi¹⁰⁸ dhe Bullgaria në tregtinë e cigareve, por nuk lënë pa përmendur edhe Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, dhe veçanërisht Kosovën. Instituti i Ekonomisë në Zagreb përlllogarit se afro 18 milionë euro fitohen në Kosovë nga kontrabanda e cigareve, dhe gati 20.5 milionë euro në Maqedoninë e Veriut.¹⁰⁹

Tregtia e paligjshme e cigareve nxitet në veçanti nga ndryshimet në taksat e akcizës në vende të ndryshme. Në Maqedoninë e Veriut – tregu më i lirë për cigare në rajon – një paketë cigare mund të blihet për 1.50 euro. Po të trafikohen përmes kufijve, mund të shitet nga pesë deri në shtatë euro në Gjermani.¹¹⁰

Duhan dhe cigare të paligjshme hyjnë në rajon nëpërmjet porteve të mëdha (si Durrësi¹¹¹ dhe Tivari në Mal të Zi¹¹²) dhe më pas kalon kufijtë tokësorë në Greqi dhe Bullgari. Kontrabanda shpesh kalon nëpër “pika alternative të kalimit të kufirit” ku terreni është i ashpër dhe malor, duke mundësuar një kalim relativisht të sigurt dhe të pakontrolluar. Mushka transportojnë mallra në krahun tjetër, dhe fshatarët e zonës paguhen me shuma të vogla për të kryer këto shërbime. Duhanit i paligjshëm zbret edhe poshtë në jug nga Kosova në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut dhe vazhdon rrugën për në Itali, Bullgari, Lindjen e Mesme, dhe Afrikën e Veriut.¹¹³



Tregtia e paligjshme në prodhime duhani, është një aktivitet kriminal i përhapur në rajon.

Kalimi i paligjshëm i emigrantëve është një nga burimet kryesore e të ardhurave kriminale në rajon.

Tregtia e paligjshme e cigareve, dhe deri diku, edhe kontrabanda e mallrave të falsifikuara, kanë një ndikim të madh në Kosovë, veçanërisht në veri të vendit. Institucionet kosovare kanë vetëm një prezencë formale në veri të Kosovës, por një strukturë paralele, e financuar nga Serbia, nën influencën dhe pushtetin e disa biznesmenëve të fuqishëm, e ka transformuar këtë krahinë në një zonë gri informaliteti.¹¹⁴ Raportohet se grupe të krimit të organizuar serbe dhe kosovare bashkëpunojnë që të mbajnë në këmbë këtë sistem ekonomik të pakontrolluar nga autoritetet, duke penguar kështu normalizimin e aktivitetit ekonomik në të mirë të qytetarëve të vendit.

Po kështu, mallrat e falsifikuara nga Kina dhe Turqia gjenden kudo në vendet e Ballkanit perëndimor. Këpucë sportive të falsifikuara, kozmetikë, aksesore për telefona celularë, dhe mallra të tjera kalojnë tranzit nëpër rajon dhe gjejnë një treg. BE përmend Shqipërinë si një pikë tranziti me rëndësi të veçantë për rishpërndarjen e produkteve të falsifikuara në tregjet Evropiane.¹¹⁵

Kalimi i mallrave kontrabandë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duket se është shtuar që kur u vendosën tarifa të rënda doganore mbi mallrat nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina, nga fundit i vitit 2018.¹¹⁶ Qeveria kosovare njoftoi uljen e barrierave doganore në fillim të vitit 2020, por është e nevojshme që të mbahet situata nën vëzhgim për të parë nëse kontrabanda do të reduktohet apo jo.¹¹⁷

Trafikimi i qenieve njerëzore

Maqedonia e Veriut ndodhet në një pozicion të favorshëm në raport me korridoret e emigracionit nga Turqia drejt Evropës perëndimore. Që kur nisi kriza e emigrantëve për në BE në vitin 2015, më shumë se 1.5 milionë emigrantë kanë kaluar nëpër këtë korridor.¹¹⁸ Kalimi i paligjshëm i emigrantëve, që organizohet kryesisht nga qytetarë pakistanezë, afganë, dhe maqedonas, është një nga burimet më të rëndësishme për të ardhura kriminale në rajon. Emigrantët i paguajnë trafikantëve nga 2,000 deri në 3,500 euro që të kalohen nga kampe refugjatësh në Greqi, si në Idomeni apo Selanik, përgjatë korridorit ballkanik drejt Evropës perëndimore.¹¹⁹ Vetëm kalimi i segmentit në Ballkanin perëndimor kushton mesatarisht nga 800 deri në 1,000 euro. Emigrantëve u kërkohet që të kryejnë edhe pagesa të tjera përgjatë rrugës për fjetje, ushqime, shërbime, dhe ryshfete.¹²⁰ Ndonëse korridori ballkanik është zyrtarisht i mbyllur tani, banorët vendas përgjatë korridorit veri-jug, nga pika kufitare e Bogodorica me Greqinë, deri në pikën e kalimit kufitar Tabanovce me Serbinë, ndihmojnë në kalimin dhe transportimin e emigrantëve në këmbim të pagesave me para në dorë, që më pas kalojnë në sistemin financiar legjitim.¹²¹

Në vitin 2018, një grup i krimit të organizuar nga Maqedonia e Veriut u identifikua si pjesë e një rrjeti ndërkombëtar që përfshinte grupe nga Shqipëria, Bullgaria, Spanja, Republika Dominikane, Hondurasi, dhe Meksika. Ky rrjet trafikonte persona nga veriu i Shqipërisë dhe Maqedonia e Veriut për në Shtetet e Bashkuara, kundrejt pagesave prej 20,000 deri në 25,000 dollarë për person. Vetëm për kalimin e një grupi ky rrjet kriminal fitonte rreth një milionë dollarë.¹²²

Më shumë se 900 emigrantë hynë në Kosovë vetëm gjatë dy muajve të parë të vitit 2020, dhe 300 prej tyre vinin nga Siria.¹²³ Shumica prej tyre kishin hyrë në vend nga Shqipëria drejt rrugës për në Serbi. Disa prej tyre ishin kthyer në Kosovë nga Serbia, pasi nuk kishin qenë në gjendje të kalonin në Hungari.¹²⁴ Një emigrant i tha Radios Evropa e Lirë se ishte kthyer në Prishtinë nga Serbia, dhe se do shkonte në Shqipëri, që të përpiquej to kalonte nga Durrësi për në Itali, dhe më tej në Gjermani. Disa emigrantë i kishin paguar shoferëve të taksive rreth 100 euro për person që t'i kalonin ilegalisht nga kufiri me Shqipërinë për në destinacion. Disa të tjerë kishin paguar 200 euro që të kalonin nga Shqipëria në Kosovë nëpërmjet një rruge mali.¹²⁵



Të ardhurat kriminale nga kalimi i paligjshëm i emigrantëve përfundojnë në sistemin financiar legjitim nëpërmjet një sërë mënyrash, duke përfshirë edhe blerjen e mallrave të luksit, si dhe prona të luajtëshme dhe të paluajtëshme, si dhe investime në sipërmarrje biznesi.

Emigrantë pranë Indomeni, në kufirin midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, korrik 2020. © SakisMitrolidis/AFP nga Getty Images

Krime të lidhura me taksat

Komponenti i tretë me rëndësi për PFP është evazioni fiskal. Evazioni fiskal ndryshon nga shmangia e taksave, që ka të bëjë me minimizimin e ngarkesës tatimore duke respektuar ligjet në fuqi. Evazioni fiskal ka të bëjë me mospagimin e paligjshëm të taksave, duke fshehur të ardhurat, duke raportuar shpenzime në mënyrë të paligjshme, apo thjesht duke mos paguar taksat.¹²⁶ Si korporata, ashtu dhe individë, bëjnë evazion fiskal, por natyrisht ka ndryshim të madh midis shkallës dhe ndikimit të tyre në shoqëri.

Përlllogaritjet e humbjeve botërore si pasojë e evazionit fiskal ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra, por gjithnjë bëhet fjalë për shifra shumë të mëdha. Për shembull, senati i SHBA-së llogarit se humbjet e buxhetit nga evazioni fiskal i kompanive dhe individëve amerikanë arrijnë në rreth 100 miliardë dollarë çdo vit.¹²⁷ Një studim i Bankës Botërore mbi Afrikën përllogariti se evazioni fiskal ishte sa 8–12 për qind e PBB.¹²⁸

Evazioni fiskal është i dëmshëm për katër arsye të ndërlidhura me njëra tjetrën. Evazioni redukton sasinë e parave që shteti mbledh nga taksat, dhe e vështirëson punën e qeverisë për të arritur objektivat social ekonomike në vend. Ai dëmton kredibilitetin e institucioneve shtetërore, dhe saboton pushtetin e ligjit. Evazioni gjithashtu përkeqëson pabarazinë sociale përsa i përket mjeteve të jetesës, dhe lejon të pasurit që të fshehin pasurinë e tyre në kurriz të të varfërve. Së fundmi, evazioni mund të joshë zyrtarë publikë, institucione financiare, dhe kompani private që të shtojnë fitimet e tyre duke shkelur ligjet dhe rregullat.¹²⁹

Si pasojë e përmasave të ekonomive informale në vendet e Ballkanit perëndimor, niveli i të ardhurave nga taksat është goxha më i ulët se kudo tjetër në Evropë. Të 28 shtetet e BE mbledhën mesatarisht 40.3 për qind të PBB-së nga tatimet në vend gjatë vitit 2018.¹³⁰ Për Maqedoninë e Veriut, Kosovën, dhe Shqipërinë niveli i të ardhurave të shtetit nga taksat ishte respektivisht 17.65 për qind (2018), 26.11 për qind (2019), dhe 18.55 për

Grupet nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut përshkruhen si 'poli-kriminale'.

qind (2018),¹³¹ dhe pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave vinte nga mbledhja e taksës së vlerës së shtuar (TVSH), dhe jo nga tatimet mbi të ardhurat.¹³² Është e pamundur që të llogaritet me saktësi, por një nga arsyet për këtë disnivel mund të jenë praktikatat e evazionit fiskal që aplikohen gjerësisht nga kompani private në vendet e Ballkanit perëndimor, dhe që bëhen të mundura nga nivele të larta të korrupsionit dhe mitmarrjes, si dhe nga kontrolli i dobët shtetëror. Një raport i Bankës Botërore të vitit 2015 llogariti se 34 për qind e TVSH-së nuk ishte mbledhur në Kosovë gjatë vitit 2012,¹³³ ndërsa një raport i strategjisë kombëtare tregoi se Kosova humbet tetë milionë euro çdo vit nga mospagesa e taksave në sektorin e ndërtimit, dhe 11 milionë euro nga sektori i tregtisë.¹³⁴

Proçedimet penale kundër kompanive për evazion japin një tablllo të situatës në lidhje me shtrirjen e fenomenit dhe strategjitë e përdorura. Hetime nga institucione kosovare arritën në përfundimin se bizneset përdorin kompani fantazëm – kompani të regjistruara që kryejnë transaksioneve financiare por që nuk ndërmarrin asnjë aktivitet real biznesi – si dhe transaksione të rreme për të evituar pagimin e taksave.¹³⁵ Një tjetër metodë e përdorur rëndom është shitja e mallrave pa faturë për të evituar pagesën e TVSH-së. Gjatë periudhës 2006–2016, moslëshimi i faturave fiskale ishte forma kryesore e shkeljeve tatimore në Maqedoninë e Veriut.¹³⁶

Në sektorë me numër të madh punonjësish, si ndërtimi dhe turizmi, taksat evitohen duke deklaruar një numër më të vogël punëtorësh dhe rroga më të ulëta se në realitet, apo duke paguar rrogat me para në dorë.¹³⁷ Pagesa e rrogave me para në dorë mund të duket si një praktikë që përdoret vetëm në ekonominë informale, por korporatat e mëdha me shumë punonjës, në sektorin e ndërtimit apo hoteleri, veprojnë sistematikisht në këtë mënyrë për të evituar pagesën e taksave dhe kontributet shoqërore për punonjësit e tyre. Kjo praktikë pune mbase edhe pranohet nga shoqëria, por në fakt nuk duhet të jetë kështu. Këto metoda kontribuojnë në rritjen e përmasave të ekonomisë informale, gjë që redukton bazën e tatueshme, dobëson pozitat e punëtorit, dhe krijon një ambient ku lulëzojnë edhe forma të tjera të aktiviteteve të paligjshme.

Në përpjekje për të krijuar dhe forcuar disiplinën fiskale, drejtoria tatimore e Maqedonisë së Veriut publikon çdo tre muaj një listë të zezë me debitorët tatimorë në bazë të TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat personale, kontributet e detyrueshme shoqërore, taksat e akcizës, dhe detyrimet doganore. Në vitin 2019, borxhi total ishte mbi 10 miliardë denarë (mbi 163 milionë euro).¹³⁸

Në shtator 2019, prokuroria e përgjithshme shqiptare publikoi një listë kompanish që ishin nën hetim për evazion fiskal si pasojë e lëshimit të faturave false të TVSH-së.¹³⁹ Në listë renditeshin një sërë kompanish konçesionare dhe firmash ndërtimi, që përdornin metoda të ngjashme me ato që aplikoheshin në Kosovë për të zvogëluar ngarkesën e tyre tatimore. Sidoqoftë, vetëm individë me të ardhura të ulëta janë identifikuar deri më tani në këtë listë: persona që u përdoret emri si pronarë të kompanive fantazëm në shkëmbim të shpërblimeve të vogla.¹⁴⁰

Të dhënat e mbledhura nga të tre vendet e Ballkanit perëndimor sugjerojnë se shumica e këtyre fitimeve transferohen jashtë rajonit në parajsë financiare, apo territore të tjera me taksë shumë të ulëta, ku fondet dhe identiteti i llogarive bankare nuk mund të gjurmohen.¹⁴¹ Paratë që dalin jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut zakonisht përfundojnë në vende si Bermuda, Bahamas, Belize, Seishell, Saint Vincent dhe Grenadine, Panama, British Virgin Islands, si dhe në shtetin Delaware në Shtetet e Bashkuara.¹⁴²

Shumë nga këto fonde, pas njëfarë kohe, e gjejnë rrugën për në shtëpi dhe kthehen pas në rajon. Sipas ekonomistëve që analizuan statistika të publikuara nga Banka Kombëtare, shumë nga investimet e huaja direkte që hyjnë në Maqedoninë e Veriut e kanë origjinën nga këto destinacione. Në vitin 2018, dolën nga Maqedonia e Veriut një sasi prej 756 milionë euro,

dhe hynë në vend 1.17 miliardë euro.¹⁴³ Transaksione me shuma të mëdha nga vendet e përmendura më lart natyrisht që ngjallin dyshime, por ekspertët mendojnë se kjo është një nga mënyrat se si PFP-të hyjnë në Maqedoninë e Veriut.

Duhet përmendur fakti se, ndonëse Maqedonia e Veriut nuk është parajsë financiare, shteti aplikon një taksë të sheshtë preferenciale për korporata prej 10 për qind, për të tërhequr investimet e huaja, si dhe një sërë përjashtimesh dhe favoresh për licensa, TVSH, dhe tarifa doganore. Shteti ka lehtësuar ndjeshëm procesin e regjistrimit të kompanive në vend, dhe ka riorganizuar Regjistrin Qendror për të bërë të mundur regjistrimin e kompanive të reja brenda ditës.¹⁴⁴ Ky nivel lehtësish dhe shpejtësie vështirë se arrihet pa një reduktim proporcional në procesin e monitorimit dhe shqyrtimit të informacionit për t'u siguruar mbi integritetin e këtyre investimeve.

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

- PFP gjenerohen në rajon nëpërmjet formave të shumta të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- PFP që vijnë si pasojë e korrupsionit mund të llogariten në miliarda euro, që vijnë si pasojë e manipulimit me fonde për kontrata publike, mitmarrje, ryshfete, dhe shkelje në financimin e partive politike. Manipulime me fonde për kontrata publike shkaktojnë një dëm prej më shumë se 300 milionë euro në vit në Shqipëri.
- Tre nga burimet kryesore të PFP nga krimi i organizuar duket se janë trafikimi i drogës, tregtia e paligjshme me mallra të falsifikuara dhe jashtë standardeve, si dhe kalimi i paligjshëm i emigrantëve.
- Trafikimi i drogës, në heroinë dhe kanabis kryesisht, të ndjekur nga kokaina, dhe amfetamina në sasi më të vogla, llogaritet të sjellë fitime prej qindra milionë euro në vit.
- Tregtia e paligjshme e mallrave legjitime të konsumit, ku kryesorja është tregtia e cigareve, është një sektor i paligjshëm i konsoliduar ndër vite, që furnizon tregjet e brendshme dhe të jashtme. Këtu bëhet fjalë për shuma disa herë më të vogla, pasi tregtia e paligjshme e cigareve llogaritet të sjellë rreth 40 milionë euro në rajon.
- Kalimi i emigrantëve nëpër korridorin ballkanik është shtuar gjatë viteve të fundit, si rezultat i krizës në Mesdhe. Grupe të krimit të organizuar kanë përfituar nga shtimi i kërkesës për kalimin e paligjshëm të emigrantëve nëpër Ballkan.
- Evazioni fiskal është një tjetër komponent i PFP, ndërsa devijon shuma të mëdha nga sistemi financiar legjitim. Një sërë skemash aplikohen për të evituar pagimin e taksave. Shumica e tyre përdorin në masë të gjerë transaksione me para në dorë, si dhe metoda të tjera të ekonomisë informale, duke përfituar nga një sistem i dobët kontrolli, si dhe parajsat financiare e juridiksionet e fshehta.



© Armend Nimani/AFP
nga Getty Images

KANALET E PRURJEVE TË PALIGJSHME

Kanalet e PFP janë metodat me anë të të cilave prurjet e paligjshme lëzinin përmes kufijve, duke përfshirë pastrim parash, manipulim me fatura, transferimin e parave kesh, si dhe kanalet e llogarive të kapitalit. Çdo kanal paraqitet në formë dhe tipare të ndryshme. Ky kapitull analizon mënyrën se si, dhe sa shpesh, përdoren këto kanale për PFP në vendet e Ballkanit perëndimor.

Pastrim parash

Pastrimi i parave është procesi nëpërmjet të cilit të ardhurat nga krimi hyjnë në sistemin financiar legjitim, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Martin Navias, një jurist britanik i specializuar në financë dhe siguri, e përshkruan pastrimin e parave si 'një pasojë e pashmangshme e aktivitetit kriminal për fitim parash, ku kriminelët kanë nevojë që ta distancojnë veten nga shkeljet e ligjit'.¹⁴⁵ Navias e përshkruan mënyrën se si mund të arrihet ky distancim në tre faza:

- 'Infiltrimi: Të ardhurat e paligjshme futen në sistemin financiar duke fshehur pronësinë e vërtetë të këtyre fondeve, në mënyrë që të evitohet aktivizimi i sistemit anti-pastrim parash (APP) të sektorit financiar.
- 'Maskimi: është një proces nëpërmjet të cilit tentohet të transferohen të ardhura kriminale nëpërmjet një sërë transaksionesh financiare të ndërlikuara për të maskuar origjinën e vërtetë të fondeve.
- 'Integrimi: është një proces ku fondet e paligjshme futen sërish në ekonomi në një formë tjetër, dhe të maskuara si pasuri e ligjshme.'¹⁴⁶

Sipas gjykimit të FMN në vitin 1998, rreth 2-5 për qind e PBB botërore qarkullonin si para të pista.¹⁴⁷ Në vitin 2009, megjithë sofistikimin e sistemit anti-pastrim parash (APP), një përlllogaritje me rezerva nga ana e UNODC doli në përfundimin se kjo shifër qëndron tek rreth 2.7 për qind.¹⁴⁸ Po të aplikojmë këtë përlllogaritje për Ballkanin perëndimor, del se 280–700 milionë euro pastrohen çdo vit Shqipëri, 155–385 milionë euro në Kosovë, dhe 240–600 milionë euro në Maqedoninë e Veriut.

Pastrimi nëpërmjet ndërtimit dhe pasurive të paluajtëshme

Investimet në ndërtim dhe pasuri të paluajtëshme kanë një histori të gjatë të thithjes së fondeve të paligjshme në vendet e Ballkanit perëndimor, duke qenë se ky sektor përbën një përqindje të madhe të ekonomisë së këtyre vendeve dhe nuk kontrollohet sa duhet.¹⁴⁹ Bashkitë në këtë rajon japin leje ndërtimi, por nuk kanë mjete dhe mundësi për të monitoruar se çfarë ndodh në terren. Nga ana tjetër, për arsye nga më të ndryshmet, edhe kadastrat e pronësive mbi tokën dhe regjistrat e lejeve të ndërtimit kanë mangësi të mëdha, dhe nuk arkivohen si duhet.

Në Kosovë, sektori i ndërtimit dhe pasurive të paluajtëshme ka një xhiro vjetore prej rreth një miliardë euro në vit, që përfaqëson rreth 8.7 për qind të PBB.¹⁵⁰ Megjithatë, 350,000 ndërtime të pasluftës vazhdojnë të jenë pa leje ndërtimi dhe legalizim,¹⁵¹ dhe është diçka e zakonshme për kosovarët që të mos kenë dokumente pronësie mbi apartamentet e tyre.¹⁵²

Në Shqipëri, nuk lejoheshin ndërtime private gjatë kohës së komunizmit, dhe vendi vuante nga mungesa kronike e ambienteve të banimit. Pas rënies së regjimit dhe

tranzicionit në ekonominë e tregut, në fillim të viteve 1990, pati një bum ndërtimesh, si për të përmbushur nevojat ekzistuese në qytete, por edhe për t'i bërë ballë migracionit të brendshëm nga zonat rurale. Ndërtimi i shtëpive dhe bizneseve lulëzoi pa regulla urbanistike, leje ndërtimi, apo regjistrime të rregullta pronësie. Një numër i madh ndërtimesh që u ngritën në mënyrë të paligjshme gjatë periudhës 1995–2004 nuk e kanë përfunduar akoma procesin e legalizimit.¹⁵³ Po kështu, ndërtimi gjatë viteve pas komunizmit u stimulua edhe nga diaspora shqiptare që zgjodhi të investojë në Shqipëri, por burimi dhe legjitimiteti i atyre fondeve ishte gati tërësisht i panjohur.¹⁵⁴

Bumi i ndërtimit në Shqipëri përfundoi në vitin 2012, dhe, ashtu si shihet edhe në grafkun e figurës 10, numri i lejeve të ndërtimit ra deri në shifra të papërfillshme. Zhvillimi i ekonomisë së Shqipërisë po fenohej, dhe pak banka ishin të gatshme që të jepnin kredi për investime në një sektor të tejngopur. Sidoqoftë, në vitin 2016, sektori i ndërtimit filloi të zhvillohej me shpejtësi, dhe ekspertët mendonin se kjo rritje erdhi si pasojë e shtimit të investimeve të parave të pista nga të ardhurat e krimit. Në Tiranë u lëshuan 65 për qind e të gjitha lejeve të ndërtimit për ambiente banimi, me një shumë totale prej 400 milionë eurosh.¹⁵⁵ Nga 141 kompani që fituan leje ndërtimi për ndërtesa më të larta se gjashtë kate, gjatë periudhës 2017–2019, 59 për qind e tyre nuk i kishte burimet financiare për të përfunduar ndërtesat.¹⁵⁶ Sipas bilanceve të këtyre kompanive, të ardhurat e tyre ishin minimale, dhe nuk kishin prona apo kredi që mund t'i lejonte që të kryenin investime të tilla. Sipas vlerësimeve tona, afërsisht 60 për qind e kësaj vlere vinte nga para të pista, afro 240 milionë euro.¹⁵⁷




FIGURA 10 Aproximi i lejeve të ndërtimit në Shqipëri, 1995–2018

BURIMI: INSTAT, Ndërtimi, <http://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/construction/>

*Sektori i ndërtimit
në të tre vendet
është veçanërisht
i ekspozuar ndaj
pastrimit të parave.*

Edhe kreditë bankare për blerje shtëpish mund të përdoren për të llogaritur nivelin e pastrimit të parave, dhe sektorit të pasurive të paluajtëshme. Në vitin 2019, u lëshuan 200 milionë euro në kredi për shtëpi në Shqipëri. Bankat zakonisht financojnë 50–70 për qind të vlerës së apartamentit, ndërsa pjesa tjetër financohet nga kursimet personale. Kjo do të thotë se gjatë viti 2019 kreditë për shtëpi financuan blerjen e 300–400 milionë eurove në ambiente banimi. Nga ana tjetër, statistikatat tregojnë se u ndërtuan pasuri të paluajtëshme me vlerë 953 milionë euro, dhe mendohet se diferenca është paguar direkt nga blerësit e ambienteve, apo nëpërmjet kredive private.¹⁵⁸ Një ekspert i pastrimit të parave në Shqipëri përlogariti se afërsisht 500 milionë euro janë pastruar nëpërmjet sektorit të pasurive të paluajtëshme në vitin 2019. Duke përdorur të njëjtën formulë edhe për vitet 2017 dhe 2018, shifrat respektive janë 320 milionë euro dhe 570 milionë euro. Sipas këtyre përlogaritjeve, del se një shumë totale prej 1.6 miliardë euro në para të pista janë pastruar nëpërmjet sektorit të pasurive të paluajtëshme në Shqipëri, gjatë këtyre tre viteve.¹⁵⁹

Sektori i ndërtimit në të tre vendet është veçanërisht i ekspozuar ndaj pastrimit të parave nga vetë mënyra e strukturimit të tij. Së pari, në ndërtimet e reja klientëve u kërkohet gati gjithmonë që të parapagujnë për hapësirën që do të zënë ambientet e tyre, dhe shitet që përpara se të fillojë ndërtimi. Ky sektor vazhdon të jetë akoma i varur nga pagesat me para në dorë, dhe agjencitë e pasurive të paluajtëshme në Shqipëri raportojnë se shitjet me para në dorë nuk janë ndonjë gjë e rrallë. Edhe në rastet kur shitja mbështetet nga marrëveshje financiare, është e rrallë që këto të vijnë nga banka apo institucione të tjera financiare, por janë kredi private të lëshuara nga sipërmarrje të tjera komerciale. Edhe sistemi i shkëmbimit në natyrë përdoret nganjëherë në ndërtimet e reja, ku materialet e ndërtimit shkëmbehen me apartamente të përfunduara.¹⁶⁰

Transaksionet me para në dorë për pasuri të paluajtëshme nuk mund të hetohen nga sistemi i rregullt financiar, dhe po kështu nuk mund të përcaktohet as burimi i fondeve. Noterët konsideroheshin më parë si të ekspozuar ndaj korrupsionit në Shqipëri, por tani po i nënshtrohen një kontrolli më të fortë. Që atëherë, ata janë eliminuar nga transaksionet e dyshimta, kështu që kompanitë e ndërtimit, dhe agjencitë e pasurive të paluajtëshme, e kryejnë vetë rolin e ndërmjetësit.¹⁶¹

Për të organizuar sistemin e pastrimit të parave, grupet kriminale identifikojnë kompani ndërtimi apo njerëz të biznesit në situata të vështira financiare, që kanë akumuluar borxhe apo kanë kredi për të kthyer. U jepen shuma të mëdha parash për t'i investuar në projekte ndërtimi dhe blerje apartamentesh, nëpërmjet një marrëveshjeje informale (dhe zakonisht përdoret si garanci kërcënimi i përdorimit të dhunës) që apartamentet t'i kthehen mbrapsht grupit kriminal pas përfundimit të projektit. Një mënyrë tjetër është përdorimi i parave të pista për të blerë aksione në një kompani ndërtimi në këmbim të apartamenteve pas përfundimit të ndërtimit. Manipulime me deklarin e vlerës së apartamentit, apo projektit të ndërtimit, lejon që të pastrohen akoma më shumë fonde.¹⁶²

Në Shqipëri, çmimet e pasurive të paluajtëshme janë rritur kohët e fundit, dhe në fund të vitit 2019 çmimi mesatar i apartamenteve të banimit në Tiranë arriti në pak më shumë se 1,000 euro për metër katror. Ka një sërë faktorësh që ndikojnë në këtë rritje, por kjo përfaqëson një normë inflacioni prej 16 për qind që nga viti 2016, që kur filloi ky bum i paligjshëm i ndërtimeve.¹⁶³ Janë çmime shumë të larta për të qenë të besueshme, në një vend ku rroga mesatare mujore është 420 euro.¹⁶⁴ Baza e të dhënave të agjencisë Numbeo mbi koston e jetesës e rendit Tiranën në një raport çmim-të ardhura në të njëjtin rang me Milanon, Mynihun, dhe Moskën.¹⁶⁵

Në Maqedoninë e Veriut, ndërtimi i moteleve për qëndrim tre-orësh ka krijuar një mënyrë të re për pastrimin e parave në sektorin e hotelierisë. Sipas një interviste me një këshilltar të ish-kryeministrit të vendit, një motel i tillë mund të gjenerojë 1.5 milionë euro në vit në transaksione të paligjshme dhe të paregjistruara. Ka afro 50 motele të tilla, që do të thotë më shumë se 50 milionë euro në fitime të paligjshme çdo vit.¹⁶⁶

Në Kosovë, ndërtimi është përqendruar në qytetet e Prishtinës, Prizrenit, dhe Ferizajt, por edhe Fushë Kosova, Lipjani, dhe Gjilani kanë regjistruar rritje të ndjeshme. Ka të dhëna se punëtorët në kantieret e ndërtimit nuk kanë kontrata pune – dhe për pasojë nuk kanë burime zyrtare të të ardhurave – por depozitojnë shuma të mëdha në llogaritë e tyre bankare, gjithmonë nën kufirin e raportimit prej 10,000 euro.¹⁶⁷ Disa kompani ndërtimi duket se janë në pronësi të familjarëve apo personave të afërt me politikanë të fuqishëm. Disa nga këto kompani e nisën aktivitetin në sektorët e infrastrukturës, apo produkteve të naftës, por më pas u orientuan drejt një sektori tjetër kur iu akorduan kontrata të majme me fonde publike.¹⁶⁸

Edhe ndërtimi në sektorin e turizmit tërheq investime të mëdha, që mund të krijojnë hapësira për pastrimin e parave. Ashtu si dhe në sektorin e ndërtimit të ambienteve të banimit, ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të lejeve të ndërtimit dhe vlerës monetare që nga viti 2016 (Figura 11).

Elementë kriminalë kanë shtrirë aktivitetet e tyre në zonat bregdetare më të mira në Shqipëri.¹⁶⁹ Ka shumë raste që ilustrojnë shkallën e lartë të infiltrimit të parave të paligjshme në bare, restorante, klube dhe hotele turistike,

veçanërisht në jug të Shqipërisë.¹⁷⁰ Shpesh deklarohet se qytetarë kosovarë i investojnë fitimet e tyre nga ryshfete e korrupsioni në pasuri të paluajtëshme në bregdetin shqiptar. Për shembull, në qershor 2020, prona me vlerë 2.1 milionë euro iu konfiskuan një qytetari polak dhe një qytetari kosovar, duke përfshirë apartamente në Tiranë dhe tokë në Vlorë.¹⁷¹ Raportime mediatike nga shtatori deri në nëntor 2019 pretendonin se dy drejtorë të kadastrës së Vlorës u detyruan të largoheshin nga posti, pasi morën kërcënime nga një grup i njohur kriminal.¹⁷²

Përveç pasurive të paluajtëshme, sektori i turizmit dhe sektori i shitjes me pakicë ofrojnë mënyra të tjera për të pastruar fonde gjatë punës së përditshme të bizneseve. Këto biznese mund të fryjnë shifrat ditore të shitjeve, numrit të klientëve apo vakteve të shërbyera, duke deklaruar në mënyrë të rreme të ardhura shumë të larta për të maskuar fondet e paligjshme.¹⁷³ Ndonëse këto biznese janë bërë objekt i inspektimeve të shumta nga administrata tatimore e Kosovës, në lidhje me dyshime për evazion fiskal, mbrojtja politike shpesh i ndihmon këto biznese që t'i shmangen drejtësisë.¹⁷⁴

Aktivitetet e pastrimit të parave bëhen të mundura edhe nga mangësi në procedurat e regjistrimit të kompanive për hapjen e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Për shembull, një kompani biznesi SHPK mund të regjistrohet me kapital fillestar prej 1,000 eurosh, apo edhe më pak. Pas regjistrimit, pronari mund të investojë shuma të mëdha në biznes, pa deklaruar fare se nga kanë ardhur këto para. Këto investime trajtohen si shpenzime legjitime, dhe shpesh përjashtohen edhe nga pagimi i taksave, dhe inspektorët tatimorë nuk hetojnë mbi origjinën e tyre.¹⁷⁵




FIGURA 11 Fondet e parashikuara për ndërtimin e hoteleve dhe turizmit në Shqipëri

BURIMI: Njësia Informative Financiare e Kosovës, Tipologjia e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Republikën e Kosovës, 2014, <http://njif.rks-gov.net/wp-content/uploads/2014/10/Typology-Eng1.pdf>

Pastrimi nëpërmjet lojërave të fatit

Kumari, si në kazino reale ashtu dhe në internet, me makina elektronike apo baste sportive, është identifikuar prej kohësh si një nga kanalet e pastrimit të parave në vendet e Ballkanit perëndimor. Shumat e mëdha të xhirove ditore dhe pagesat me para në dorë e bëjnë shumë të lehtë përzierjen e parave të pista me paratë e pastra. Kumari, në thelb, nuk është i paligjshëm apo negativ, dhe një administrim i mirë i këtij sektori mund të sjellë shumë përfitime për ekonominë, nëpërmjet turizmit dhe investimeve të huaja, por pa një kontroll dhe mbikqyrje të efektshme, lojërat e fatit mund të kthehen në çerdhe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nga këndvështrimi i zhvillimit të ekonomisë, kumari konsiderohet edhe si taksë regresive në dëm të të varfërve, dhe kontribuon në shtimin e informaleitetit në ekonomi.

Ka një sërë metodash për pastrimin e parave nëpërmjet lojërave të fatit. Mënyra më e thjeshtë është kur një individ hyn në kazino, blen kredite loje me para të pista, dhe më pas luan për pak kohë, zakonisht në lojëra me koeficientë të lartë. Vendos baste për çdo rezultat të mundshëm, dhe për pasojë do të dalin një ose më shumë rezultate pozitive. Kur kthen kreditet në para, i kërkon arkës që t'i japë një çek për shumën e parave, ose të paktën një faturë, në mënyrë që të pretendojë se paratë janë të fituara në kumar.¹⁷⁶

Grupe të krimit të organizuar, apo bashkëpunëtorët e tyre kanë në pronësi kazino, posaçërisht për pastrimin e parave. Si pronarë, e kanë më të lehtë që të pastrojnë fonde nëpërmjet kalimit të parave në arkë. Shtimi i numrit të pikave të lojërave të fatit, si makina elektronike, e bëjnë më të vështirë situatën, pasi pastruesit e parave të pista mund t'i humbasin të gjitha paratë në makinat e lojërave të fatit, dhe më pas i regjistrojnë si fitime, duke qenë vetë pronarët e pikës së kumarit.¹⁷⁷

Llogaritë e lojërave të fatit në internet, që nuk i verifikojnë në mënyrë të hollëshishme identitetin e klientëve të tyre, ofrojnë mundësi të tjera. Pastruesit e parave mund të hapin një llogari, të vendosin disa baste me shuma të vogla, dhe më pas i tërheqin paratë e mbetura nga llogaria. Po të hapësh dhjetëra llogari me shuma të vogla, e mban shumën e transaksioneve nën kufirin e lejuar, duke evituar kështu raportimin për transaksion të dyshimtë. Lojërat e fatit në internet janë veçanërisht të vlefshme për lëvizjen e parave jashtë vendit, pasi fondet mund të depozitohen në llogari bastesh kudo nëpër botë.¹⁷⁸

Për të zbutur efektet negative të kumarit, si Shqipëria ashtu edhe Kosova nxorren jashtë ligjit, në fillim të vitit 2019, shumicën e formave të lojërave të fatit, duke përfshirë pikat e basteve, makinat elektronike, dhe faqet e lojërave në internet. Në Shqipëri, lejohen të zhvillojnë aktivitetin vetëm kazinotë në hotele luksoze, bingo në televizion, dhe llotaria kombëtare. Llogaritej se shqiptarët harxhonin rreth 700 milionë euro në vit për baste sportive, dhe vetëm 150 milionë euro në baste vendoseshin në kompani legjitime.¹⁷⁹ Kryeministri tha se ndalimi i lojërave të fatit u bë për të dhënë 'një mesazh të qartë kundër krimit të organizuar që pastron para nëpërmjet këtyre aktiviteteve'.¹⁸⁰ Partia opozitare pretendon se paratë e paligjshme që më parë pastroheshin nëpërmjet kazinovë dhe lojërave të fatit, tani janë spostuar në ndërtim.¹⁸¹

Edhe në Kosovë, kumari ishte shumë i përhapur, veçanërisht bastet sportive, dhe shumë të rinj të papunë luanin 'për të provuar fatin'.¹⁸² Përpara ndalimit me ligj, kishte 12 kompani të mëdha kumari, me më shumë se 470 pika të hapura në të gjithë vendin, dhe sektori ziente nga aktiviteti i paligjshëm. Në vitin 2018, këtyre kompanive iu vendosën 700 gjoba, dhe pati 18 denoncime penale, u konfiskuan më shumë se 100 makina elektronike, u hoqën 28 licenca, dhe u mbyllën 301 pika.¹⁸³ Sektori dominohej nga persona që kishin lidhje me politikanë të nivelit të lartë, dhe madje thuhet se politikanë të korruptuar i humbnin në kumar paratë e fituara nga aktivitete ilegale, dhe më pas merrnin mbrapsht të ardhura të pastruara nga biznesi i lojërave të fatit.¹⁸⁴

Një numër i madh ambientesh që më parë funksiononin si kazino apo pika bastesh janë kthyer në kafene, restorante, dhe hotele, që vazhdojnë të përdoren për potencialin që kanë për pastrim parash. Shumë prej tyre përdoren në mënyrë të paligjshme për kumar, apo për të vënë baste për lojëra fati në internet. Në këtë mënyrë, kumari vazhdon por qeveria nuk merr më taksa, dhe grupet kriminale kanë më shumë kontroll në këtë sektor. Persona të intervistuar për këtë raport thanë se policia e Kosovës po heton mbi këtë çështje, por si pasojë e ndërhyrjeve politike dhe korrupsionit, shumë aktivitete vazhdojnë pa hasur në ndonjë problem.¹⁸⁵

Kumari është akoma i ligjshëm në Maqedoninë e Veriut. Ka shumë pika bastesh sportive të hapura anembanë vendit, si dhe shumë faqe bastesh në internet, dhe qeveria nuk ka dhënë ndonjë shenjë se do të ndjekë shembullin e fqinjëve të saj dhe të ndalojë kumarin.¹⁸⁶ Si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë, ky sektor shihet i lidhur ngushtë me persona që mbajnë apo kanë mbajtur poste publike, dhe me nivele të larta korrupsioni. Një operacion policor, në vitin 2012, arrestoi 23 pjesëtarë të një familjeje të krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë ish-kryetarë

bashkie, të afërm politikanësh, si dhe anëtarë të partisë në pushtet asokohe, për krime të lidhura me kumarin e paligjshëm.¹⁸⁷

Pas mbylljes së lojërave të fatit në Shqipëri dhe Kosovë, shumë kompani kumari hapën degë në Maqedoninë e Veriut, dhe pika lojërash pranë kufirit me Kosovën, apo u zhvendosën në zona që kontrollohen nga Misioni NATO në Kosovë (KFOR), si fshati Karacevo.¹⁸⁸

Karaceva (që shkruhet edhe Karacevo) është një fshat që ndodhet në kufi me Serbinë, në një zonë neutrale, sipas Marrëveshjes së Kumanovës të vitit 1999. Në marrëveshje thuhet se ka një zonë sigurie tokësore prej pesë kilometrash (pra zonë neutrale) përgjatë kufirit, që kontrollohet nga KFOR, dhe policia kosovare nuk mund të hyjë në këto zona pa marrë leje nga KFOR. Kumari zakonisht tërheq kriminelë nga vendet fqinje për pastrimin e parave, dhe kontrolli i dobët shtetëror mbi lëshimin e licensave të kumarit e bën akoma më të lehtë këtë proces. Maqedonia e Veriut po zhvillon në mënyrë aktive sektorin e turizmit, dhe pritet që ndalimi i kumarit në Shqipëri dhe Kosovë të shkaktojë më shumë trafik ndërkufitar.

Manipulimi me faturat

Task Forca ndërqeveritare për Veprimin Financiar (TFVF) e konsideron manipulimin me faturat si një nga tre metodat kryesore të kalimit të vlerave monetare pa i lëvizur fizikisht paratë – si dhe një nga kanalet kryesore për PFP. Ndonëse ka mënyra të shumta për të abuzuar me transaksione tregtare dhe financimin e tyre, në thelb zhvillohet e njëjta lojë: falsifikimi i qëllimshëm i vlerës, volumit dhe/apo lojit të mallit në një transaksion tregtar ndërkombëtar mallrash apo shërbimesh, për të manipuluar me vlerën dhe për të shmangur tarifa doganore. Diferenca midis vlerës së vërtetë dhe vlerës së deklaruar shërben si për të shmangur pagesën e taksave, ashtu dhe për të lëvizur sasi të mëdha parash përmes kufijve ndërkombëtarë. Rritja e volumit të tregtisë në ekonominë e globalizuar e ka amplifikuar nivelin dhe vlerën e pastrimit të parave nëpërmjet tregtisë.¹⁸⁹ Një ekspert mbi PFP nga Maqedonia e Veriut mendon se ky lloj 'aktiviteti informal' stimulohet edhe nga kompani vendase që nuk kanë shumë mundësi për të kaluar produktet e tyre në tregjet e huaja.¹⁹⁰

Lëshimi i një fature me vlerë më të ulët se realiteti zakonisht bëhet me kërkesën e firmës importuese, për të paguar më pak taksa importi. Por kjo shkon edhe në favor

të eksportuesit, pasi reduktohet vlera e tatueshme në faturë. Në shumicën e rasteve, këtu fitojnë të dy palët – dhe humbasin të dy shtetet.

Nënfaturimi shoqërohet nganjëherë edhe me kalime të paligjshme të parave të thata, ku blerësi kalon përmes kufirit sasira më të vogla parash (nën limitin e raportimit prej 10,000 eurosh) për të paguar për mallrat që i dorëzohen me një vlerë më të ulët në faturë se vlera reale, ashtu si tregohet edhe në skemën e figurës 12.

Një nga treguesit e manipulimit me faturat në tregtinë ndërkombëtare është raporti ndërmjet të ardhurave nga tregtia (që pasqyrohet nga deficit i llogarisë korrente) dhe rezervat e këmbimit valutor. Në Shqipëri, në periudhën 2017–2019, rezervat e këmbimit valutor u rritën me 3.2 miliardë euro, nga 6.7 miliardë euro në 9.9 miliardë euro. Statistikat mbi volumin e shkëmbimeve tregtare nuk i justifikojnë këto shifra, pasi tregohet një rritje me vetëm 52 milionë euro për vitin 2018, dhe një shifër të ngjashme edhe për vitin 2019 (figura 13).¹⁹¹ Ekspertët që u konsultuan për këtë raport mendonin se afro tre miliardë euro hynë në vend në mënyra që nuk pasqyrohen në të dhëna të shkëmbimeve tregtare apo fiskale.




FIGURA 12 Nën-faturimi i shoqëruar me transferta të paligjshme parash




FIGURA 13 Deficiti i llogarisë korrente shqiptare (blu) dhe kursi mesatar i këmbimit Lek me Euro (2008–2019)

BURIMI: Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë konfirmon se gjatë periudhës 2016–2020 janë vënë re më shumë prurje në këmbime valutore se më parë. Këto mospërputhje në balancat tregtare nuk mundet dhe nuk duhet t'i faturohen vetëm prurjeve të paligjshme, pasi një pjesë e saj mund të shkaktohet si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, apo çrregullimeve të tjera teknike. Sidoqoftë, ekspertët mendojnë se 80 për qind e tyre mund të jenë PFP, që i atribuohen të ardhurave nga droga, dhe manipulimet me faturat në shkëmbimet tregtare dhe shërbime.¹⁹²

Në korrik 2019, ministria shqiptare e financave njoftoi ngritjen e një sistemi faturimi online për të reduktuar evazionin fiskal. Kjo iniciativë u ndërmor pasi kontrolle në sektorin e hotelierisë zbuluan se 1,600 hotele nuk ishin regjistruar në drejtoritë tatimore.¹⁹³ Mbetet për të parë nëse kjo iniciativë do të arrijë të zgjidhë problemet e shumta në sistemin e monitorimit dhe mbikqyrjes së tregtisë.

Integriteti Global Financiar dhe përlogaritjet e PFP nga tregtia

Integriteti Global Financiar (IGF) përdor treguesin e FMN për manipulimin me çmimet për të llogaritur volumin e PFP që dalin nga vendet në zhvillim. IGF llogarit se rreth 80 për qind e PFP gjenerohen nëpërmjet manipulimit me faturat.¹⁹⁴

Përlogaritjet e tyre bazohen mbi dy kritere: manipulimi me çmimet në tregti, dhe 'rrjedhjet' nga balanca e pagesave. Për të arritur në këto përfundime, IGF analizon hendekun tregti/vlerë monetare, duke shqyrtuar diferencat midis importeve dhe eksporteve të deklaruara nga një vend, dhe balancës së importeve dhe eksporteve në vendet e origjinës dhe destinacionit. Kjo metodologji nënkupton se e gjithë diferenca mund t'i atribuohet manipulimeve me çmimet tregtare për qëllime kriminale.

IGF nuk jep shifra për PFP në Kosovë, por i jep këto të dhëna për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Analiza e IGF për Maqedoninë e Veriut sugjeron se fluksi i daljes së fondeve të paligjshme gjatë periudhës 2004–2013 ishte mesterisht me 516 milionë dollarë çdo vit, ndërkohë që përlogaritjet se kulmi u arrit në vitin 2008, me 928 milionë dollarë. Statistikat tregojnë se gati 97 për qind e këtyre parave dolën jashtë Maqedonisë së Veriut nëpërmjet faturave të falsifikuara që e rrisnin në mënyrë fiktive vlerën e mallrave dhe shërbimeve në eksport/import.¹⁹⁵

Në Shqipëri, përlogaritjet e IGF sugjerojnë se 123 milionë dollarë humbën si pasojë e manipulimit me çmimet tregtare nga 2004 deri në 2012, por edhe në këtë rast maksimumi u arrit në vitin 2008, me 305 milionë dollarë. Vlerësimi kumulativ për periudhën 2008–2017 arrin në 5.5 miliardë dollarë. Nga viti 2013 deri në 2017, nënfaturimi në import dhe mbifaturimi në eksport përfaqëson 21.8 për qind të volumit total të shkëmbimeve tregtare të vendit. Kjo shifër është shumë e lartë, edhe në krahasim me vende të tjera në zhvillim.

Metodologjia e përdorur nga IGF është kritikuar gjerësisht pasi futen në të njëjtën kategori mallra me çmime të përcaktuara nga tregu, së bashku me mallra fizike që kanë vlera abstrakte (si vepra arti), dhe mallra jo fizike (shërbime).¹⁹⁶ Manipulimi me faturat është veçanërisht i vështirë që të përlogaritet kur çmimet e mallrave nuk janë përcaktuar apo nuk ka çmim reference.

Pavarësisht nga kritikata, kjo përqasje ka vlerë analitike. Ashtu si thotë edhe IGF në mbrojtje të metodave të saj: pavarësisht nëse manipulimi me faturat është apo nuk është përgjegjës për sasinë e plotë të PFP, shumë pak vetë mund të hedhin poshtë faktin se ky fenomen shkakton një hemoragji fondesh me pasoja të rënda për zhvillimin e një vendi. Kësaj i bëhet jehonë edhe nga pika OZHQ 16.4, nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në lidhje me PFP.

Transferimi i parave

Kontrabanba e parave të thata është një tjetër kanal për lëvizjen e paligjshme të vlerave monetare, veçanërisht në ekonomi që dominohen nga pagesat me para në dorë, si vendet e Ballkanit perëndimor, me nivel të lartë informaliteti në sektorin e financave.¹⁹⁷ Në një ekonomi të tillë, elementë të paligjshëm mund të akumulojnë, transferojnë, dhe absorbojnë me lehtësi shuma të mëdha parash, pa lënë gjurmë në sistemin financiar zyrtar, dhe për pasojë është e vështirë që të përlllogaritet shkalla e këtyre prurjeve.

Shumica e transferimeve të parave të thata realizohet duke kaluar kufirin me makina, kryesisht në pika zyrtare të kalimit të kufirit. Kontrolli në pikat kufitare është i dobët, dhe shumica e tyre nuk kanë personel të mjaftueshëm, kështu që kalimi i kufirit me para me vete nuk paraqet shumë rrezik. Për shembull, policia kufitare dhe doganat e Kosovës, e pranojnë faktin se puna e tyre përqendrohet në ndaljen në kufi të mallrave të paligjshme dhe drogave, dhe nuk i kushtojnë shumë vëmendje parave që hyjnë e dalin nga vendi.¹⁹⁸ Sidoqoftë, sasia e parave kesh që konfiskohet nga autoritetet jep një ide mbi shkallën e problemit. Në një rast të bujshëm në qershor 2018, doganierët e portit të Durrësit konfiskuan 3.4 milionë euro në rimorkion e një kamioni që vinte nga Belgjika.¹⁹⁹

Administrata e doganave në Maqedoninë e Veriut konfiskon çdo vit miliona euro kesh, në valuta të huaja, në pikat e kalimit kufitar, gjatë periudhës midis 2011 dhe 2019.²⁰⁰ Pikat kryesore të kalimit kufitar në Maqedoninë e Veriut janë Bogodolica, Tabanovce, dhe aeroporti ndërkombëtar i Shkupit. Shumica e këtyre parave iu konfiskuan shtetasve maqedonas, të ndjekur nga shtetas të huaj nga vendet fqinje, si Greqia, Serbia, dhe Kosova, si dhe nga shtetas turq. Paratë kesh zakonisht konfiskohen nga shtetas maqedonas që dalin nga vendi, ndërsa shtetasit e huaj kapen me shuma të mëdha me vete si duke hyrë, ashtu dhe duke dalë nga vendi.²⁰¹

Korrierët e parave udhëtojnë rregullisht ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, dhe Britanisë së Madhe, duke marrë me vete jo më shumë se 10,000 euro për çdo rrugë për të mos rënë në sy. Pjesëtarët e grupeve kriminale i kërkojnë të afërmeve të tyre, miqve, apo shqiptarëve të tjerë që kanë shkuar për pushime, që të transportojnë para në vendin e tyre në këmbim të një shpërblimi të vogël. Spanja është identifikuar si bazë e rëndësishme e korrierëve të parave për në Shqipëri.²⁰² Ligji shqiptar thotë se përveç nisjes së procedimeve penale, duhet të vendoset edhe gjobë për mosdeklarim parash në kufi. Sidoqoftë, një zyrtar i lartë i anti-kontrabandës në doganat shqiptare, që u intervistua për këtë raport, shpjegoi se si ligji mund të keqinterpretohet. 'Për shembull,' shpjegoi zyrtari, 'po u kape me 50,000 euro me vete, mjafton të paguash një gjobë 500 euro për mosdeklarim parash, dhe mund të largohesh duke i marrë paratë me vete.'²⁰³

Rastet e kontrabandës së parave rrallë raportohen në media pasi nuk konsiderohen si lajme të rëndësishme. Statistikat në Maqedoninë e Veriut tregojnë se, për periudhën 2010-2015, më shumë se 150 milionë euro u deklaruan në hyrje, dalje, apo kalim tranzit në pikat e kalimit kufitar, por vihet re se ka një tendencë në ulje në deklarimin e shumave në valutë të huaj në kufi.²⁰⁴ Origjina e këtyre shumave me para nuk mund të përcaktohet me saktësi, por ka vend për dyshim, qofshin këto para të deklaruara apo jo. Individët që nuk i deklarojnë paratë që kanë me vete shkelin ligjin, ndërsa ata që i deklarojnë shumat që po mbartin duhet të japin arsye pse mbajnë me vete shuma të mëdha në kesh, në vend që të përdorin transaksione bankare dhe transfertat të shpejta të parave në sistemin financiar zyrtar.

Biznesmenë të fuqishëm që punojnë në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut mbajnë me vete shuma të mëdha parash kur udhëtojnë nga një vend në tjetrin. Gjatë një interviste, një punonjës doganash përmendi emrin e një biznesmeni, që dyshohet se

Biznesmenë të fuqishëm me aktivitete në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut kalojnë kufijtë mes këtyre vendeve duke mbajtur me vete sasi të konsiderueshme parash kesh.




FIGURA 14 Kursi i këmbimit valutor, Lek – Euro (2001–2020)

BURIMI: Oanda, Konvertues Valutash, <https://www1.oanda.com/currency/converter/>

transporton para ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, edhe ngaqë ka investime në të dy vendet. Punonjësi i doganave tha, 'Nuk guxon njeri t'ia kontrollojë bagazhin e makinës, kaq i fuqishëm është. Askush nuk guxon ta ndalojë dhe t'i kontrollojë makinën.'²⁰⁵

Grupet e krimit të organizuar përdorin rrjetet e tyre të shpërndarjes për të transportuar drogë nëpër Evropë, si dhe për të sjellë fitimet në Shqipëri. Mendohet se paratë kesh transportohen nëpër kufij me kamionë të kompanive të import-eksportit, si dhe me makina të vogla me ndarje të fshehta. Një shqiptar tha se kjo është edhe metoda më e preferuar për të sjellë në vend fitimet nga aktivitete kriminale: 'Është e lehtë të fshehësh para në kamionë me mallra. Shoferët e kamionëve zakonisht paguhen sipas distancës që përshkojnë, por nuk marrin rroga të mira. Për këtë arsye bëjnë një vend bosh në kamion për të transportuar para të thata.'²⁰⁶

Shoferët marrin një përqindje nga paratë që transportojnë, që zakonisht shkon nga tetë deri në 15 për qind të shumës, dhe të paktën 10 për qind e lart kur paratë transportohen nga Londra. Personi i intervistuar tha se 'djemtë e Londrës' paguajnë më shumë, pasi zakonisht kanë shuma të mëdha nëpër duar. Këto para mund të jenë fituar në mënyrë të ndershme, por shumë shqiptarë që punojnë në Londër nuk kanë leje qëndrimi dhe paguhen me para në dorë. Paratë më pas u besohen individëve me pasaporta të vendeve të BE-së, që i transportojnë përmes kufijve deri sa arrijnë në shtëpi, si remitanca për familjen e emigrantit.'²⁰⁷

Kur u pyet në lidhje me kanalet e përdorura nga politikanët për të lëvizur para kesh jashtë vendit, një doganier shqiptar tha: 'Shumë e thjeshtë: mjafton të bashkëpunosh me drejtorin e përgjithshëm të doganave, që nuk i kontrollohet

makina kur kalon kufirin. Kështu ndodh zakonisht në kufirin me Greqinë. Paratë transportohen në kesh, dhe depozitohen në banka offshore nëpërmjet kanaleve të ligjshme.'²⁰⁸

Shërbimet e këmbimit valutor

Një sërë skemash përdorin këmbimin valutor për të lëvizur vlera monetare në mënyrë të paligjshme, dhe përdorimi shumë i gjerë i këtyre transaksioneve manipulative mund të kenë shkaktuar një rritje artificiale të vlerës së lekut që nga viti 2016.

Kursi i këmbimit në Shqipëri përcaktohet nga regjimi i rrjedhës së lirë të valutës. Pas një periudhe gjashtëvjeçare stabiliteti, nga 2010 deri në 2016, leku filloi të forcohej dukshëm kundrejt euros (figura 13), dhe një shportë me valuta të ndryshme. Disa ekspertë mendojnë se kjo erdhi si pasojë e kanalizimit të fondeve të paligjshme në Shqipëri, pasi këto ndryshime nuk mund të shpjegohen vetëm me zhvillimet në ekonominë formale.'²⁰⁹

Në vitin 2019, deficitit tregtar i Shqipërisë u rrit me 195 milionë euro, afro 40 për qind më shumë se në vitin 2018. Ky deficit duhet ta kishte dobësuar pozitën e lekut në raport me euron, por përkundrazi, leku u forcua. Bashkëbiseduesit tanë nga Banka e Shqipërisë ia atribuon këto ndryshime prurjeve të pazakonta të valutës – 19.2 për qind më shumë gjatë vitit 2019, në krahasim me vitin e kaluar.

Ndërkohë, u shtuan edhe kursimet në valuta të huaja në Shqipëri: në janar 2020, 54.7 për qind e të gjitha depozitave ishin në valutë të huaj, në krahasim me 50.6 për qind në janar 2016.'²¹⁰

Kompanitë e këmbimit valutor kanë luajtur një rol të madh në qarkullimin e parave të pista. Gjatë viteve të fundit, janë hapur shumë firma të reja të këmbimit valutor në vend, me 58 kompani të regjistruara vetëm për vitin 2018. Xhiroja totale e të gjithë pikave të këmbimit valutor ishte 73 milionë euro në vitin 2018.²¹¹ Kompanive të këmbimit u lejohet me ligj që të blejnë dhe shesin valutë, në varësi të kapitalit të tyre, por ato blejnë dhe shesin valutë me kërkesë të klientëve të tyre, për shuma që shkojnë deri në dy milionë euro në ditë.²¹² Sipas një operatori në treg, kjo jo vetëm që është në kundërshtim me ligjin, por transaksione të atij niveli kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kursin e këmbimit. Mendohet gjithashtu se disa kompani këmbimi valutor lëshojnë kredi afatshkurtra, me interesa të lartë për bizneset.²¹³

Nga Maqedonia e Veriut vjen një shembull mbi një tjetër kanal për transferime të parave kesh përmes kufijve, si dhe manipulime me këmbimin valutor: transfertat e shpejta të parave. Ky vend ka nëntë kompani për transfertat e shpejta të parave, që përdorin tre sisteme globale elektronike për transferimin e parave (Western Union, MoneyGram, dhe RIA). Gjashtë nga këto kompani janë banka, ndërsa tre të tjerat funksionojnë ligjërisht me licensa të lëshuara nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BKRMV). Këto shërbime përdoren kryesisht nga diaspora për të transferuar para për të afërmit e tyre në Maqedoninë e Veriut, dhe përdorimi i tyre po përhapet gjithnjë e më shumë.

Transfertat e shpejta të parave kryhen në dy monedha: euro dhe dollarë amerikanë. Ligji në Maqedoninë e Veriut për shërbimet e transfertave të shpejta të parave cakton një kufi ditor prej 2,500 eurosh për person në dërgime parash, dhe limit prej 5,000 eurosh në ditë për tërheqje parash, ndërsa kompania që kryen këtë shërbim është e detyruar që të njoftojë administratën tatimore mbi të gjitha transaksionet mbi 1,000 euro në fund të çdo dite pune.²¹⁴ BKRMV akordon licensa sipas kriterëve të përcaktuara qartë, ndërsa Banka dhe Njësia Informative Financiare mbikqyrin huadhënësit dhe filialet. Por në realitet, respektimi i rregullave dhe kriterëve nuk monitorohet ashtu si duhet, dhe sistemi mund të manipulohet lehtë nga pala dërguese, pasi degët dhe filialet mund të manipulohen që të tejkalohet kufiri i transfertave për person.²¹⁵

Mashtrime me kartat e kreditit

Zyrtarët e doganave në Maqedoninë e Veriut përmendën mashtrimet me kartat e kreditit, dhe falsifikimin e identitetit, si metoda të tjera për kalimin e vlerave monetare përmes kufijve pa i deklaruar në doganë. Shtetas të huaj përdorin letërnjoftime dhe karta bankare të falsifikuara për të blerë mallra të shtrenjta, pajisje elektronike (celularë, kompjutera), apo bizhuteri, që më pas mund të vishen, apo merren me vete si pajisje personale përmes kufijve shtetërorë, dhe të konvertohen në para diku tjetër.

Kanale të llogarive kapitale

Jo të gjitha fondet që kalojnë si PFP krijohen nga aktivitete kriminale. Disa prej tyre fitohen në mënyrë të ligjshme, gjysëm legjitime, apo në mënyrë informale, por më pas kthehen në fonde të paligjshme, kur transferohen në kundërshtim me ligjet kombëtare apo ndërkombëtare. Në këtë kategori hyn evazioni fiskal, manipulimi me faturat, transferimi në para kesh, dhe skema të tjera.²¹⁶ Këto transaksione mund të përdorin infrastrukturën e sistemit global financiar, duke përfutur nga numri gjithnjë në rritje i shteteve dhe territoreve që aplikojnë sekretin bankar, duke e kamufluar origjinën dhe destinacionin e prurjeve të paligjshme.

Ashtu si u përmend më lart, të ardhurat kriminale nga trafikimi i drogës krijohen në BE dhe investohen në vendin mëmë, dhe anembanë botës. Politikanë dhe elita të korruptuara, që janë pasuruar nëpërmjet krimit dhe ryshfeteve, i transferojnë pasuritë e tyre në

parajsa financiare. Të dhënat e dala nga Dokumentet e Panamasë treguan se shumë individë nga Ballkani perëndimor, dhe kompani të lidhura me vendet e Ballkanit perëndimor, kanë depozituar sasi të mëdha parash në banka offshore.²¹⁷

Shumë nga personat e intervistuar për këtë raport përmendën rolin e internetit dhe kriptomonedhave, si bitcoin, për të lëvizuar para në mënyrë të paligjshme brenda e jashtë rajonit, dhe kudo nëpër vendet e Ballkanit perëndimor. Deri më sot, ka shumë pak të dhëna për të mbështetur këto pretendime, dhe është e vështirë të gjykosh se sa të përhapura janë këto teknika.²¹⁸

Duket qartë, nga të dhënat e paraqitura këtu, se ka një përhapje të gjerë të aktivitetit të pastrimit të parave në ekonominë legjitime në secilin nga tre vendet. Këto para investohen tek partitë politike, apo pastrohen nëpërmjet pasurive të paluajtëshme, ndërtimit, tregtisë me pakicë, si dhe në një sërë sektorësh të tjerë të ekonomisë brenda vendit, në rajon, dhe më gjerë.²¹⁹ Sidoqoftë, prurjet nga jashtë rajonit zakonisht tërheqin më shumë vëmendje.

Prurjet nga jashtë rajonit

Para nga diaspora dhe aktivitete kriminale jashtë rajonit dërgohen dhe pastrohen në ekonominë e Ballkanit perëndimor. Këto para shpesh përdoren për të ndërhyrë në procese politike e elektorale, ashtu si dëshmohet edhe nga akuza të shumta për financime të paligjshme të fushatave elektorale, donacione të huaja për parti dhe kandidatë, si dhe 'valixhe të zeza' me para të pista që kalojnë dorë më dorë, pavarësisht nga hapat formale ligjore për të përmirësuar integritetin elektoral.²²⁰

Sa për të dhënë një shembull: prokuroria serbe kundër krimit të organizuar urdhëroi një hetim rreth një çështjeje mashtrimi ndërkombëtar, që përfshinte edhe abuzim me pushtetin, evazion fiskal, dhe pastrim parash, për periudhën 1 janar 2015 – 14 dhjetor 2017. Nga 36 personat e akuzuar, 16 janë arrestuar. Këta individë kishin regjistruar katër kompani në Serbi, dhe një në Londër. Në Maqedoninë e Veriut, kishin hapur llogari bankare si persona jo-rezidentë. Në kompanitë serbe vinin para, në bazë të faturave false për shërbime të ndryshme, nga firma të regjistruara në Agjencinë Serbe të Regjistrimit të Bizneseve. Më pas, grupi transferoi rreth 518 milionë dinarë serbë (rreth 5 milionë euro) tek llogaritë jo-rezidenciale në Maqedoninë e Veriut. Pjesëtarë të grupit shkuan në Maqedoninë e Veriut, tërhoqën paratë, dhe i transferuan në Serbi në shuma më të vogla se 10,000 euro. Pjesëtarët e grupit kriminal më pas ia kthyen mbrapsht fondet kompanive që kishin bërë derdhjet, duke mbajtur nga 6 për qind deri në 10 për qind të shumave, duke siguruar fitime të paligjshme prej rreth 400,000 eurosh, dhe duke i shkaktuar një dëm prej 800,000 eurosh buxhetit të Serbisë.²²¹

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

- PFP hyjnë dhe transferohen nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut nëpërmjet katër kanaleve kryesore: transferim parash kesh, manipulim faturash, pastrim parash, dhe llogari kapitali.
- Ndonëse pastrimi i parave shpesh konsiderohet si ekuivalenti i PFP, në fakt është vetëm procesi nëpërmjet të cilit të ardhurat e krimit hyjnë (të maskuara) në sistemin financiar legjitim.
- Ndërtimi dhe pasuritë e paluajtëshme, kumari, dhe shkëmbimet tregtare janë identifikuar si sektorët më të rëndësishëm për pastrimin e parave në të tre vendet. Duke përdorur të dhëna nga kreditë bankare për blerje shtëpie, një ekspert llogariti se rreth 500 milionë euro ishin pastruar nëpërmjet sektorit të pasurive të paluajtëshme në Shqipëri, vetëm gjatë vitit 2019.
- Ndonëse lojërat e fatit u ndaluan me ligj në Shqipëri dhe Kosovë, në fillim të vitit 2019, ka të dhëna se kumari vazhdon akoma në mënyrë të paligjshme, ndërsa kompanitë kanë hapur filiale në Maqedoninë e Veriut, ku lojërat e fatit janë akoma të ligjshme. Disa kompani kosovare i kanë zhvendosur aktivitetet e tyre në zona ushtarake të kontrolluara nga KFOR.
- Nënfaqsimi i mallrave dhe shërbimeve, që minimizon pagesën e taksave dhe krijon hapësira për pastrim parash, është një praktikë e zakonshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.
- Kontrabanda e parave është një nga metodat më të thjeshta për të transferuar vlera monetare në mënyrë të paligjshme. Si pasojë e përmasave të mëdha të sektorit informal, transaksionet në vendet e Ballkanit perëndimor zakonisht kryhen me para në dorë. Paratë kesh zakonisht transportohen me makina private apo në kamionë që kalojnë kufirin, shpesh të futura në ndarje të fshehta.
- Shërbimet e këmbimit valutor dhe mashtrimi me kartat e kreditit janë mënyra të tjera për të transferuar para në mënyrë ilegale.
- PFP nga përtej rajonit tërheqin më shumë vëmendjen, si në rastin e grupeve të krimit të organizuar që akumulojnë fitime të paligjshme në BE, dhe i pastrojnë paratë në ekonomitë e Ballkanit perëndimor. Ka të dhëna se individë dhe kompani të lidhura me rajonin kanë depozituar shuma të mëdha në parajsa financiare.



© Omar Marques/
Getty Images

VLERËSIMI I REAGIMIT NDAJ PFP NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Ky kapitull i raportit analizon përparimet e arritura në ngritjen e mekanizmave ligjorë, rregullatore, dhe zbatuese në përpjekjet kundër PFP.

Përpara se të gjykohen përpjekjet e këtyre vendeve për të luftuar PFP, duhet të kemi parasysh faktin se kjo është një sfidë shumë e vështirë, dhe në mbarë botën ka shumë pak vende – për të mos thënë asnjë – që mund të thonë me plot gojë se po ia dalin me sukses. Ashtu si u shpjegua dhe në kapitujt e mësipërm, PFP shfrytëzojnë çdo pikë të dobët të institucioneve shtetërore, ndërkohë që destabilizojnë dhe sabotojnë qeverisjen, integritetin, dhe pushtetin e ligjit.

Koncepti i përgjithshëm i Prurjeve Financiare të Paligjshme, paralelisht me mungesën e një përkufizimi të qartë dhe gamën e gjerë të këtij fenomeni, nuk është shumë i dobishëm përse i përket hartimit të një plani praktik për t'u përballur me PFP. Lufta vazhdon në shumë fronte – krimi i organizuar, korrupsioni, varfëria, pabarazia, dhe injorimi financiar – por asnjë nga këto beteja nuk fitohet me lehtësi. Ky është gjithashtu një problem ndërkombëtar që kërkon zgjidhje dhe përgjigje kolektive. Sistemet e ndryshme tatimore dhe ligjore, ekzistenca e parajsave financiare, zonat e tregtisë së lirë, dhe juridiksionet sekrete, sabotojnë përpjekjet e vendeve dhe krijojnë stimuj negativë për PFP. Suksesi në këtë drejtim, apo mungesa e tij, në Ballkanin perëndimor duhet analizuar në këtë kontekst.

Elementë kriminalë lëvizin nëpër rajon duke reaguar ndaj ndryshimeve në vende të caktuara, në lidhje me bazën ligjore dhe zbatimin e ligjit. Për shembull, ndalimi me ligj i kumarit, në vitin 2019, në Shqipëri dhe Kosovë, i detyroi kompanitë e lojërave të fatit që të lëviznin në Maqedoninë e Veriut për të vazhduar aktivitetin e tyre. Pagesat dhe transferimet e parave për aktivitete kontrabande kryhen me para në dorë, paguhen me mallra të tjera, apo edhe shkëmbehen në një sistem kompleks transferimesh parash,

që duket sikur nuk njihet kufij dhe probleme. Oficerë policie nga Kosova përshkruan situatën e krijuar në fshatrat përgjatë kufirit – duke përfshirë edhe ato që kontrollohen nga KFOR, dhe që mbeten jashtë juridiksionit të policisë kombëtare – një situatë që shfrytëzohet për kontrabandë.²²²

Detyrimi politik për të reaguar ndaj PFP vjen si parakusht për hyrjen në BE. Perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit perëndimor kërkon forcimin e pushtetit të ligjit, përparime në fushën e konkurrencës së lirë, reduktimin e niveleve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duke nënvizuar faktin se ekonomitë e rajonit nuk bazohen tek konkurrenca e lirë, ndikohen tepër nga ndërhyrjet politike, dhe se sektori privat nuk është zhvilluar sa duhet, raporti i zgjerimit të BE gjithashtu tërheq vëmendjen mbi

elementë të kapjes së shtetit, duke përfshirë lidhje me krimin e organizuar, korrupsion në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe ngatërrim të interesave publike dhe private. E gjitha kjo krijon një atmosferë pandëshkueshmërie dhe pabarazie. Po kështu ka ndërhyrje të fortë politike, dhe kontroll mbi mediat. Një sistem juridik i fortë dhe i pavarur, qeveri dhe administrata të përgjegjshme, janë faktorë thelbësorë për të realizuar ndryshimet e nevojshme shoqërore.²²³

Baza legjislative dhe regullat e BE-së parashtojnë një sërë objektivash dhe standardesh që duhet të arrihen nga secili prej vendeve të Ballkanit perëndimor, përpara se të merret në konsideratë anëtarësimi i tyre,²²⁴ dhe këto vende janë angazhuar në këtë drejtim. Në mars 2020, Komisioni Evropian pranoi që të hapte negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, dhe Maqedoninë e Veriut, pasi ishin përmbushur kushtet dhe kriteret kryesore.²²⁵

BE dhe vendet anëtare kanë investuar në iniciativë për të përmirësuar kapacitetet e institucioneve kryesore shtetërore. Ndonëse shumë pak nga këto nisma kanë patur për objektiv përballjen me problemin e PFP – kjo vjen edhe nga fakti se kemi të bëjmë me një koncept akoma të ri – elemente të pastrimit të parave, krimi i organizuar dhe korrupsioni janë identifikuar qartë në këto politika dhe iniciativë. Po kështu, përpjekjet për të reformuar qeverisjen

ekonomike të vendit, dhe për modernizimin e bazës ligjore, shpesh përfshijnë elemente më rëndësi thelbësore për luftën kundër krimit ekonomik dhe PFP.

Për shembull, BE dha fonde për një projekt të UNODC për të ngritur mekanizma rajonale për luftën kundër pastrimit të parave, dhe bllokimin e financimit të terrorizmit (APP/BFT) në Evropën juglindore. Projekti, që u zhvillua nga dhjetor 2017–2019, punoi për përmirësimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për të kryer hetime financiare dhe bashkëpunuar në programe ndërkombëtare anti-pastrim parash.²²⁶ Edhe GIZ ka një program për luftën kundër krimeve serioze në vendet e Ballkanit perëndimor, që përfshin edhe hetimet financiare, procedimet penale, dhe rekuperimin e pasurive kriminale.²²⁷ Programi i saj global për luftën kundër PFP, që e trajton këtë subjekt në tërësinë e tij, përfshin edhe Ballkanin perëndimor si një rajon prioritar. Ky program kërkon të organizojë ndërhyrje dhe veprimtari parandaluese në disa nivele, duke përfshirë transparencën mbi çështje të pronësisë, vlerësimin e situatës mbi pastrimin e parave, dhe respektimin e standardeve të APP/BFT.²²⁸

Niveli i suksesit dhe efikasitetit mund të matet edhe nga numri i procedimeve të suksesshme penale për kategori të ndryshme krimi. Sidoqoftë, në vitin 2019 raporti i Komisionit Evropian mbi zgjerimin e BE-së doli në përfundimin se,

në përgjithësi, janë regjistruar rezultate të dobëta në lidhje me përfundimin e suksesshëm të procedimeve penale kundër rasteve të krimit të organizuar. Një sërë vendesh kanë arritur të dënojnë një numër shumë të ulët të akuzuarish për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, gjatë viteve të fundit. Këto rezultate të dobëta tregojnë mungesën e efektshmërisë të procedimeve kriminale, krijojnë një klimë pandëshkueshmërie, dhe shtojnë rrezikun e infiltrimit të sistemit politik dhe ekonomik nga elementë kriminalë. Këto vende duhet që të rrisin në mënyrë të ndjeshme bllokimin dhe konfiskimin e pasurive në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe t'i kundërpërgjigjen më me forcë grupeve kriminale.²²⁹

Përpjekjet kundër pastrimit të parave

Grupet kriminale dhe të korruptuarit angazhohen në mënyrë aktive në pastrimin e parave, por ekosistemi i pastrimit mundësohet nga një numër i madh profesionistësh në sektorët e financës, drejtësisë, dhe aktivitetit tregtar, që punojnë për fshehjen e parave të pista, apo që nuk pyesin fare për origjinën e fondeve të klientëve të tyre. Lufta kundër këtij fenomemi vështirësohet akoma më tepër nga shumëllojshmëria e sektorëve dhe instrumentet financiarë të përdorura për këtë qëllim. Llogaritet se më pak se 1 për qind e të gjitha të ardhurave të krimit, që pastrohen në ekonomi, bllokohen apo konfiskohen nga autoritetet në të gjithë botën, gjatë një viti.²³⁰ Edhe Task Forca për Veprim Financiar, rojtarët e sistemit anti-pastrim parash, e pranon punën e dobët në këtë drejtim, duke i nxitur autoritetet që të ndryshojnë dhe përshtatin taktikat e tyre në varësi të situatës që del përpara.²³¹

SHQIPËRIA

Sipas raporteve nga MONEYVAL,²³² Shqipëria ka bërë përparime të ndjeshme që kur u miratua për herë të parë ligji anti-pastrim parash, në vitin 2000. Vendi ka krijuar një agjenci APP si dhe prokurorinë e posaçme anti-korrupsion. Gjatë viteve të fundit, janë miratuar një sërë ligjesh, në përputhje me direktivat e BE-së. Në bashkëpunim me organizata si MONEYVAL, Shqipëria ka intensifikuar masat e ashpra penale kundër aktiviteteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT), dhe ka ndërmarrë një proces vetingu ndaj gjykatësve.²³³ Në bazë të këtyre përparimeve dhe reformave, BE nisi procesin e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, në mars 2020.

Më 17 maj 2000, Shqipëria miratoi ligjin e parë të paketës APP (ligji 8610). Në të përfshihej edhe një përkufizim për pastrimin e parave, si dhe mekanizma parandalimi për monitorimin dhe denoncimin e aktiviteteve të pastrimit të parave. Paralelisht me miratimin e ligjit, u krijua edhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), pranë ministrisë së financave.

Tre vjet më vonë, më 19 qershor 2003, kuvendi miratoi ndryshime në paketën APP (ligji 9084). Ky ligj kërkonte nga të gjitha kompanitë që të regjistronin të gjitha transaksionet prej më shumë se dy milionë lekësh, dhe të raportnin çdo transaksion të dyshimtë nën këtë vlerë. Po kështu, ligji uli edhe kufirin e transaksioneve që duhet të raportohen automatikisht, nga 70 milionë në 20 milionë lekë. Ligji 9084 përmbante edhe ndryshime strukturore për DPPPP.

Në ekosistemin e korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në vendet e Ballkanit perëndimor, theksi që vendoset nga sistemi APP mbi raportimin e saktë dhe respektimin e normave teknike tingëllojnë si fjalë boshe. Institucionet në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut kanë miratuar legjislacion APP dhe kanë ngritur mekanizma koordinimi që i kanë rritur aftësitë informative financiare. Investimet dhe përpjekjet e konsiderueshme nga ana e këtyre vendeve për përmirësimin e bazës ligjore, për krijimin e sistemit të raportimit të transaksioneve të dyshimta (STR), dhe për promovimin e masave të tjera që duhen respektuar në sistemin financiar zyrtar – masa që e kanë treguar tashmë paefektshmërinë e tyre anëmbanë botës – duken akoma më të kota përballë shkallës së gjerë të sektorit informal, dobësisë së institucioneve rregullatore, si dhe niveleve të larta të korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në këto vende.

Më 19 maj 2008, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (ligji 9917), shënoi edhe kalimin nga paketa APP në legjislacionin APP/BFT. Ligji kërkon nga subjektet private që t'i kërkojnë klientëve të tyre dokumente identifikimi për veprime financiare. Po kështu, ligji përcakton edhe kritere monitorimi për blerjen e krediteve të kumarit me vlerë mbi 200,000 lekë, dhe çdo transaksion prej më shumë se 1.5 milionë lekësh. Ligji 9917 u ndryshua tre herë, por në dy raste pati vetëm ndryshime të vogla. Amendamenti i dytë, në vitin 2015, solli ndryshime sipas direktivave të BE 2015/849 dhe 2018/843, dhe në përputhje me rekomandimet e MONEYVAL.

Në lidhje me financimin e terrorizmit, më 10 tetor 2013 u miratua ligji 157, dhe pati ndryshime në Kodin Penal në vitin 2014. Këto ndryshime zgjeruan bazën e shkeljeve penale për përfshirjen në luftime në vende të huaja, si dhe veprimtari të lidhura me të, si rekrutimi dhe financimi. Në shkurt 2020, Shqipëria ndërmori një angazhim në nivel të lartë politik për të punuar me TFVF dhe MONEYVAL për të përmirësuar efektshmërinë e sistemit së saj APP/BFT. Procesi i monitorimit do të zgjasë dy vjet, dhe përpjekjet do të përqendrohen në sektorë ku respektimi i Rekomandimeve 40+9 të TFVF është në nivele të ulëta apo mesatare. Si rezultat, Shqipëria renditet në listën gri.

KOSOVA

Kosova ka miratuar ligje në përputhje me direktivat e BE-së, dhe ka adoptuar përkufizime mbi pastrimin e parave, që janë relativisht në linjë me rekomandimet e TFVF dhe MONEYVAL. Sidoqoftë, dispozitat e ligjeve APP/BFT nuk janë akoma të qarta, dhe e vështirësojnë punën e gjykatave. Përkufizimet duhet të rishikohen me kujdes për të eliminuar paqartësitë, dhe të jenë qartësisht të kuptueshme në serbisht dhe shqip.

Në shtator 2004, filloi punën Qendra e Inteligjencës Financiare (QIC), në përputhje me ligjet dhe rregullat e UNMIK-ut për parandalimin e pastrimit të parave dhe shkeljeve ligjore të lidhura me të (2004/2). Kjo bazë ligjore pati disa ndryshime të vogla në vitin 2005 (ligji 2005/9), dhe u amendua dy herë në vitin 2006 (2006/9, 2006/53).

Sistemi APP u ngrit për herë të parë në Kosovë në vitin 2008, po atë vit kur u deklarua edhe pavarësia. Që nga ai moment, QIC kaloi nga duart e UNMIK tek Misioni i Bashkimit Evropian për Pushtetin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Në vitin 2010, u miratua Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Nr. 03/L-196), dhe QIC u zëvendësua nga Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës (NJIF-K). Ky ligj përcakton masat, autoritetet kompetente, dhe procedurat për diktimin dhe parandalimin e aktiviteteve të PP/FT. Në vitin 2013, u miratua një ligj shtesë (Nr. 04/L-178) që bëri disa ndryshime të vogla në ligjin e vitit 2010, si përkufizime dhe ndryshime fjalësh e termash.

Në vitin 2014 u hartua një plan katërvjeçar për të luftuar ekonominë informale dhe krimin financiar (duke përfshirë edhe masat APP/BFT). Po kështu, një Udhëzim Administrativ i NJIF-K (Nr. 05/2014) përcaktoi standardet minimale, procedurat me shkrim, dhe kontrollet

për APP/BFT. Ndryshime të vogla u bënë edhe mbi ligjet APP/BFT të Kosovës, në vitin 2015 (Udhëzime Administrative të NJIF-K, respektivisht Nr.02/2015 dhe Nr.03/2015). Në vitin 2016 u miratua një ligj i rëndësishëm i paketës APP/BFT (Nr. 05/L-196). Qëllimi i tij ishte zbatimi i Direktivave të BE-së 2015/849 dhe 648/2012, si dhe anulimi i Direktivave 2005/60/EC dhe 2006/70/EC. Udhëzimi Administrativ i NJIF-K Nr. 02/2017 u miratua në vitin 2017, për nevojën e trajnimit në lidhje me APP/BFT.

Në vitin 2019, u hartua një tjetër plan katërvjeçar për periudhën 2019–2023. Aty përvijohet një strategji kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë informale dhe financimit të krimit (duke përfshirë APP/BFT).

Sidoqoftë, përpjekjet e Kosovës për të luftuar pastrimin e parave kanë mbetur në vend, pasi vetëm 11 persona janë paditur për pastrim parash, dhe vetëm katër janë dënuar nga gjykatat.²³⁴ Pjesë e strategjisë së qeverisë për të luftuar ekonominë informale ishte edhe fushata për rritjen e nivelit të lëshimit të faturave për transaksione tregtare. Bizneseve iu shpërndanë kasa regjistrimi, një veprim që u kritikua ashpër për çmimin e lartë të kasave, dhe monopolin e krijuar nga prokurimi i kasave nga ana e qeverisë.²³⁵ Një fushatë ndërgjegjësimi i ofroi qytetarëve shpërblime në para për mbledhjen dhe dorëzimin e kuponave fiskalë që lëshoheshin nga kasat tek administrata tatimore. Është për të ardhur keq, por një numër i madh biznesesh që u pajisën me kasa fiskale refuzuan që të pritnin fatura, dhe i mbanin kasat sa për të përmbushur kërkesat ligjore. Deri më tani, fushata ka patur ndikim të kufizuar, dhe duket se nuk ka vullnet politik për të përmirësuar zbatimin e masave kundër ekonomisë informale.

MAQEDONIA E VERIUT

Republika e Maqedonisë së Veriut ka miratuar bazën ligjore APP/BFT, në përputhje me direktivat e BE dhe rekomandimet e TFVF. Maqedonia e Veriut u anëtarësua në MONEYVAL në vitin 1998, dhe në qershor 2004 u bë pjesë e Grupit Egmont, një platformë ndërkombëtare e njësive informative financiare për të luftuar PP/FT. Komiteti i MONEYVAL arriti në përfundimin se vendi ishte në gjendje që të plotësonte të gjitha rekomandimet për periudhën 2014–2018, dhe e hoqi Maqedoninë e Veriut nga lista e vendeve që përmendeshin rregullisht në raportet e situatës. Në bazë të këtyre përparimeve dhe reformave, BE nisi procesin e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, në mars 2020.

Në vitin 2001, Maqedonia e Veriut aprovoi ligji e parë APP (Nr. 70/01). Tre vjet më vonë, ishte e nevojshme që të miratohej një ligj i ri për t'u përshtatur më mirë me legjislacionin ndërkombëtar. Ligji i ri (Nr. 46/04) hyri në fuqi më 20 korrik 2004.

Në vitin 2002, u krijua Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF-M) pranë ministrisë së financave. NJIF-M mbledh, përpunon, analizon, arkivon dhe dorëzon informacion mbi PP/FT.

Ligji Nr. 4/08 u miratua më 10 janar 2008. Ky ligj e kaloi fokusin nga APP tek APP/BFT, dhe solli masa të reja me rëndësi thelbësore kundër financimit të terrorizmit, për

t'u përshtatur më mirë me nëntë rekomandimet e veçanta të TFVF. Ligji i detyron bankat që të përdorin programe kompjuteri APP që i lejojnë autoritetet që të analizojnë më mirë transaksionet e dyshimta. Po kështu, bankave u kërkohet që të kryejnë analiza më të plota dhe të hollësishme mbi klientët e tyre përpara se të kryhen veprime financiare.

Mbase ligji më i rëndësishëm deri më sot (Nr. 120/18) u miratua më 26 qershor 2018, si amendament i ligjeve të mëparshme të paketës ligjore APP/BFT. Ky ligj i dha mundësi Maqedonisë së Veriut që të zbatonte masat e nevojshme për t'u përshtatur me Direktivën 4 të BE-së (2015/849), dhe pjesë të Direktivës 5 (2018/843). Disa udhëzime shtesë (186/2018, 243/2018) u aprovuan nga ministria e financave, dhe NJIF-M hartoi dokumente të tjera për të dhënë udhëzime dhe për të sugjeruar metoda për të ndihmuar punën kundër APP/BFT. Është hartuar një tjetër projektligj për t'u përshtatur më mirë me Direktivat 5 dhe 6 të BE-së.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2009, i amenduar në vitin 2018) ka disa dispozita APP. Të 13 klauzolat e nenit përcaktojnë dënimet për një gamë të gjerë aktiviteteve të pastrimit të parave, duke përfshirë gjoka, dënime me burg deri në 10 vjet, si dhe konfiskimin e të ardhurave, apo të pronave të fituara me veprimtari kriminale. Neni 98a thotë se, për një krim që lidhet me pastrimin e parave, të dënueshëm me katër apo më shumë vite burg, çdo pronë e personave të dënuar, që është blerë brenda një afati të caktuar kohor nga data e dënimit, dhe që tejkalon të ardhurat e ligjshme të personit, duhet të konfiskohet.

Raporti i fundit i vlerësimit nga MONEYVAL, në vitin 2019, arriti në përfundimin se vendi është pjesërisht në përputhje me rregullat. Raporti doli në përfundimin se, për periudhën 2014–2018, Maqedonia e Veriut i kishte përmbushur rekomandimet e bëra, dhe se baza ligjore ishte në përputhje me rekomandimet e TFVF, dhe, për rrjedhojë, edhe në përputhje me Direktivat e BE.²³⁶

Ndonëse numri i përgjithshëm i krimeve të kryera në Maqedoninë e Veriut ka rënë gjatë viteve të fundit, qeveria thotë se ka një rritje të vazhdueshme të krimeve që sjellin fitime të paligjshme.²³⁷ Sidoqoftë, për periudhën 2013–2015, vetëm pesë grupe kriminale u paditën për veprën penale të pastrimit të parave.²³⁸

Mangësi

Ka boshllëqe të rëndësishme në këtë bazë (në dukje të plotë) ligjore dhe monitoruese, por miratimi i ligjeve të mira nuk është garanci për zbatimin e tyre me sukses. Gjatë punës kërkimore për këtë studim, shpesh u regjistruan kritika mbi dispozita ligjore të paqarta dhe disi konfuze, duke e vështirësuar punën e prokurorëve dhe gjykatësve në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për çështjet që marrin në shqyrtim.

Në mënyrë ironike, zyrtarë të sistemit të drejtësisë në Kosovë vërejtën se, si rezultat i asistencës ndërkombëtare, klauzolat e ligjit mund të jenë të qarta në anglisht, por nuk janë artikuluar aq qartë në shqip apo serbisht. Kjo lë shumë vend për interpretim, veçanërisht në gjykatat e niveleve më të ulëta, ku njohja e mirë e anglishtes është më e rrallë.²³⁹ Po kështu, në Maqedoninë e Veriut, ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të ardhura të tjera kriminale, pas amendamenteve të vitit 2018 ka arritur në 160 nene, dhe është 75 faqe i gjatë. Ky lloj kompleksiteti e bën më të vështirë njohjen dhe aplikimin e efektshëm të ligjit nga sistemi penal i drejtësisë.

Për më tepër, ligji përfshin edhe detyrimin për të kryer, një herë në katër vjet, një analizë kombëtare të vlerësimit të situatës dhe rreziqeve, për të demonstruar përpjekjet e vendit për plotësimin e 13 objektivave të kërkuara.²⁴⁰ Analiza e parë u krye në vitin 2016, dhe një tjetër pritej në Qershor 2020.

Ekspertët vërejtën gjithashtu se baza ligjore dhe rregullatore vuan nga fragmentarizimi ndërmjet institucioneve të ndryshme shtetërore. Për shembull, në Maqedoninë e Veriut, institucionet mbikqyrëse përfshijnë Njësinë e Inteligjencës Financiare, Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencinë e Mbikqyrjes së Sigurimeve, dhe shumë të tjera. Organizmat shtetërore të autorizuar për ndjekje penale janë Ministria e Brendshme, Policia Financiare, Administrata e Doganave, dhe Prokuroria e Shtetit Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit. Përveç kësaj, ka edhe dispozita të tjera anti-pastrim parash në legjislacionin penal dhe bankar të Maqedonisë së Veriut.

Kapitujt e mësipërm të këtij raporti dokumentuan raste të shumta të peshqve që i shpëtojnë rrjetës të sistemit të drejtësisë, ndërkohë që volumi vjetor i PFP vazhdon të jetë goxha i lartë. Për shembull, ka shumë të dhëna që konfirmojnë faktin se sektori i ndërtimit përdoret rëndom për pastrimin e parave në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut, por megjithatë ky problem nuk përmendet shpesh në masat dhe mekanizmat APP.

Kjo tregon se, megjithëse baza ligjore është e plotë në dukje, ajo ka probleme serioze në lidhje me boshllëqe në legjislacion, dhe mangësi në zbatim, dhe këto kompromentojnë aftësitë e këtyre vendeve për të përmbushur objektivat e tyre.

Legjislacioni financiar

Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut parapëlqejnë që të tregojnë procedurat e hartuara për sinjalizimin e transaksioneve të dyshimta (STR) për të ilustruar përpjekjet për të reduktuar PFP. Transaksionet e dyshimta raportohen nga institucione të ndryshme dhe i dërgohen Drejtorive të Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të secilit vend, që mbledhin dhe publikojnë të dhënat në një raport vjetor të aktiviteteve të dyshimta. Ashtu si tregohet edhe nga tabela në figurën 14, numri i sinjalizimeve të dyshimta ka ardhur gradualisht duke u rritur.

Të dhënat më të fundit nga të tre vendet janë nga viti 2017, por një burim i intervistuar nga NJIF në Shqipëri, raportoi se kishte 1,525 sinjalizime për transaksioneve të dyshimta gjatë vitit 2018, një rritje prej 10.2 për qind në krahasim me vitin e kaluar.²⁴¹ Shifrat janë rritur vazhdimisht në të tre vendet, ndonëse me ritëm shumë më të shpejtë në Shqipëri dhe Kosovë. Ashtu si tregohet në tabelën e figurës 15, Maqedonia e Veriut mbetet shumë prapa këtyre dy vendeve.²⁴²

Sidoqoftë, regjistrimi i sinjalizimeve është vetëm një nga treguesit e respektimit të standardeve, dhe nuk është dëshmi e efektshmërisë së sistemit. Një shpërthim i menjëhershëm i numrit të STR mund të jetë tregues i një sistemi të dobët filtrimi që jep alarmin në mënyrë të panevojshme – pasi shumë nga këto sinjalizime mund të jenë alarme të rreme. Ngarkesa e tepruar, në analizimin e sinjalizimeve të kota, mund të ezaurojnë sisteme të brishta të monitorimit financiar, dhe organizmat rregullatore.²⁴³

Një tjetër pikë e dobët, që u vu në dukje nga puna kërkimore, është se institucionet përgjegjëse për identifikimin dhe parandalimin e futjes së të ardhurave kriminale në sistemin financiar nuk bëjnë analizë sasiore të këtij problemi. Raporte vjetore nga të tre vendet zakonisht publikojnë numrin e transaksioneve me para në dorë, por jo volumin apo sasinë e parave. Më këto të dhëna, është e pamundur që të bësh një vlerësim mbi sasinë e parave që hyjnë dhe dalin nga sistemi financiar. Edhe autoritetet përgjegjëse për hetimin dhe identifikimin e të ardhurave nga krimi nuk japin shifra mbi këto të ardhura.

Për shembull, në Maqedoninë e Veriut nuk ka kufi ligjor për sasinë e parave që mund të depozitohen në sistemin financiar nga një individ, apo një person juridik. Çdo bankë e përcakton vetë tavanin e depozitimit, dhe ndjek rregulla e procedura të brendshme për sinjalizimin e transaksioneve të dyshimta.²⁴⁴ Në shumicën e rasteve, minimumi i kufirit të sinjalizimit është 10,000 euro.

Sektori apo njësia sinjalizuese	2017		
	Shqipëria	Kosova	Maqedonia e Veriut
Banka	686	10	177
Kompani transferimi parash	165	5	526
Drejtoria e përgjithshme e doganave / lidhje me sigurimet	46	15	1
Drejtoria e përgjithshme e tatimeve	5	n/a	n/a
Juristë	n/a	840	1
Drejtoria e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme	83	n/a	n/a
Kompani këmbimi valutor	n/a	41	n/a
Lojëra fati / kumar	n/a	42	2
Noterë	254	74	23
Agjenci pasurish të paluajtëshme	n/a	46	n/a
Pronarë/administratorë kompanish	20	n/a	n/a
Argjendarë dhe tregtarë gurësh të çmuar	n/a	411	n/a
Institucione financiare jo-bankare	10	11	2
Revizorë	n/a	20	n/a
Shitësa makinash	101	n/a	n/a
Të tjerë	14	n/a	n/a
Totali	1 384	1 515	232

FIGURA 15 Tablo e raportimit të transaksioneve të dyshimta në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut (2017)

BURIMI: Këshilli i Evropës, Raport mbi vlerësimin e respektimit nga ana e Kosovës të standardeve ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit, 2018, <https://rm.coe.int/assessment-report-on-compliance-of-kosovo-with-international-anti-money-laundering/16809381e1>; Njësia Shqiptare e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raport vjetor 2018, http://njif.gov.al/wp-content/uploads/2019/RaportVjetore/Annual_Report_2018.pdf; Ministria e Financave (Maqedonia e Veriut), Raporti vjetor 2018, <http://www.ufr.gov.mk/files/docs/Godisenizvestaj2018.pdf>.

Përpjekjet anti-korrupsion

Në përgjithësi, korrupsioni kronik vazhdon të sabotojë përparimin e vendeve të Ballkanit perëndimor. Ashtu si u përmend më lart, BE ka arritur në përfundimin se dobësitë në zbatimin e ligjit, interferenca shtetërore në ekonomi, kapacitete të dobëta të enteve rregullatore financiare, si dhe abuzime me prokurimet publike kanë krijuar hapësira të gjera për prurje të paligjshme. Ndryshime të shpeshta në politikat rregullatore dhe tatimore krijojnë paqartësi dhe boshllëqe në sistem, që zhfrytëzohen menjëherë nga elementë kriminalë, dhe të korruptuarit.²⁴⁵

Në vitin 2018, vendet e Ballkanit perëndimor u zotuan publikisht që të luftonin korrupsionin, në përputhje me Deklaratën Botërore Kundër Korrupsionit të vitit 2016.²⁴⁶ Këtu përfshiheshin edhe një sërë angazhimesh në lidhje me prokurimet publike, konfiskimin e pasurive, edukimin anti-korrupsion, etj.²⁴⁷

Sidoqoftë, një analizë e këtyre angazhimeve nga shoqëria civile vërejtë se, pavarësisht nga shtimi 'dinamik dhe eksponencial' i masave legislative, dhe një sërë aktesh e gjestesh vizuale kundër korrupsionit dhe promovimit të transparencës, për ndershmëri dhe llogaridhënie, nuk ka patur ndonjë përmirësim real të integritetit. Po kështu ka probleme në çështje me rëndësi kritike – si akseset në informacion, financimi i partive politike, prokurimet publike, konflikti i interesit, dhe pasurimi i paligjshëm – çka tregon se kemi të bëjmë me një kuadër ligjor të pafuqishëm për t'iu kundërpërgjigjur shkeljeve më të rënda.

Ashtu si u pa edhe me sistemin anti-pastrim parash, ajo që ndodh në praktikë nuk përkon fare me objektivat dhe aspiratat që ekzistojnë vetëm në letër. Shumë akte korruptive nuk raportohen, shumë raste të denoncuar nuk procedohen, shumë raste të tjera arkivohen nga

prokuroria, apo dërgohen si me pahir në gjykata, ku çështja pastaj hidhet poshtë. Edhe për ato pak çështje ku jepet vendimi fajtor, dënimet janë shumë më të ulëta se minimumi i sanksioneve të parashikuara në ligj. Pavarësisht nga strategji dhe politika të shkruara bukur (që shpesh hartohen me nxitje dhe asistencë ndërkombëtare), mungesa e vullnetit politik bën që të dështojë përbushja e objektivave dhe synimeve të tyre.²⁴⁸

Një tjetër mangësi serioze, që u identifikua nga analiza e shoqërisë civile, është se organizmat anti-korrupsion që janë krijuar kohët e fundit në vendet e Ballkanit perëndimor zakonisht kanë detyra e përgjegjësi që kufizohen tek parandalimi, ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve, në vend që t'u lejohet mbikqyrja dhe hetimi i pavarur. Për shembull, Shqipëria nuk ka një agjenci të dedikuar kundër korrupsionit, por e ndan përgjegjësinë për zbatimin e strategjisë kombëtare anti-korrupsion midis një koordinatori kombëtar në ministrinë e drejtësisë, dhe një komiteti ndërministror: duke mos lejuar kështu aktivitet të pavarur nga qeveria. Një tjetër problem që

haset dendur është ngritja dhe funksionimi i instrumenteve të specializuara për zbatimin e ligjeve anti-korrupsion, dhe prokuroritë e gjykatat speciale. Këto organizma shpesh kanë përplasje juridiksioni me institucionet e tjera të drejtësisë penale, duke shkaktuar konkurrencë dhe politizim.²⁴⁹

Në përmbledhje: në strategjitë e ndryshme për reduktimin e korrupsionit, krimit të organizuar, dhe pastrimit të parave në vendet e Ballkanit perëndimor, nga ana teknike, respektimi i standardeve ndërkombëtare është në lartësinë e duhur për të përbushur kriteret e vendosura nga BE për zgjerim, por shumë pak ka ndryshuar në ekonomitë politike në Ballkanin perëndimor, dhe ky është ndryshimi që duhet të arrihet për një përmirësim real të situatës. Kjo sugjeron se, shqyrtimi i situatës nga këndvështrimi i PFP mund të jetë një kontribut i rëndësishëm në këtë debat, pasi një përjasje holistike, që përqendrohet mbi zhvillimin, mund të rigjallërojë këto përpjekje shumëvjeçare.

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

- Ekosistemi i prurjeve të paligjshme mundësohet nga një numër i madh punonjësish në sektorët financiarë, ligjorë, dhe tregtarë, pasi nëpërmjet shërbimeve të tyre fshihen paratë e pista. Numri i madh i sektorëve të ekonomisë të përfshirë në këtë proces e vështirëson luftën kundër këtij problemi.
- Janë bërë përparime në krijimin e mekanizmave të nevojshme ligjore, rregullatore, dhe zbatuese për t'iu kundërvënë PFP në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut. Sidoqoftë, ky përparim ka mbetur në letër, dhe zbatimi i ngadalshëm nga ana e autoriteteve ka patur pak ndikim në terren. Shembuj të shumtë tregojnë se elementë të paligjshëm reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve në zbatimin e ligjit, bazës ligjore, dhe marrëdhëniet midis vendeve.
- Vendet shpesh tërheqin vëmendjen ndaj shtimit të numrit të STR-ve gjatë viteve të fundit, si shenjë e përmirësimit të përpjekjeve APP. Sinjalizimet për transaksione të dyshimta janë shtuar në të gjitha vendet – megjithëse ky ritëm është shumë më i lartë në Shqipëri dhe Kosovë. Sidoqoftë, regjistrimi i raporteve të STR është vetëm një nga treguesit e respektimit të normave. Dënimet për përfshirje në pastrim parash mbeten në nivele të ulëta nëpër të gjithë rajonin.
- Organizmat anti-korrupsion janë të fragmentarizuar, dhe shpesh nuk është e qartë kush komandon. Po kështu, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre kufizohet në parandalim, ndërgjegjësim, dhe rritje kapacitetesh, në vend që t'u lejohet mbikqyrja dhe hetimi i pavarur.



© Pat Whelen/Unsplash

NDIKIMI MBI POLITIKAT

PFP paraqesin një pengesë serioze për zhvillimin e vendeve të Ballkanit perëndimor. Një atmosferë lëshimi dhe pandëshkueshmërie gjëryen nga brenda zhvillimet pozitive (në dukje) në të tre vendet e Ballkanit perëndimor, drejt anëtarësimit në BE, zhvillimit ekonomik, dhe qeverisjes demokratike. Gjatë 20 viteve të fundit, kapacitetet për të devijuar, mbrojtur, përvetësuar dhe shtuar pasuri shtetërore dhe të ardhura kriminale për përfitim personal, e ka shtrembëruar botëkuptimin e qytetarëve mbi shtetin dhe pushtetin e ligjit.

Shkalla e gjerë e axhendës mbi prurjet e paligjshme, që përqendrohet njëkohësisht mbi komponentët dhe kanalet e PFP, kontekstin e tyre politiko-ekonomik, ndikimin e këtyre prurjeve në shoqëri, si dhe masat teknike dhe administrative për t'i luftuar ato, mund të krijojë një bazë të shëndoshë për të arritur rezultate pozitive. Ballkani perëndimor mund të përfitojë nga dedikimi, mbështetja, burimet, dhe investimet e mundshme nga komuniteti ndërkombëtar. Ndërsa shtetet e rajonit afrohen më pranë anëtarësimit në BE, duke qenë se kriteret kryesore teknike janë përmbushur, tani objektivi i punës duhet të jetë prishja e sistemit ekzistues të interesave vetjake dhe pasurimit të elitave në ekonomi politike të korrupsionit.

Programet anti-korrupsion, kundër krimit të organizuar, për parandalimin e pastrimit të parave, dhe përpjekjet për të luftuar varfërinë, pabarazinë, informalitetin, dhe injorimin ekonomik, duhet të bashkojnë forcat, dhe të koordinohen politikat e programet për të arritur efektin maksimal. Forumi i diskutimit mbi prurjet e paligjshme mund të jetë një nga mekanizmat për të arritur këtë koherencë dhe koordinim, pasi i jep prioritet luftës kundër atyre formave të PFP që shkaktojnë dëmin më të madh ndaj zhvillimit.

Analizimi i PFP për periudhën pas COVID-19

Pjesa më e madhe e punës kërkimore për këtë raport u zhvillua përpara shpërthimit të pandemisë COVID-19, dhe aplikimit të kufizimeve mbi lëvizjen, si brenda vendit ashtu dhe përmes kufijve. Në kohën kur po shkruhej ky raport, në qershor 2020, kufijtë e të gjitha vendeve të Ballkanit perëndimor ishin mbyllur që nga muaji mars, dhe ishin vendosur kufizime të rrepta mbi lëvizjen e njerëzve.²⁵⁰ Të gjitha forcat e mbrojtjes së rendit dhe sigurisë u angazhuan në disiplinimin e sjelljes së popullatës për të kufizuar përhapjen e infeksionit, sigurimin e transportimit të mjeteve dhe mallrave mjekësore, si dhe për marrjen e masave për parandalimin e trazirave sociale. Lufta kundër krimit nuk ishte më prioritet.²⁵¹

Nga monitorimi i ekonomisë së paligjshme nga ana e GI-TOC, nëpërmjet platformës së shoqërisë civile SEE-Obs, kuptohet qartë se masat e marra për të mbajtur nën kontroll pandeminë kanë ndikuar edhe mbi aktivitetet e grupeve kriminale, dhe kanë ndryshuar edhe dinamikat lokale.²⁵² Trafikimi i qenieve njerëzore u reduktua ndjeshëm pas vendosjes së kufizimeve mbi lëvizjen dhe mbylljen e kufijve. Nuk janë regjistruar hyrje të reja të emigrantëve apo refugjatëve në të tre vendet e marra në studim, që nga bllokimi në mes të muajit mars.²⁵³ Drogat vazhdojnë të trafikohen: prodhimi i kanabisit është rritur pak, por furnizimi me heroinë duket se është reduktuar ndjeshëm, si pasojë e bllokimeve në nivelet e larta të zinxhirit të trafikimit. Shpërndarja në tregjet e brendshme vazhdon, ndonëse ka probleme e tensione që pasqyrohen edhe mbi çmimin e drogës në rrugë.²⁵⁴ Analistët mendojnë se grupet kriminale mund t'i zhvendosin bazat e tyre të përpunimit dhe logjistikës në qyteza të vogla dhe zona rurale për të evituar diktimin nga forcat e zbatimit të ligjit. Në Tiranë, numri i personave të arrestuar për drogë renditej në vendin e dytë, pas ndalimeve për shkeljen e shtetrrrethimit.²⁵⁵

Përsa i përket PFP, është e logjikshme të mendohet se kontrolli mbi lëvizjen në kufij duhet të ketë patur ndikimim e vet mbi lëvizjen e parave ndërmjet vendeve, që zakonisht kryhet nëpërmjet kalimit të personave në kufij. Duke patur parasysh ndikimin e madh të këtyre prurjeve të paligjshme në ekonominë e remitancave në këto vende – veçanërisht në Kosovë, ku remitancat përbëjnë një pjesë shumë të madhe të PBB – ky bllokim mund të përkeqësojë ndikimin negativ të pandemisë mbi popullatën. Ndërkohë që shumë persona që përfitojnë nga sektori informal dhe ekonomia e transferimit të parave kesh do të vuajnë si pasojë e ndryshimeve, grupet kriminale që përdorin korrierë parash, dhe transferime parash për të kryer pastrimin e tyre ka të ngjarë që të kalojnë shpejt në forma të tjera të transferimit të vlerave monetare. Në një situatë ku furnizime urgjente me mallra mjekësore, ushqime, dhe ngarkesa humanitare dërgohen me shpejtësi nëpër të gjithë kontinentin, dhe doganierëve u kërkohet që t'i lënë të kalojnë shpejt në kufi,²⁵⁶ mundësitë për trafik dhe tregti të paligjshme, si dhe pastrim parash, nëpërmjet tregtisë janë shtuar në mënyrë dramatike.

Ekspertë shprehin gjithashtu shqetësimin se elementë që zotërojnë sasi të mëdha parash të pista do të gëzojnë pozita më të forta kur të fillojë të ndihet mungesa e likuiditetit në sektorët privatë dhe publikë. Sipërmarrës në Shqipëri kanë paralajmëruar se shumë kompani mund të jenë pranë falimentimit si pasojë e krizës COVID-19, dhe kjo mund të përdoret si stimul për pastrim parash.²⁵⁷

Mashtrime dhe aktivitete kriminale u shfaqën thuajse menjëherë në rajon, duke rritur së tepërmi çmimet e pajisjeve të mbrojtjes personale (PMP), dhe mallrave mjekësore me rëndësi kritike. Ka patur raportime mbi mjekë të rremë që merrnin në telefon spitale dhe u ofronin mallra mjekësore me çmime shumë të shtrenjta; po kështu, u krijuan shumë faqe



interneti me oferta të ngjashme.²⁵⁸ Pjesa më e madhe e tortës do të vijë nga prokurimet shtetërore për pajisje mbrojtëse, si dhe mundësi të tjera për korrupsion me fondet publike në sektorin e shëndetësisë. Mashttrimet me fonde publike dhe korrupsioni do të ndikojnë negativisht kundrejt çdo pakete ekonomike stimuluese për parandalimin e pasojave ekonomike afatgjata në rajon.

Po kështu, ka edhe shqetësime serioze në lidhje me të ardhmen e këtyre vendeve nëse pandemia vazhdon gjatë në vendet e Ballkanit perëndimor. Në një ambient shoqëror me institucione të dobëta, grupet kriminale mund të pozicionohen si partnerë të autoriteteve zyrtare, duke ofruar që të kryejnë shërbime, të shpërndajnë ndihma, apo të sigurojnë mbështetje për komunitete ku shteti është i paaftë të ndihmojë.²⁵⁹ Dështimi i sistemit shtetëror të shërbimeve mund të shkatërrojë përfundimisht edhe atë besim të brishtë që po krijohet tek qytetarët e rajonit ndaj integritetit dhe kapaciteteve të institucioneve shtetërore. Shkelje më të rënda të besimit publik dhe të drejtave të njeriut, si sigurimi i rendit publik dhe kontrolli i kufirit me masa tepër të ashpra, mund të ringjallë trashëgiminë e pashuar të konflikteve e trazirave të kohëve të fundit, dhe të sabotojë procesin e demokratizimit. Një tjetër fakt shqetësues, që nga fillimi i pandemisë, janë sulmet ndaj medias në Shqipëri, që kufizojnë aftësitë investigative dhe mbikqyrëse të pushtetit të katërt.²⁶⁰

Pandemia është padyshim një problem madhor, dhe situata pas përfundimit të krizës COVID-19 duhet të monitorohet me kujdes. Duhet të analizohen ndryshimet në ekonominë politike në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, pasi ka shumë të ngjarë që mjedisi shoqëror do të ketë ndryshuar shumë. Duhet të ndryshojnë edhe kundërpërgjigjet e autoriteteve ndaj PFP, dhe mund të krijohen hapësira të reja për ndryshimin e paradigmave dhe stimulje që janë përdorur për shumë vite në këtë drejtim.

Protestues në Prishtinë respektojnë normat e distancimit social, në pritje të shpalljes të një vendimi gjyqësor, maj 2020. © Armend Nimani/AFP nga Getty Images



© Andre Francois McKenzie/
Unsplash

PËRFUNDIME

Ky raport analizon dinamikat rajonale të PFP në vendet e Ballkanit perëndimor, duke u fokusuar mbi Shqipërinë, Kosovën, dhe Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë që analizat kombëtare mbi situatën dhe nivelin e rrezikut, raportet e vlerësimit MONEYVAL, dhe raportet e zhvillimit nga BE bëjnë analiza të hollësishme nga një pikëpamje shtetërore, ky raport paraqet këndvështrimin e shoqërisë civile mbi çështje të ndryshme të shpalosura gjatë intervistave në terren, nga dhjetor 2019 deri në mars 2020. Raporti përmban shembuj dhe raste konkrete mbi mënyrat se si fitohen, transferohen, dhe pastrohen pasuritë e paligjshme në këto tre vende, dhe përmes kufijve.

Përhapja dhe niveli i rritjes së PFP në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ndihmohet edhe nga integrimi dhe ndërlidhja midis vendeve të rajonit. Pozita gjeografike i bën këto vende pjesë të korridoreve të trafikimit, ku mallra, njerëz, dhe prurje financiare mund të kalojnë lehtësisht nëpër kufij. Kriminelët dhe të korruptuarit i përdorin këto avantazhe që u krijohen për të shtrirë aktivitetet e tyre nëpër rajon, duke investuar dhe blerë prona aty ku u vjen më për shtat.

Trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe tregtia e paligjshme janë aktivitetet kryesore të krijimit të pasurive të paligjshme nga krimi i organizuar. Në mënyrë të veçantë, përfshirja e grupeve shqiptare të krimit të organizuar në zinxhirin ndërkombëtar të trafikimit të kokainës mendohet se gjeneron sasi të mëdha të ardhurash kriminale në rajon. Sidoqoftë, edhe forma të tjera më pak fitimprurëse të krimit të organizuar kanë një ndikim të rëndësishëm mbi ekonominë dhe shoqërinë e një vendi, dhe nuk duhet të neglizhohen.

Kjo situatë ndikohet edhe nga politikat rajonale dhe ndërshtetërore, pasi kriminelë nga vende fqinje lëvizin mallra të paligjshme nëpër rajon, duke supozuar se kontrolli i dobët nga autoritetet do t'i lejojë që të investojnë dhe pastrojnë fitimet e tyre pa u ndëshkuar. Pavarësisht nga miratimi i masave anti-korrupsion dhe pro-transparencë në të tre vendet, korrupsioni vazhdon të jetë një nga burimet kryesore të prurjeve të paligjshme, dhe një pengesë e madhe për parandalimin e tyre. Perceptimi i përgjithshëm i këtij raporti, dhe i vëzhguesve ndërkombëtarë, është se autoritetet qeveritare po punojnë shumë që të dobësojnë masat që duhet të sigurojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe po mundohen të dobësojnë sistemin e kontrolleve dhe balancave, në vend që të forcojnë integritetin e sistemit dhe pushtetin e ligjit.

Manipulimi me faturat, veçanërisht nënfaturimi i mallrave dhe shërbimeve, u identifikua si një nga metodat kryesore për transferimin e PFP. Shpesh kjo kryhet me kërkesën e kompanisë importuese, që i kërkon firmës eksportuese që të lëshojë faturë me vlerë më të ulët për mallrat, në mënyrë që të paguajë më pak për tarifa doganore importi. Për shembull, 'disniveli' midis të ardhurave nga tregtia dhe rezervave të këmbimit valutor, që vihet re momentalisht në Shqipëri, mendohet se vjen si rezultat i manipulimit me faturat tregtare.

Shumë nga burimet thonë se transportimi i parave është kanali më i rëndësishëm për transferimin e parave të pista përmes kufijve, në ndarje të fshehta në makina private, apo e fshehur mes mallrave të ligjshme që transportohen me kamionë. Sidoqoftë, nuk dihet akoma volumni i parave që hyjnë apo dalin nga secili vend. Me përjashtim të Shqipërisë, nuk ka të dhëna mbi pagesat që jepen për të kryer kontrabandë parash. Futja e parave të pista në ekonominë e ligjshme të një vendi mundësohet nga përdorimi i gjerë i pagesave me para në dorë, dhe ekonomitë informale të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, dhe veçanërisht Kosovës. Ekonomitë me para në dorë krijojnë hapësira të gjera për infiltrimin e prurjeve të paligjshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë formale.

Paratë e paligjshme që nuk transferohen në parajsë financiare pastrohen brenda rajonit, nëpërmjet fushatave elektorale, si dhe sektorëve të ndërtimit dhe lojërave të fatit. Në Shqipëri, ofrohen mundësi të shumta në sektorin e pasurive të paluajtëshme dhe në turizëm; në Maqedoninë e Veriut këto mundësi ofrohen nga sektori i lojërave të fatit, pasi është i vetmi vend ku kumari vazhdon të jetë i ligjshëm, me mbikqyrje të kufizuar nga ana e autoriteteve dhe me mbështetje politike.

Një përfundim i rëndësishëm i këtij raporti është se, megjithë faktin që Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut kanë miratuar baza të shëndosha ligjore APP/BFT, dhe kanë firmosur konventa të shumta ndërkombëtare për luftën kundër prurjeve të paligjshme, shumë institucione nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për zbatimin në terren të këtyre ligjeve dhe rregullave. Analizat kombëtare mbi situatën dhe nivelin e rrezikut, si dhe raportet e vlerësimit nga MONEYVAL tregojnë se këto shtete i njohin mirë rreziqet që vijnë prej tyre, por boshllëqe në legjislacion, mospërputhje dhe fragmentarizim detyrash e përgjegjësish, paralelisht me kapacitete të dobëta dhe korrupsion, e sabotojnë zbatimin e ligjeve dhe masave.

Ndërkohë që numri i sinjalizimeve për transaksione të dyshimta është rritur vazhdimisht, numri i procedimeve të suksesshme, dhe dënimeve mbi prurjet e paligjshme (veçanërisht për pastrim parash) vazhdon të qëndrojë në nivele tepër të ulëta. Është e vërtetë që ka patur përmirësime në shumë drejtime, por pjesa më e madhe e dënimeve jepen për krime të tjera, dhe jo për pastrim parash. Numri i rasteve të procedimeve penale janë tregues i rëndësisë që i kushtohet një shkeljeje penale. Po kështu është e nevojshme që autoritetet të fokusohen mbi zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimit të pronave të fituara në mënyrë të paligjshme. Duhet bërë më shumë në nivel kombëtar për të përmirësuar bashkëpunimin midis institucioneve, veçanërisht për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të mbrojtjes së ligjit në vendet e Ballkanit perëndimor dhe më gjerë. Ajo që mungon, edhe njëherë, është bashkëpunimi në terren.

Shoqëria civile duhet të luajë një rol të rëndësishëm në kundërpërgjigjen ndaj PFP në vendet e Ballkanit perëndimor. Ajo duhet të ushtrojë presion për qeverisje dhe institucione të efektshme, si dhe për konsolidimin e kulturës së ligjshmërisë. Ato duhet të punojnë me qeveritë për t'i dhënë prioritet çështjeve që lidhen me prurjet më të dëmshme. Në të njëjtën kohë, komuniteti ndërkombëtar duhet që të ushtrojë presion mbi qeveritë e rajonit për të siguruar hapësira dhe liri për median, OJQ dhe qytetarët që të shprehin opinionet e tyre.

PFP në vendet e Ballkanit perëndimor është një fenomen që nuk është studiuar akoma sa duhet. Është e nevojshme që të zhvillohen më shumë studime dhe të mblidhen më shumë të dhëna për të njohur më mirë fenomenin në rang rajonal, duke përfshirë në studim edhe Bosnjë Hercegovinën, Malin e Zi, dhe Serbinë. Intensifikimi i bashkëbisedimit dhe debatit ndërmjet palëve të interesuara mund të përmirësojë njohuritë mbi elementet kryesore dhe prirjet që bëjnë të mundur hyrjen e PFP në vendet e Ballkanit perëndimor, duke krijuar kështu më shumë mundësi për të hartuar kundërpërgjigje më të forta ndaj këtij problemi.

Përfundime për secilin shtet

Ndonëse përfundimet e përgjithshme që u renditën më lart mund të aplikohen për të tre vendet e Ballkanit perëndimor, ka disa ndryshime që ia vlen të përmenden.

SHQIPËRIA

Trafikimi i drogës ka qenë aktiviteti më fitimprurës për grupe kriminale nga Shqipëria, gjatë 30 viteve të fundit. Kultivimi i kanabisit vazhdon të jetë një problem i madh në disa zona të vendit, megjithë përpjekjet e konsiderueshme të qeverisë për të reduktuar prodhimin që nga viti 2014. Kanabisi krijon fitime të paligjshme nëpër të gjithë zinxhirin, që nis nga fshatarët që kultivojnë bimën deri tek grupet e krimit të organizuar që e trafikojnë dhe e shesin në vendet e BE-së. Sidoqoftë, fitimet nga trafikimi i kokainës janë shumë më të mëdha, deri në 20,000 euro për kilogram.

Pas trafikimit të narkotikëve, korrupsioni dhe vjedhjet e fondeve publike janë burimi i dytë më i madh në Shqipëri. Investigime të kohëve të fundit tregojnë se 300 milionë euro humbasin çdo vit nga abuzime me procedurat e prokurimeve publike, që do të thotë gati 45 për qind të vlerës totale të kontratave publike që u akorduan gjatë vitit 2019.

Krimi ekonomik nga kompani të mëdha dhe evazoni fiskal janë gjithashtu problematike në Shqipëri. Ekspertët mendojnë se gati 80 për qind e disnivelit midis të ardhurave nga tregtia dhe rezervave të këmbimit valutor mund t'i atribuohen manipulimit dhe mbifaturimit të mallrave dhe shërbimeve që hyjnë në vend.

Një pjesë e madhe e këtyre fitimeve të paligjshme transferohen në para kesh brenda dhe jashtë vendit. Transportimi i parave të thata mbetet mënyra më e thjeshtë për lëvizjen e vlerave monetare, veçanërisht në një vend që ka qenë historikisht skeptik kundrejt sistemit bankar. Grupe të krimit të organizuar përdorin rrjetet e tyre të shpërndarjes për këtë qëllim, dhe korrierët e parave udhëtojnë rregullisht ndërmjet vendeve të BE-së, Britanisë së Madhe, dhe Shqipërisë, duke mbajtur me vete jo më shumë se 10,000 euro për çdo udhëtim, për të mos ngjallur dyshime. Raportohet se paratë kesh shpesh

transportohen përmes kufijve në kamionët e kompanive të import/eksportit, dhe në makina private me ndarje të fshehta. Shoferët e kamionëve mbajnë një komision prej tetë deri në 15 për qind të shumës.

Raporti i fundit nga MONEYVAL identifikoi zyrat e shkëmbimit valutor si pika të dobëta për transferta të paligjshme parash.²⁶¹ Në përpjekje për të zgjidhur këtë problem Banka e Shqipërisë ka forcuar kontrollin mbi zyrat e shkëmbimit valutor që nga viti 2018.²⁶² Ekspertët mendojnë se një vlerësim i ndjeshëm i lekut në raport me euron që nga viti 2016, që nuk mund të shpjegohet nga volumi i shkëmbimeve në ekonominë e rregullt, është rezultat i kanalizimit të parave të paligjshme në vend.

Edhe kompanitë e lojërave të fatit në Shqipëri ishin shumë të ekspozuara ndaj përfshirjes në pastrimin e parave. Për t'iu kundërpërgjigjur këtij problemi, qeveria ndaloi të gjitha format e kumarit në vend, në vitin 2019. Sidoqoftë, paratë vazhdojnë të pastrohen nëpërmjet pasurive të paluajtëshme, një sektor që vazhdon të përdorë gjerësisht pagesat me para në dorë, shkëmbimet në mallra dhe shërbime. Po kështu blerjet paraprake të ambienteve përdoren si burime financimi. Në fakt, përdorimi i gjerë i parave të paligjshme në këtë sektor ka ndikuar në rritjen e çmimit të pasurive të paluajtëshme, veçanërisht në Tiranë, ku çmimi mesatar i apartamenteve të banimit arriti në pak më shumë se 1,000 euro/m² në fund të vitit 2019. Po kështu, ekspertët vërejnë se nga 141 kompani që kanë marrë leje për të ndërtuar godina me gjashtë kate (e më lart) për periudhën 2017–2019, afro 59 për qind e tyre nuk dukej se i kishin mundësitë financiare për t'i përfunduar.

Edhe shtimi i sulmeve mbi median në Shqipëri është një shqetësim serioz, veçanërisht që nga shpërthimi i pandemisë, pasi mund të kufizojë aftësitë investigative dhe mbikqyrëse të pushtetit të katërt.

MAQEDONIA E VERIUT

PFP në Maqedoninë e Veriut ndikohen shumë nga pozicioni i vendit në korridorin tranzit të njerëzve dhe mallrave nga Azia për në Evropën perëndimore. Ndërkohë që skandale politike, dhe konflikti i emrit të vendit me Greqinë, e kanë penguar përparimin e Maqedonisë së Veriut drejt

anëtarësimit në BE, përpjekjet e vendit u shpërblyen kohët e fundit me hapjen e negociatave në prill 2020.

Komponenti kryesor i prurjeve të paligjshme të krimit në Maqedoninë e Veriut është korrupsioni dhe abuzimi me pushtetin, ndërsa statistikave qeveritare tregojnë se

numri i këtyre krimeve po rritet vazhdimisht vit pas viti. Megjithë përpjekjet e shumta anti-korrupsion, ky problem mbetet shumë i përhapur në formën e ryshfeteve për favore e shërbime, që duhet të jetë forma më e lehtë për t'u eliminuar. Kjo tregon se kemi të bëjmë me një traditë tolerance ndaj korrupsionit dhe pushtetit të dobët të ligjit.

Paratë zakonisht dalin nga Maqedonia e Veriut drejt llogarive në parajsa financiare dhe juridiskione sekrete me taksa shumë të ulëta, ku nuk janë të detyruar që të raportojnë mbi identitetin e pronarit të llogarisë bankare. Bogodorica, Tabanovce dhe aeroporti ndërkombëtar i Shkupit janë pikat e kalimit kufitar ku janë kapur sasitë më të mëdha të valutës së huaj që po hynte në vend.

Transferrat e shpejta të parave janë një tjetër kanal për kalimin e fondeve të paligjshme në Maqedoninë e Veriut. Banka Kombëtare lëshon licenca për këto shërbime, dhe së bashku me Njësinë e Inteligjencës Financiare, është përgjegjëse për monitorimin e huadhënësve dhe pikave

KOSOVA

Statusi ndërkombëtar i Kosovës është akoma i pazgjidhur. Kjo pengon anëtarësimin e saj në një sërë organizatash ndërkombëtare, dhe ka ndikim të madh mbi vendin – si dhe mbi sasinë e informacionit në dispozicion në lidhje me këtë çështje.

Të ardhurat nga korrupsioni dhe abuzimi me pushtetin besohet se janë komponentët kryesorë të PFP në Kosovë. Mendohet se ndërtimi i rrugëve është një nga sektorët më të ekspozuar ndaj korrupsionit me kontrata publike. Për shembull, janë vërejtur disa raste të shkeljeve të tenderit për ndërtimin e autostradës së Gjilanit, dhe projekteve të tjera. Grupet e krimit të organizuar janë përfshirë në një sërë aktiviteteve që krijojnë fitime të paligjshme, veçanërisht në trafikimin e drogës dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Emigrantë hyjnë në vend nga dy drejtime: nga jugu drejt Serbisë dhe BE-së, dhe nga veriu drejt Shqipërisë dhe Italisë.

Duke përfituar nga pozita e saj gjeografike, kufijtë porozë, dhe zonën e kontestuar në veri të vendit, Kosova është bërë qendër e kontrabandës së mallrave të falsifikuara dhe tregtisë së paligjshme, veçanërisht cigareve. Mallrat shpesh dalin nga vendi nëpërmjet pikave 'alternative' të kalimit të kufirit, zakonisht nëpër male apo zona të tjera me terren të vështirë. Grupet e krimit të organizuar nga Kosova bashkëpunojnë me rrjete më të mëdha kriminale në Ballkanin perëndimor për prodhimin dhe kontrabandën e cigareve, me lidhje që shkojnë deri në Lindjen e Mesme.

nënkontraktore, por masat për respektimin e kushteve dhe kritereve nuk zbatohen si duhet, dhe lënë vend për manipulim.

Burimet thonë se pastrimi i parave në shkëmbime tregtare është veçanërisht i përhapur. Kompani vendase nënfaturojnë ngarkesat me mallra eksporti, ndërsa diferenca e parave kalon kontrabandë përmes kufirit. Llogaritë e personave jo rezidentë, që hapen posaçërisht për pagimin e faturave, funksionojnë në mënyrë të ngjashme.

Metoda të tjera të pastrimit të parave përfshijnë pagesat për sigurimin e jetës, ku këstet paguhen me para në dorë. Sektori i lojërave të fatit paraqet një shqetësim serioz, veçanërisht pas ndalimit të kumarit në Shqipëri e Kosovë, dhe transferimit të aktivitetit të kompanive në Maqedoninë e Veriut. Ndonëse qeveria i kupton rreziqet, vendi po mundohet të zhvillojë sektorin e turizmit për të pritur më shumë vizitorë nga Shqipëria dhe Kosova.

Kanalet e pastrimit të parave në Kosovë vazhdojnë të bazohen tek paratë kesh. Mendohet se bizneset i fryjnë shifrat e shitjeve dhe fitimeve ditore për të kamufluar fondet e paligjshme, përdorin kompani të rreme për të evituar pagesën e taksave, dhe manipulojnë me faturat e mallrave dhe shërbimeve në shkëmbimet tregtare ndërkombëtare.

Lojërat e fatit janë një tjetër sektor me rrezikshmëri të lartë për pastrimin e parave. Ndonëse kumari u ndalua me ligj në vitin 2019, një numër i madh ish-kazinosh dhe pikash bastesh janë kthyer në kafene, restorante dhe hotele, ku lojërat e fatit dhe pastrimi i parave vazhdon. Disa aktivitete të tjera kumari janë zhvendosur në zona ushtarake nën kontrollin e KFOR, ku policia e Kosovës nuk hyn dot pa marrë leje.

Ashtu si në Shqipëri, paratë pastrohen nëpërmjet ndërtimit dhe sektorit të pasurive të paluajtëshme. Besohet se një sërë kompanish ndërtimi janë në pronësi të të afërmeve apo bashkëpunëtorëve të politikanëve me pozitë të lartë. Kompanitë i paguajnë punëtorët e tyre me para në dorë, dhe punonjësit depozitojnë sasi të mëdha parash në llogaritë e tyre bankare. Sidoqoftë, paratë e pista që gjenerohen në Kosovë nuk pastrohen vetëm në sektorin vendas të ndërtimit: grupe kriminale kosovare duket se po investojnë në pasuri të paluajtëshme në bregdetin shqiptar.



REKOMANDIME

Ashtu si u përmend disa herë në këtë raport, aplikimi i një axhende PFP mbi programe ekzistuese (por disi të fjetura) anti-pastrim parash dhe anti-korrupsion mund të gjallërojë këto përpjekje, dhe të përmirësojë integrimin dhe koordinimin e tyre. Pandemia e koronavirusit e rrit akoma më tepër këtë potencial.

Duke ndjekur udhëzimet e OECD mbi praktikat më të mira të punës për t'iu kundërvënë PFP, janë bërë disa rekomandime në katër fusha kryesore.²⁶³

1. IDENTIFIKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI MBI LLOJET, SHKALLËN DHE RREZIQET E PFP.

Ashtu si u përmend dhe më lart, 'Prurje Financiare të Paligjshme' është një koncept relativisht i ri zhvillimor, që nuk përdoret gjerësisht në vendet e Ballkanit perëndimor. Risia e këtij koncepti mund të ndihmojë në hapjen e kanaleve të reja të dialogut me zyrtarë shtetërorë, sektorin privat, shoqërinë civile, dhe publikun e gjerë. Në këtë mënyrë ky bashkëbisedim i gjerë mund të orientohet drejt njohjes dhe zbutjes së dëmeve që i shkaktohen perspektivave të zhvillimit.²⁶⁴ Këto konsultime mund të ngjallin interesin e publikut vendas për një debat që zakonisht shihet si i frymëzuar nga jashtë. Roli i shoqërisë civile ka rëndësi themelore në këtë drejtim: ajo duhet të angazhohet në mënyrë aktive në vlerësimin e situatës dhe rreziqeve, dhe të shpalosë këndvështrimin dhe eksperiencat e publikut në lidhje me prurjet e paligjshme, dhe rreziqet që ato paraqesin për demokracinë dhe paqen. Mendimet dhe opinionet e shoqërisë civile duhet të përfshihen në proceset e analizimit të pasojave, dhe identifikimit të ndërhyrjeve prioritare.

Sasia e vogël e të dhënave të mbledhura deri tani mbi PFP, e bën të vështirë kalimin e këtij problemi në qendër të vëmendjes të hartimit të politikave. Nuk vlerësohet akoma sa duhet niveli i rrezikut dhe dëmit të shkaktuar nga PFP, veçanërisht në shtete ku populli duket se

është dorëzuar ndaj korrupsionit të institucionalizuar, pandëshkueshmërisë, varfërisë, dhe informalitetit. Një pjesë e popullatës mund të varet apo përfitojë nga prurjet informale dhe të paligjshme, gjë që e bën akoma më të vështirë pranimin e problemit, zbulimin dhe luftën kundër PFP.

Ka shumë nevojë që të rritet cilësia dhe sasia e të dhënave në lidhje me shkallën dhe natyrën e PFP, dhe të bëhet e mundur që ky informacion të publikohet në mënyrë transparente dhe të jetë në dispozicion të publikut të gjerë. Për shembull, ia vlen të përmendet se për disa nga kërkesat për informacion, gjatë punës për hartimin e këtij raporti, nuk erdhi asnjë përgjigje gjatë nëntë muajve që zgjati puna kërkimore. Publikimi i rregullt i informacioneve mbi bizneset, dhe publikimi i të dhënave nga regjistrat e kompanive të huaja e vendase që punojnë në rajon është me rëndësi thelbësore.

Nga këto konsultime, mund të hartohet një strategji kombëtare dhe të arrihet në një analizim të situatës dhe nivelit të rrezikut. Këto dokumente duhet që të identifikojnë qartë burimet kryesore, destinacionet, kanalet e prurjeve të paligjshme që hyjnë apo dalin nga vendi, si dhe ndikimin e tyre mbi vendin dhe rajonin.

Situata pas COVID-19 mund të krijojë një terren pjellor për disa aspekte të PFP: ndikimi negativ i krimit dhe korrupsionit mund të ndihet më shumë, pasi grupet kriminale mund të shfrytëzojnë nevojat ekonomike dhe dobësitë njerëzore; ndërsa edhe marrja e ryshfeteve nga politikanë të korruptuar (veçanërisht nga fonde për sektorin e shëndetësisë) do të jetë akoma më e dukshme. Angazhimi i shoqërisë civile do të ketë rëndësi themelore në këtë situatë.

2. KONSIDERIMI I FAKTORËVE KONTEKSTUALË QË LEJOJNË LULËZIMIN E PFP.

Kundërpërgjigjet ndaj PFP duhet të marrin në konsideratë faktorët jo-politikë që mund të përforcojnë apo dobësojnë efektshmërinë e tyre. Këtu përfshihet gjendja e ekonomisë, mjetet dhe burimet në dispozicion për të luftuar PFP, si dhe niveli i integritit rajonal dhe ndërkombëtar që mund të dëmtojë përpjekjet e një vendi.

Shkalla e informalitetit është padyshim një nga faktorët nxitës të PFP: informaliteti redukton ndjeshëm mbikqyrjen e transaksioneve financiare, dhe fsheh nivelin real të devijimit të burimeve financiare. Po kështu, ai lejon që të ardhurat e krimit të fshihen me lehtësi, dhe nuk lejon që të zhvillohen hetime financiare të suksesshme, duke kompromentuar kapacitetin e sistemit të drejtësisë penale për të dënuar kriminelët. Gjithashtu, informaliteti e ekspozon popullatën ndaj rreziqeve shëndetësore, pasigurisë dhe shfrytëzimit, dhe i privon nga mbrojtja shoqërore, për aq kohë sa pagat paguhen me para në dorë. Po nuk pati përpjekje të konsiderueshme për të luftuar informalitetin, pjesa tjetër e axhendës PFP do të mbetet vetëm në letër.

Përgjigjja ndaj pandemisë mund të ofrojë mundësi për të adresuar problemin e informalitetit dhe gjithëpërfshirjes financiare. Stimuj ekonomikë në shkallë të gjerë, dhe programe të tjera të mbështetjes sociale mund të krijojnë mundësi për të regjistruar dhe kaluar punonjës nga sektori informal tek ekonomia e rregullt. Kjo do të përmirësojë kapacitetet për mbikqyrje dhe kontroll mbi ekonominë, dhe do të reduktojë hapësirat për PFP.

Ekonomia e periudhës pas COVID-19 mund të shfrytëzojë edhe gjendjen emocionale të publikut dhe vullnetin politik për t'u marrë me faktorët ndihmës të PFP: pabarazinë kronike, dhe pasurimin në kurriz të tjerëve. Për shembull, qeveria e Polonisë, dhe vende të tjera, kanë ndërmarrë një iniciativë për të mos i dhënë stimuj e ndihmë financiare kompanive që

janë regjistruar në parajsa finaciare dhe juridiksione sekrete.²⁶⁵ Rrjeti i Drejtësisë Tatimore (RDT – Tax Justice Network) ka propozuar një test me pesë hapa ‘falimentim apo shpëtim’ (bail or bailout) për të orientuar qeverinë në marrjen e vendimeve për kriteret e pranimit në programet e saj të asistencës, për të përmirësuar transparencën tatimore për fondet e ndihmës financiare, dhe për të parandaluar rrjedhën e parave të taksapaguesve drejt parajsave financiare. Qeverive u kërkohet që të marrin në konsideratë faktin nëse kompania që kërkon ndihmë financiare ka regjistruar filiale të saj në një nga vendet e renditura në krye të dy listave: Treguesi i Sekretit Financiar (Financial Secrecy Index), dhe Treguesi i Parajsave Financiare për Korporata (Corporate Tax Haven Index); nëse kompania është përfshirë në ndonjë nga skandalet e daljes së informacioneve financiare, si Dokumentet e Panamasë; nëse kompania publikon në mënyrë transparente bilanci financiar, jo vetëm të subjekteve kombëtare, por për të gjitha njësitë e grupit; nëse ka informacion të qartë mbi pronësinë dhe përfituesit kryesorë; dhe në fund, nëse kompania është e gatshme që të angazhohet për të mbrojtur punëtorët e saj, dhe të mos ndajë fitime për aksionerët, deri sa të kthehet mbrapsht e gjithë sasia e ndihmës financiare.²⁶⁶ Vendet e Ballkanit perëndimor mund t’i aplikojnë këto rregulla që ndihmojnë kompanitë që paguajnë rregullisht taksat, për të promovuar një reformë të përgjithshme të transparencës së kompanive, dhe të reduktojnë rrezikun e kalimit të ndihmës financiare me fonde publike në xhepin e PFP.

Edhe RDT ka rekomandimet e saj për reduktimin e problemeve të ngjashme në proceset e prokurimeve publike, si bllokimi automatik i të gjitha kompanive që shmangin pagesën e taksave.²⁶⁷ Duke patur parasysh shkallën e prokurimeve publike, që pritet të dalin si pasojë e ndërhyrjes ekonomike ndaj krizës së pandemisë, mund të jetë e nevojshme që të përmirësohen legjislacionet kombëtare dhe të BE-së, për të përjashtuar kompani të tilla nga fitimi i kontratave për projekte të infrastrukturës publike, dhe nga bashkëpunimi ndërsektorial publik-privat.

3. DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË NDËRVEPRIMET MIDIS FUSHAVE EKONOMIKE, SOCIALE, DHE AMBIENTALE NË ADRESIMIN E PFP (KOHERENCË NË RRAFSHIN HORIZONTAL).

Në të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor, ka një mungesë të qartë të koherencës në luftën kundër PFP. Iniciativat e ndryshme që duhet të përbëjnë kundërpërgjigjen ndaj problemit (anti-pastrim parash, hetime financiare, bashkëpunim ndërkombëtar, anti-korrupsion) janë zbatuar në copëza të shkëputura nga njëra-tjetra, ku ministri dhe drejtori të ndryshme merren me aspekte të ndryshme. Kjo ka sjellë boshllëqe të mëdha ndërmjet bazës ligjore, zbatimit, sistemit juridik, strategjisë fiskale dhe tatimore. Me pak fjalë, nuk është e qartë kush komandon, dhe institucionet nuk punojnë në mënyrë koherente së bashku. Kjo ka kontribuar në krijimin e idesë se mungon vullneti politik, dhe se vazhdon pandëshkueshmëria për prurjet e paligjshme dhe krimin ekonomik.

Udhëheqje nga nivele të larta – do të ishte ideale një ndërhyrje jopartiake – ka rëndësi themelore për lidhjen së bashku të kësaj tabloje të shpërndarë. Ata që emërohen për të udhëhequr procesin duhet të jenë në gjendje që të punojnë në mënyrë të pavarur, të kenë burime të mjaftueshme, si dhe mbështetje politike të brendshme e të jashtme.

Duhet të përqendrohet vëmendja mbi elementët raportues, në veçanti profesionistët e sektorëve jo-financiarë si juristë, noterë, agjenci të pasurive të paluajtshme, dhe profesionistë në sektorë të tjerë që rrezikohen nga përfshirja në aktivitete të pastrimit të parave. Rritja e ndërgjegjësimit, krijimi i kapaciteteve, dhe monitorimi për respektimin

e rregullave do të jenë pika kyçe në luftën kundër PFP. Këtu përshihet edhe shoqëria civile, gazetaria investigative, si dhe organizma të tjerë që kanë aftësinë për të ushtruar monitorim publik.

Edhe aspekte të tjera të qeverisjes së dobët sabotojnë luftën kundër PFP. Denoncimi i korrupsionit dhe aktiviteteve të paligjshme kërkon një media dhe shoqëri civile aktive. Vendet e Ballkanit perëndimor njihen për mungesën e pavarësisë së medias, dhe gjatë viteve të fundit janë shtuar përpjekjet për kërcënimin e gazetarëve dhe aktivistëve që punojnë në fusha me ndjeshmëri të lartë. Promovimi dhe mbrojtja e veprimit qytetar dhe raportimit të medias së pavarur duhet të jetë pjesë e strategjive qeveritare.

4. FORCIMI I KOHERENCËS NDËRMJET KORNIZAVE NORMATIVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE (KOHERENCË NË RRAFSHIN VERTIKAL).

Si pasojë e natyrës të PFP, secili vend do ta kishte shumë të vështirë që të luftonte i vetëm kundër prurjeve të paligjshme. Kërkohej përpjekje globale për t'u përballur me këtë problem ndërkombëtar. Është e nevojshme që të arrihet një harmonizim rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe aksion i koordinuar dhe bashkëpunues, veçanërisht në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së, dhe Procesit të Berlinit. Deri më tani, pjesa më e madhe e përpjekjeve në luftën kundër PFP ka shkuar drejt ushtrimit të presionit mbi vendet e Ballkanit perëndimor, që të punonin për të arritur standardet ndërkombëtare të respektimit të kriterëve, ndihmës së ndërsjellë, bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe konfiskimit të pasurive. Sidoqoftë, është e nevojshme që të bëhet shumë më tepër në lidhje me tre shtyllat e përgjigjes ndaj PFP, që u përmendën më lart, përpara se të ndihet ndikimi i forcimit të koherencës në rrafshin vertikal.

Mospërputhje dhe ndryshime në politikat tatimore dhe kapacitetet zbatuese në rajonin e Ballkanit krijojnë hapësira ku mund të manovrojnë elementët kriminalë. Parajsat financiare dhe juridiksionet sekrete nëpër botë ofrojnë mundësi, dhe shtojnë stimujt për korrupsion dhe pastrim parash. Këto dobësi të sistemit duhet të zgjidhen.

Shkalla dhe rritja e PFP në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut përfitojnë shumë nga integrimi dhe ndërthurja e vendeve në rajon. Megjithatë, PFP në vendet e Ballkanit perëndimor janë akoma një fenomen që nuk është studiuar sa duhet. Është e nevojshme që të mblidhen më shumë të dhëna, për të arritur një njohje më të mirë të shtrirjes së fenomenit në rajon, si dhe të analizohen lidhjet e këtyre vendeve edhe me Bosnjë Hercegovinën, Malin e Zi, dhe Serbinë. Diskutime më serioze ndërmjet të gjitha palëve të interesuara mund të rritin nivelin e ndërgjegjësimit mbi faktorët nxitës dhe tendencat që mundësojnë PFP-të në vendet e Ballkanit perëndimor, pasi një njohje më e mirë e fenomenit do të krijojë mundësi për krijimin e një baze të shëndoshë për marrjen e masave më të forta.

SHËNIME

- 1 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Takim i nivelit të lartë për bashkëpunim ndërkombëtar për të luftuar Prurjet Financiare të Paligjshme dhe për të promovuar praktikën e mira të punës për kthimin e pronave, 16 maj 2019, <https://www.un.org/pga/73/event/international-cooperation-to-combat-illicit-financial-flows-and-strengthen-good-practices-on-asset-returns/> <https://www.un.org/pga/73/event/international-cooperation-to-combat-illicit-financial-flows-and-strengthen-good-practices-on-asset-returns/>.
- 2 UNCTAD-UNODC, UNCTAD-UNODC Takim i Task Forcës mbi metodologjitë statistikore për matjen e prurjeve financiare të paligjshme, 2019, https://unctad.org/meetings/en/SessionalDocuments/statemiff_Minutes_IFFTaskForceMeeting_16-17July2019.pdf.
- 3 Dev Kar dhe Joseph Spanjers, Prurje Financiare të Paligjshme nga vende në zhvillim: 2004–2013 (Illicit financial flows from developing countries), Integriteti Global Financiar (Global Financial Integrity), dhjetor 2015, <https://igfntegrity.org/report/illicit-financial-flows-from-developing-countries-2004-2013/>. Llogaritjet se vlera e PFP vetëm nga manipulimi me faturat midis Afrikës dhe pjesës tjetër të botës nga viti 2000 deri në 2015 ishte e barazvlefshme me gati 5 për qind të PBB të kontinentit. Marcena Hunter, Prurje Financiare të Paligjshme në Afrikë: Hartimi dhe prioritetet e kundërpërgjigjeve (African illicit financial flows: Designing and prioritising responses), ENACT, nëntor 2019, <https://enactafrica.org/research/research-papers/african-illicit-financial-flows-designing-and-prioritising-responses>.
- 4 Dev Kar and Joseph Spanjers, Prurje Financiare të Paligjshme nga vende në zhvillim: 2004–2013, Integriteti Global Financiar (Global Financial Integrity), dhjetor 2015, <https://igfntegrity.org/report/illicit-financial-flows-from-developing-countries-2004-2013/>.
- 5 Programi i Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, Qëllimi 16.4, <https://open.undp.org/sdg/targets/16/4>.
- 6 Komisioni Evropian, Një perspektivë e besueshme zgjerimi për një angazhim më të madh të BE me Ballkanin perëndimor (European Commission, A credible enlargement perspective for an enhanced EU engagement with the Western Balkans), 6 shkurt 2018, https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf.
- 7 Po aty, f 3.
- 8 Komisioni Evropian, Politika Evropiane e fqinjësisë së mirë dhe negociatat për zgjerim: Kushtet për anëtarësim, (European Commission, European neighbourhood policy and enlargement negotiations: Conditions for membership) https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en.
- 9 Marcena Hunter, Masa që nuk qëllon në shenjë: Identifikimi i të ardhurave kriminale në modelet e prurjeve të paligjshme financiare (Measures that miss the mark: Capturing the proceeds of crime in illicit financial flow models), Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, qershor 2018, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/06/TGIATOC-Illicit-Financial-Flows-report-1941-hi-res-2-1.pdf>.
- 10 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Task Forca Ndërsëktoriale për Financimin dhe Zhvillimin, Prurje Financiare të Paligjshme, <https://developmentfinance.un.org/illicit-financial-flows>.
- 11 UNCTAD-UNODC, UNCTAD-UNODC Takim i Task Forcës mbi metodologjitë statistikore për matjen e Prurjeve Financiare të Paligjshme, 2019, https://unctad.org/meetings/en/SessionalDocuments/statemiff_Minutes_IFFTaskForceMeeting_16-17July2019.pdf.
- 12 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Task Forca Ndërsëktoriale për Financimin dhe Zhvillimin, Prurje Financiare të Paligjshme, <https://developmentfinance.un.org/illicit-financial-flows>.
- 13 Fondacioni për Planifikim Ndërveprimi, Probleme serioze, pa datë (Interaction Design Foundation, Wicked problems), <https://www.interaction-design.org/literature/topics/wicked-problems>.
- 14 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Spostimi i Problemit: Kalimi i paligjshëm i emigrantëve nëpër Bosnjë Hercegovinë (A problem displaced: The smuggling of migrants through Bosnia and Herzegovina), mars 2020, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/03/Bosnia-Migration.16.03.web3_.pdf.
- 15 BIRN, Shqipëria Zbulon Sasi të Mëdha Kokainë të Fshehura në Banane (Albania Finds Huge Cocaine Haul Among Bananas), 28 shkurt 2018, <https://balkaninsight.com/2018/02/28/albania-seize-record-shipment-of-columbian-cocaine-02-28-2018/> dhe STA, Kokainë e Gjetur në Ngarkesë Sllovene me Banane, Kompania Mohon Përfshirje në Trafik (Cocaine Found in Slovenian Banana Shipment, Company Denies Involvement), 21 shkurt 2020, Total Slovenia News, <https://www.total-slovenia-news.com/news/5674-cocaine-found-in-slovenian-banana-shipment-company-denies-involvement>.
- 16 EUROPOL, Goditet një kartel ballkanik që trafikonte kokainë nëpër botë me avionë privatë, Deklaratë shtypi (Balkan cartel trafficking cocaine around the globe in private planes busted) 25 qershor 2019, <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/balkan-cartel-trafficking-cocaine-around-globe-in-private-planes-busted> dhe Borzou Daragahi, 'Kolumbia e Evropës':

- Si arriti Shqipëria e vogël të shndërrohet në një pikë kryesore të trafikimit të drogës në kontinent (Colombia of Europe: How tiny Albania became the continent's drug trafficking headquarters), 27 janar 2019, The Independent, <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-drug-cannabis-trafficking-hub-europe-adriatic-sea-a8747036.html>*
- 17 Walter Kemp, Kaleidoskopi i shtrembër: Krimi i organizuar në Ballkan (Crooked kaleidoscope: Organized crime in the Balkans), Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, qershor 2017, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf; Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Zona problematike të krimin të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor (Hotspots of organized crime in the Western Balkans), maj 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>; EUROPOL, Shkatërrohet një kartel ballkanik që trafikonte kokainë nëpër botë me avionë privatë (Balkan cartel trafficking cocaine around the globe in private planes busted), 25 korrik 2019, <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/balkan-cartel-trafficking-cocaine-around-globe-in-private-planes-busted>.
 - 18 Fatjona Mejдини dhe Kristina Amerhauser, Rritet si bar i keq? Analizim i traditës shqiptare të kultivimit të kanabisit (Growing like weeds? Rethinking Albania's culture of cannabis cultivation), Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Dhjetor 2019, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/12/AlbaniaCannabis.14.12.web_.pdf.
 - 19 Walter Kemp, Kaleidoskopi i shtrembër: Krimi i organizuar në Ballkan, Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, qershor 2017, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf; Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Zona problematike të krimin të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor, maj 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>.
 - 20 Raport ndihmës nga ekspertë PFP në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.
 - 21 Walter Kemp, Kaleidoskopi i shtrembër: Krimi i organizuar në Ballkan, Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, qershor 2017, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf
 - 22 Republika e Kosovës, Strategjia kombëtare për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë informale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimin financiar 2019–2023, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0211B611-A5EB-45F5-BE19-45A408D1DFA8.pdf>; Bedri Peci, Ekonomia informale: Djalli pëshpërit në veshin e Kosovës (Informal economy: The devil on Kosovo's shoulder), Prishtina Insight, 25 qershor 2019, <https://prishtinainsight.com/informal-economy-the-devil-on-Kosovos-shoulder/>.
 - 23 Rositsa Dzhekova, Josip Franic, Lyubo Mishkov dhe Colin C. Williams, Trajtimi i ekonomisë informale në IRJ të Maqedonisë: Një studim bazë (Tackling the undeclared economy in FYR Macedonia: A baseline assessment), Universiteti i Sheffield, 2014, https://www.sheffield.ac.uk/polopoly_fs/1.579204!/file/WP3TacklingtheUndeclaredEconomyinFYROM.pdf.
 - 24 Republika e Kosovës, Seria 3: *Statistikat ekonomike rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve* 2018, <https://ask.rks-gov.net/media/5174/anketa-strukturore-e-nd%C3%ABrmarrjeve-asn-2018.pdf>.
 - 25 Intervista me ekspertë tatimorë dhe bankarë dhe autoritete lokale, shtator 2018.
 - 26 Ekonomi tregtare, Niveli i papunësisë, <https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate>.
 - 27 Banka Botërore, Tregues të zhvillimit në botë: Shërbimet, vlera e shtuar (për qind e PBB), 2020, <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=2&series=NVS.SRV.TOTL.ZS>.
 - 28 Banka Botërore, Shkëmbini në shërbime (për qind e PBB) – Shqipëri, 2020, <https://data.worldbank.org/indicator/BG.GSR.NFSV.GD.ZS?locations=AL>.
 - 29 Banka Botërore, Bujqësi, pyje dhe peshkim, vlera e shtuar (për qind e PBB) – Shqipëri, 2020, <https://data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?locations=AL>.
 - 30 Banka Botërore, Industria (duke përfshirë ndërtimin), vlera e shtuar (për qind e PBB) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NV.IND.TOTL.ZS?locations=MK-XK-AL>.
 - 31 Republika e Kosovës, Agjencia për Statistika, të dhëna ekonomike: Prodhimi i përgjithshëm bruto 2008–18, f 6, <https://ask.rks-gov.net/media/5075/gross-domestic-product2008-2018.pdf>.
 - 32 Banka Botërore, Popullsia, total – Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/SP.POP.TOTL?locations=AL-MK-XK>.
 - 33 Banka Botërore, PBB (në US\$) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NY.PBB.MKTP.CD?locations=AL-MK-XK>.
 - 34 Banka Botërore, Rritja e PBB (për qind në vit) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NY.PBB.MKTP.KD.ZG?locations=AL-MK-XK>.
 - 35 Banka Botërore, PBB për kokë (current US\$) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NY.PBB.PCAP.CD?locations=AL-MK-XK>.
 - 36 Banka Botërore, Importet e mallrave dhe shërbimeve (për qind e PBB) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NE.IMP.GNFS.ZS?locations=AL-MK-XK>.
 - 37 Banka Botërore, Eksportet e mallrave dhe shërbimeve (për qind e PBB) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/NE.EXP.GNFS.ZS?locations=AL-MK-XK>.
 - 38 Tirana Times, Ekonomia informale vazhdon të jetë në nivele shqetësuese (Informal economy still at concerning levels), Tirana Times. 20 qershor 2019, <https://www.tiranatimes.com/?p=142264>; Bedri Peci, Ekonomia informale: Djalli pëshpërit në veshin e Kosovës, Prishtina Insight, 25 qershor 2019, <https://prishtinainsight.com/informal-economy-the-devil-on-kosovos-shoulder/>; Nordea, Konteksti ekonomik i Maqedonisë së Veriut (The economic context of Northern Macedonia), Nordea Trade, https://www.nordeatrade.com/fi/explore-new-market/north-macedonia/economical-context?vider_sticky=oui&.
 - 39 Ekonomia Tregtare, rrogat mesatare mujore në Shqipëri, 1993–2020, <https://tradingeconomics.com/albania/wages>; Rrogat mesatare mujore në Kosovë, periudha 2005–18, <https://tradingeconomics.com/kosovo/wages>; Rrogat mesatare mujore në Maqedoninë e Veriut 2003–2020, <https://tradingeconomics.com/macedonia/wages>. Të dhënat e analizuar për periudhën 2018–2020. Shuma e parave u konvertua në euro me kursin e këmbimit më 14 qershor 2020.
 - 40 Banka Botërore, Papunësia, total (për qind e forcës punëtore) (përllogaritje kombëtare) – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.NE.ZS?locations=AL-MK-XK>.
 - 41 Banka Botërore, migracioni – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, <https://data.worldbank.org/indicator/SM.POP.NETM?locations=AL-MK-XK>; Agjencia e Statistikave të Kosovës, Përllogaritje: Popullsia në Kosovë 2016, f 7, qershor 2017, <https://ask.rks-gov.net/media/3485/estimation-kosovo-publication-2016.pdf>.
 - 42 Transparency International, Treguesi i perceptimit të korrupsionit 2019, <https://www.transparency.org/cpi2019>
 - 43 Banka e Shqipërisë, Remitancat: Një ndihmë për zhvillimin, 16 qershor 2018, https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Remitancat_Revista_eng_12103.pdf.

- 44 Banka Botërore, Remitanca personale, pritëse (në US\$) – Maqedoni e Veriut, https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.CD.DT?locations=MK&name_desc=true.
- 45 Banka Botërore, Konteksti i vendit: Kosovë, <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>.
- 46 Republika e Kosovës, *Në emër të popullit*, nëntor 2019, https://apeli.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/AP_APS_11_2019_SQ.pdf.
- 47 Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor, Përdorimi i remitancave dhe gjithpërfshirjes financiare (International Fund for Agricultural Development, The use of remittances and financial inclusion), shtator 2015, <https://www.ifad.org/documents/38714170/40187309/gpfi.pdf/58ce7a06-7ec0-42e8-82dc-c069227edb79>.
- 48 Armend Bekaj, Evitimi i kalimit në autoritarizëm në demokracitë e reja nga Ballkani perëndimor, (Escaping the slide towards authoritarianism in new democracies alerts from the Western Balkans), International IDEA, 17 mars 2020, <https://www.idea.int/news-media/news/escaping-slide-towards-authoritarianism-new-democracies-alerts-western-balkans>.
- 49 Sadik Haxhiu dhe Arben Sahiti, Financimi i partive politike dhe fushata elektorale në vendet e Ballkanit perëndimor, (Financing of political parties and electoral campaigns in the Western Balkans), *Acta Universitatis Danubius Relationes Internationales*, 11,1, 2018, f 98–111, https://www.researchgate.net/publication/327477369_Financing_of_Political_Parties_and_Electoral_Campaigns_in_the_Western_Balkans.
- 50 Othon Anastasakis, Konsolidimi i zgjedhjeve në Ballkanin post-komunist: Përparime dhe pengesa (Election consolidation in the post-communist Balkans: Progress and obstacles), *Caucasus International* 3, 4, Dimër 2013–2014, f 15–25, https://www.sant.ox.ac.uk/sites/default/files/progress_obstacles.pdf.
- 51 International IDEA, Transparenca e Financimit Politik (Political finance transparency), mars 2019, <https://www.idea.int/sites/default/files/publications/political-finance-transparency.pdf>.
- 52 Othon Anastasakis, Konsolidimi i zgjedhjeve në Ballkanin post-komunist: Përparime dhe pengesa (Election consolidation in the post-communist Balkans: Progress and obstacles), *Caucasus International* 3, 4, Dimër 2013–2014, f 15–25, https://www.sant.ox.ac.uk/sites/default/files/progress_obstacles.pdf.
- 53 Po aty.
- 54 Intervistë me një ish-punonjës të EULEX, shkurt 2020.
- 55 Komisioni Evropian, Kosovë raport 2018, Dokument pune për personelin e komisionit, 17 prill 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>.
- 56 Blerta Begisholli, Protestuesit kosovarë që dolën kundër ligjit për financimin e partive ankohen për dhunë (Kosovo marchers against financing bill complain of violence), *Balkan Insight*, 17 qershor 2019, <https://balkaninsight.com/2019/06/17/kosovo-marchers-against-parties-financing-bill-complain-of-violence/>.
- 57 Redaksia Shqiptare, Kriza politike në Shqipëri thellohet ndërsa Bild publikon inçizime të tjera (Political crisis in Albania deepens as Bild leaks other taped conversations), Independent Balkan News Agency, 17 qershor 2019, <https://balkan.eu.com/political-crisis-in-albania-deepens-as-bild-leaks-other-taped-conversations/>.
- 58 Neritan Sejmini, Pesë gjërat që mësuam nga skandali i zgjedhjeve në Shqipëri (Five things we learned from the Albanian electiongate tapes), Exit News, 5 qershor 2019, <https://exit.al/en/2019/06/05/five-things-we-learned-from-the-albanian-electiongate-tapes/>.
- 59 Radio Free Europe/Radio Liberty, Opozita maqedonase pretendon se votimet janë manipuluar nga qeveria (Macedonia opposition claims government rigged elections), 11 mars 2015, <https://www.rferl.org/a/macedonia-elections-/26892892.html>; Sinisa Jakov Marusic, Në seancën gjyqësore të ish-kryeministrit maqedonas dëgjohen 'inçizimet e manipulimit me zgjedhjet' (Macedonia's ex-PM's trial hears 'election rigging tapes'), *Balkan Insight*, 17 Gusht 2018, <https://balkaninsight.com/2018/08/17/wiretaps-reveal-past-election-rigging-schemes-in-macedonia-08-17-2018/>.
- 60 Sandra Maksimović, Financimi i partive dhe zgjedhjet në vendet e Ballkanit perëndimor: Parregullsi që ndodhin cikël pas cikli, Ballkani Perëndimor Evropian (Financing parties and elections in the Western Balkans: Irregularities occur from cycle to cycle, European Western Balkans), 18 mars 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/03/18/financing-parties-and-elections-in-the-western-balkans/>.
- 61 Saška Cvetkovska, Blanka Zöldi dhe Anuška Delić, Furnizimi i makinës së propagandës së Orban (Oiling Orbán's propaganda machine), Projekti i Raportimit mbi Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (Organized Crime and Corruption Reporting Project), 28 Shkurt 2020, <https://www.occrp.org/en/investigations/oiling-orbans-propaganda-machine>.
- 62 Transparency International, Treguesi i perceptimit të korrupsionit 2019, <https://www.transparency.org/en/cpi/2018>.
- 63 Wilton Park / Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Trajtimi i kimit serioz dhe të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor: raport i konferencës rajonale Wilton Park (Tackling serious and organized crime in the Western Balkans: Wilton Park regional conference report), shkurt 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/05/GIATOC-Wilton-Park-conference-report-4May1125-Web.pdf>.
- 64 Gjatë përpilimit të raportit, ligji u tërhoq dhe nuk u aprovua. Reporterët Pa Kufij, Treguesi i lirisë së shtypit 2019, profile për Kosovën, Maqedoninë e Veriut, dhe Shqipërinë, <https://rsf.org/en/>.
- 65 Transparency International, Treguesi i perceptimit të korrupsionit 2019, p 16, <https://www.transparency.org/cpi2019>.
- 66 Uglješa Zvekić dhe Sunčana Roksandić Vidlička, Korrupsioni dhe anti-korrupsioni në vendet e Ballkanit perëndimor: Një tablo rajonale e politikës ekonomike të korrupsionit, reagimeve qeveritare dhe premtimeve anti-korrupsion, Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (Corruption and anti-corruption in the Western Balkans: A regional overview of the political economy of corruption, government responses and anti-corruption pledges, Global Initiative Against Transnational Organized Crime), 2020 (vjen së shpejti).
- 67 Ekonomia Tregtare, Niveli i papunësisë në Kosovë, janar 2020, <https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate>.
- 68 OECD, Shenime mbi instrumentet për prurje financiare të paligjshme, [http://www.oecd.org/gov/pcsd/ONLINE_Annotations_PFP%20\(5\).pdf](http://www.oecd.org/gov/pcsd/ONLINE_Annotations_PFP%20(5).pdf).
- 69 Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, Raport vlerësimi mbi respektimin nga Kosova të standardeve ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, dhjetor 2018, <https://rm.coe.int/APP-cft-assessment-report-final-eng/1680997c54>; Këshilli i Evropës, Raport mbi vizitën e katërt për vlerësimin e situatës: Anti-pastrim parash dhe lufta kundër financimit të terrorizmit, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, prill 2014, <https://rm.coe.int/report-on-fourth-assessment-visit-anti-money-laundering-and-combating-/1680715adc>.
- 70 MONEYVAL, Masat anti-pastrim parash dhe kundër financimit të terrorizmit: Shqipëri, korrik 2018, <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measures/1680931f70>.
- 71 Banka Botërore, Studim mbi sipërmarrjen në Shqipëri, të dhëna nga 277 firma të intervistuar nga janari deri në maj 2019 (Enterprise survey Albania, data from 377 firms interviewed between January and May 2019), <https://www.enterprisesurveys.org/en/data/exploreconomies/2019/albania>.

- 72 Të dhënat kanë dalë nga analiza e disa dokumenteve dhe raporteve: Qeveria e Republikës së Maqedonisë (2016), Raport për kryerjen e analizës së situatës dhe nivelit të rrezikut mbi pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit 2010 – 2015, 2016; <http://www.ufr.gov.mk/files/docs/%D0%9D%D0%A0%D0%90.pdf>; Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Maqedonisë, Raporte Vjetore, raportet për 2018, 2017 dhe 2016, <http://jorm.gov.mk/>; Ministria e Brendshme, Raport për vlerësim situatë mbi krimin e organizuar dhe krimet serioze (2010--2016), 2016, Shkup; Ministria e Brendshme, Raport për vlerësim situatë mbi krimin e organizuar dhe krimet serioze (2017--2019), 2019, Shkup.
- 73 OECD, Parandalimi i korrupsionit në prokurimet publike, 2016, <http://www.oecd.org/gov/ethics/Corruption-Public-Procurement-Brochure.pdf>.
- 74 Intervista me një ish-zyrtar të lartë të ministrisë së financës, dhe intervista konfidenciale me sipërmarrës, shkurt 2020.
- 75 Republika e Shqipërisë, Agjencia e Prokurimit Publik, Analiza vjetore 2019, <http://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=2a69a5ce-d232-47ef-b290-0cfa79f97b15>.
- 76 Top Story, 'Vjedhje me tendera.' Ja si grabiten 300 mln euro çdo vit nga institucionet, Top Channel, 7 janar 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=4Hu1tSwMqQ8>.
- 77 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji mbi Buxhetin (Nr. 07/L-001), Përcakimi i fondeve në Republikën e Kosovës për vitin 2020, 19 mars 2020, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EA0446D5-97E0-4540-A9CB-73521FD245A9.pdf>.
- 78 Telegrafi.com, Mbi 3 miliardë euro për autostrada, 2 May 2018, <https://telegrafi.com/mbi-3-miliarde-euro-per-autostrada/>.
- 79 Banka Botërore, Reduktimi i vjedhjeve, korrupsionit dhe bashkëpunimit kriminal në ndërtimin e rrugëve (Curbing fraud, corruption and collusion in the roads sector), qershor 2011, http://siteresources.worldbank.org/INTDOI/Resouces/Roads_Paper_Final.pdf.
- 80 Gjergj Erebara, Kompani shqiptare 'falsifikon lidhje me SHBA' për të fituar kontratën e rrugës (Albanian company 'falsified US links' to win road contract), Balkan Insight, 7 dhjetor 2018, <https://balkaninsight.com/2018/12/07/us-company-in-albania-accused-for-falsifying-documents-12-07-2018/>.
- 81 Raport ndihmës nga një ekspert kosovar i pastrimit të parave, mars 2020. Shiko edhe Naim Krasniqi, *Ndërrohen Kompanitë që do ta Ndërtojnë Autostradën e Gjilanit*, Kallxo, 29 nëntor 2017, <https://kallxo.com/gjate/analize/nderrohen-kompanite-qe-do-ta-ndertojne-autostraden-e-gjilanit/>.
- 82 BIRN, Shkup 2014 uncovered, 5 Janar 2018, <http://skopje2014.prizma.birn.eu.com/en>; BIRN, BIRN Maqedoni krijon bazën e të dhënave 'demaskimi Shkup 2014' (BIRN Macedonia launches 'Shkup 2014 uncovered' database), 19 gusht 2015, <https://birn.eu.com/news-and-events/birn-macedonia-launches-skopje-2014-uncovered-database/>.
- 83 Intervistë me email me një analist financiar, shkurt 2020. Shiko edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Raport për kryerjen e analizës për situatën mbi pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit 2010-2015, 2016, <http://www.ufr.gov.mk/files/docs/%D0%9D%D0%A0%D0%90.pdf>; Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Maqedonisë, Raporte Vjetore 2018, 2017 and 2016, <http://jorm.gov.mk/>. Ministria e Brendshme, Raport për analizimin e situatës mbi krimin e organizuar dhe krimet serioze (2010-2016), 2016, Shkup Ministria e Brendshme, Raport për analizimin e situatës mbi krimin e organizuar dhe krimet serioze (2017-2019), 2019, Shkup.
- 84 Sinisa Jakov Marusic, Maqedonia e Veriut dënon me burg ish-prokurorin e posaçëm për një 'zhvatje' (North Macedonia jails ex-special prosecutor over 'extortion' case), BIRN, 18 qershor 2020, [https://balkaninsight.com/2020/06/18/north-macedonia-jails-ex-special-prosecutor-over-extortion-](https://balkaninsight.com/2020/06/18/north-macedonia-jails-ex-special-prosecutor-over-extortion-case/?utm_source=Balkan+Insight+Newsletters&utm_campaign=73ba9378c7-BI_DAILY&utm_medium=email&utm_term=O_4027db42dc-73ba9378c7-319821509) case/?utm_source=Balkan+Insight+Newsletters&utm_campaign=73ba9378c7-BI_DAILY&utm_medium=email&utm_term=O_4027db42dc-73ba9378c7-319821509; Sinisa Jakov Marusic, Gjyqi në Maqedonia e Veriut për 'zhvatje' fillon me surpriza (North Macedonia 'extortion' case trial starts with surprise), BIRN, 3 dhjetor 2019, <https://balkaninsight.com/2019/12/03/north-macedonia-extortion-case-trial-starts-with-surprise/>; Shërbimi për Ballkanin, Radio Free Europe, Një prokuror, dhe një biznesmen nga Maqedonia e Veriut paditen për zhvatje (North Macedonia prosecutor, businessman charged in extortion case), 11 tetor 2019, <https://www.rferl.org/a/north-macedonia-prosecutor-businessman-charged-in-extortion-case/30211390.html>.
- 85 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Tentakula ndërkombëtare: Zona problematike nëpër botë të krimin të organizuar nga Ballkani perëndimor (Transnational tentacles: Global hotspots of Western Balkans organized crime), korrik 2020.
- 86 Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë, Raport për analizimin e situatës mbi krimin e organizuar dhe krimet serioze 2017-2019, Shkup 2019.
- 87 Treguesi i krimin të organizuar nga GI-TOC bën nga dy analiza për secilin vend: një për 'kriminalitetin' dhe tjetri për 'rezistencë ndaj krimin të organizuar'. Vlerësimi mbi kriminalitetin përfshin edhe një analizë të ekspertëve mbi shkallën dhe shtrirjen e dhjetë aktiviteteve të paligjshme, dhe elementeve të krimin të organizuar. Në vlerësimin e rezistencës analizohen 12 'elementë reagimi'. Treguesi i Krimin të Organizuar Ballkanik, që përfshin gjashtë vende të Ballkanit perëndimor, nisi si një projekt pilot në vitin 2018/19, bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura për vitin 2018. Është përdorur një fond i gjerë literature, intervista në terren, analiza ekspertësh, si dhe vlerësime nga më shumë se 40 përfaqësues të shoqërisë civile në rajon, që bëjnë pjesë në platformën SEE-Obs të krijuar nga Iniciativa Globale. Treguesi i Krimin të Organizuar Ballkanik po rifreskohet dhe do të publikohet si pjesë e Treguesit të Krimin të Organizuar Global në vitin 2021. I njëjti proces u ndoq edhe për Afrikën në vitin 2019. Këtë raport, që përmban edhe një shpjegim të hollësishëm të metodologjisë dhe strukturës së Treguesit mund të lexohet tek www.ocindex.net.
- 88 Po aty.
- 89 Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe Varësisë nga Droga, Përdorimi i drogës dhe pasojat në vendet e Ballkanit perëndimor (European Monitoring Centre on Drugs and Drug Addiction, Drug use and its consequences in the Western Balkans), 2006-14, 2015, <https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/64/TD0215196ENN.pdf>.
- 90 Associated Press, Policia maqedonase konfiskon droga sintetike me vlerë 3 milionë dollarë (Macedonian police seize synthetic drugs Worth \$3 millions), 1 dhjetor 2017, <https://apnews.com/00a0d05233e34c0e9ab3ba9883807acc>.
- 91 MONEYVAL, Masa kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit: Shqipëri, korrik 2018, <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>.
- 92 Komisioni Evropian, Shqipëri 2016 report (Dokument pune për personelin e komisionit), nëntor 2016, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.
- 93 Këto përllogaritje u kryen nga Monitor.al duke u bazuar mbi të dhënat e UNODC nga raportet e tyre vjetore për periudhën 2010-2017. Monitor.al, Këtu filloi gjithçka! Sa është vlera e kanabisit të prodhuar në shqipëri, kanalet si hyri në ekonomi e politikë, 27 qershor 2019, <https://www.monitor.al/sa-eshte-vlera-e-kanabisit-te-prodhuar-ne-shqiperi-kanalet-si-hyri-dhe-u-investua-ne-ekonomi/?fbclid=IwY3bSNjZm9hZG91bWVudC448zrehzcvtbcgye-evvhsnc95eehuaegbtgd159hm>.

- 94 Dilip Kuner, Spanja, SHBA, Kolumbia, dhe Maqedonia e Veriut bashkojnë forcat në operacion anti-kokainë (Spain, USA, Colombia and Northern Macedonia join forces in anti-cocaine smuggling operation), EuroWeekly, 26 dhjetor 2019, <https://www.euroweeklynnews.com/2019/12/26/spain-usa-colombia-and-northern-macedonia-join-forces-in-anti-cocaine-smuggling-operation/>; Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Zona problematike të krimin të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor: Dobësitë lokale në një kontekst rajonal, Maj 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>.
- 95 Tony Sagers, Një vlerësim mbi nivelin e përfshirjes të grupe të krimin të organizuar shqipfolës në furnizimin me drogë të Bashkimit Evropian: Karakteristikat, roli dhe niveli i ndikimit, Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogës dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA), 2019, http://www.emcdda.europa.eu/system/files/attachments/12102/EDMR2019_BackgroundReport_AlbanianSpeakingOCGs.pdf?fbclid=IwAR3NCo5xwUkbgurZz6Om8qml_KrYTqYo4LZ3Owwd7ltmjLWyy8tcjCAi_S8.
- 96 Benet Koleka, Shqipëria konfiskon 613 kilogramë kokainë kolumbiane, arrestohen dy persona (Albania seizes 613 kilos of Colombia cocaine, holds two), Reuters, 28 shkurt 2018, <https://www.reuters.com/article/us-albania-cocaine/albania-seizes-613-kilos-of-colombia-cocaine-holds-two-idUSKCN1GC2KY>.
- 97 Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Raporti vjetor 2018 për arritjen e objektivave nga policia e shtetit, maj 2019, <http://www.punetebrendshme.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/Raporti-Vjetor-per-Arritjen-e-Objektivave-nga-PSH-2018.pdf>.
- 98 Intervistë me një zyrtar të anti-drogës, Tiranë, janar 2020.
- 99 Një vlerësim mbi nivelin e përfshirjes të grupe të krimin të organizuar shqipfolës në furnizimin me drogë të Bashkimit Evropian: Karakteristikat, roli dhe niveli i ndikimit. Studim ndihmës i porositur nga EMCDDA për Raportin mbi Tregun e Drogës në BE 2019, 2019, f15, https://www.emcdda.europa.eu/system/files/attachments/12102/EDMR2019_BackgroundReport_AlbanianSpeakingOCGs.pdf
- 100 Republika e Maqedonisë, Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gazeta Zyrtare (Nr. 37/16), <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-KONTROLA-NA-OPOJNI-DROGI-I-PSIHOTROPNI-SUPSTANTSI-zakluchno-so-37-od-2016.pdf>.
- 101 Ivana Sekularac, Maqedonia e Veriut shpreson se kanabisi mjekësor do të ndihmojë në rritjen e ekonomisë dhe eksporteve (North Macedonia banks on medicinal cannabis growth to boost economy, exports), Reuters, 17 shtator 2019, <https://www.reuters.com/article/us-north-macedonia-cannabis/north-macedonia-banks-on-medicinal-cannabis-growth-to-boost-economy-exports-idUSKBN1W21MA>.
